

MENAXHIMI I INFORMACIONIT MJEDISOR NË SHQIPËRI



ANALIZË E KUADRIT LIGJOR DHE E MENAXHIMIT TË
INFORMACIONIT MJEDISOR NË NIVEL VENDOR E KOMBËTAR,
BAZUAR NË INFORMACIONIN E GJENERUAR NGA RAPORTI I
GJENDJES NË MJEDIS I SHQIPËRISË

MENAXHIMI I INFORMACIONIT MJEDISOR NË SHQIPËRI

PERGATITUR NGA:



EcoAlbania

TIRANË, TETOR 2018



* Ky studim është realizuar nga Organizata “EcoAlbania” në kuadër të projektit “Informacioni mjedisor për një qytetari aktive!”, si pjesë e programit “Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile në Shqipëri (SENIOR-II), i cili zbatohet nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri dhe financohet nga Qeveria Suedeze. Përmbajtja e studimit është përgjegjësi vetëm e Organizatës “EcoAlbania” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Qeverisë Suedeze dhe/apo të REC Shqipëri.

TETOR 2018

PËRGATITËN STUDIMIN:

Dr. ENTELA ÇOBANI
Dr. ORJANA HANXHARI
PhD (c). ERVIN GOCI
Av. MSc. OLTA HADUSHAJ

PËRGATITËN BOTIMIN:

MSc. VALENTINA KABILI
PhD (c). OLSI NIKA

REDAKTIMI SHKENCOR:

Prof. Dr. ALEKO MIHO



PASQYRA E LËNDËS



Lista e shkurtimeve	7
Lista e figurave	7
Lista e tabelave	7
1. HYRJE	8
2. Analiza historike e kuadrit ligjor për informacionin mjedisor dhe RGjMSh.	10
2.1 Fillesat e rregullimit të së drejtës për informacion mjedisor	11
2.2 Legjislacioni për të drejtën e informacionit mjedisor në periudhën 1993-2000	11
2.3 Legjislacioni për informacionin mjedisor në periudhën 2000-2011	14
2.4 Përafrimi i legjislacionit mjedisor me atë të BE-së	16
2.5 Kuadri rregullator aktual për informacionin mjedisor	17
2.5.1 Institucionet kompetente për prodhimin e Raportit të Gjendjes në Mjedisit	19
2.5.2 Roli i njësive të qeverisjes vendore në transferimin e informacionit mjedisor tek qytetarët.	26
3. Analizë e Raportit të Gjendjes në Mjedis në Shqipëri	27
3.1 Konteksti institucional dhe mangësitë në funksionimin e RGjMSh-së	27
3.2 Procesi i Vlerësimit të Gjendjes së Mjedisit mbështetur tek treguesit mjedisorë	29
3.2.1 Qasja evropiane ndaj treguesve mjedisorë dhe kriteret e përzgjedhjes	29
3.2.2 Kriteret e përzgjedhjes së treguesve mjedisorë sipas metodologjisë DPSIR	33
3.2.3 Situata e treguesve mjedisorë: tematika dhe problematikat:	37
3.3 Vlerësimi i aktivitetit të monitorimit të gjendjes së mjedisit në Shqipëri	39
3.3.1 Kuadri konceptual MDIAK dhe zbatimi i tij në kontekstin shqiptar	41
3.3.2 Parimet themelore të procesit të monitorimit të gjendjes së mjedisit	44
3.3.3 Vlerësimi i infrastrukturës aktuale të monitorimit të gjendjes së mjedisit	46
3.3.4 Sistemet aktuale të Monitorimit të gjendjes së mjedisit	51
3.3.5 Burimet e aktivitetit të monitorimit mjedisor dhe problematikat e grumbullimit të të dhënave	57
3.4 Menaxhimi i të dhënave dhe zbatimi i Sistemit të Përbashkët të Informacionit Mjedisor	62
4. Analizë e komunikimit të informacionit mjedisor në RGjMSh	67
4.1 Tipologjia e komunikimit publik në Shqipëri	67
4.2 Pjesëmarrja e publikut në procesin e hartimit të RGjMSh	67
4.3 Analizë e komunikimit të informacionit mjedisor tek publiku	68
4.3.1 Raportimi i ndotjes	68
4.3.2 Raportimi i parametrave të shkarkimeve	69
4.3.3 Burimet e ndotjes: Raportimi mbi efektet në mjedis dhe në shëndetin e njeriut	69
4.3.4 Identifikimi i publikut	70
4.3.5 Reformimi i konceptit të raportimit	70
4.4 Sugjerime për ta bërë komunikimin më efektiv	71
4.4.1 Raportimi dhe gjuha e komunikimit	71
4.4.2 Komunikimi i gjendjes së mjedisit	71
4.4.2.1 Toka, Erozioni	71
4.4.2.2 Biodiversiteti	72
4.5 Komunikimi i normativës ndërkombëtare	73
4.6 Raporti i ICCP - Një shembull pozitiv i raportimit parë nga aspekti komunikativ	73
5. Përfundime dhe rekomandime	77
6. Literatura e konsultuar	83

LISTA E SHKURTIMEVE

LISTA E FIGURAVE

LISTA E TABELAVE



Lista e akronimeve

AEM - Agjencia Evropiane e Mjedisit
AKM - Agjencia Kombëtare e Mjedisit
BE – Bashkimi Evropian
BOD – Nevoja biologjike për oksigjen
CBD - Konventa e Diversitetit Biologjik
CO₂ - dyoksid karboni
COD – Nevoja kimike për oksigjen
DPSIR - D-Forcat Shtytëse, P-Prisionet, S-Gjendja, I-Impakti/Ndikimi, R-Përgjigjet
DRM – Drejtoria Rajonale e Mjedisit
DUDNJ – Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
EPR (Environmental Performance Review) – Rishikim i Performancës mjedisore
EUROSTAT – Zyra e statistikave e Komisionit Evropian
GHG – Gazet e efektit serë
GIS (Geographic information system) – Sistemi informacionit gjeografik
ICCP - Intergovernmental Panel on Climate Change (Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike)
INSTAT – Instituti i Statistikave
ISHP – Instituti i Shëndetit Publik
KE – Këshilli i Evropës
KMM – Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit
MDIAK - (Monitoring-Data-Indicators-Assessment-Knowledge) –Monitorim – Të dhëna – Tregues – Vlerësim - Njohuri
MTM – Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
OECD –Organizata për bashkëpunimin e zhvillimin ekonomik
OJF – Organizata jo Fitimprurëse
OSHC – Organizata të shoqërisë civile
PKMM - Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit
QA (Quality Assurance) - Sigurimi i Cilësisë
QC (Quality Control) - Kontrolli i Cilësisë
RES (Renewable Energy System) – Sistemi i

energjisë së rinovueshme (zbutja e efekteve të Ndryshimeve Klimatike)

RGjMSh - Raporti i Gjendjes së Mjedisit në Shqipëri

SIIM - Sistemi i Integruar i Informacionit Mjedisor

UN (United Nation) – Kombet e Bashkuara

UNFCCC - Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

VKM –Vendim i Këshillit të Ministrave

Lista e figurave

[Figura 1.](#) Cikli politik për hartimin e një vendimmarje të duhur (burimi AEM).

[Figura 2.](#) Treguesit dhe informacionet të lidhura me metodologjinë DPSIR.

[Figura 3.](#) Mënyra e ndërveprimit të faktorëve brenda sistemit MDIAK.

[Figura 4.](#) Harta e rrjetit të monitorimit të mjedisit për vitin 2018 (PKMM, 2017).

[Figura 5.](#) Shpërndarja e buxhetit sipas komponentëve mjedisorë në PKMM 2018.

[Figura 6.](#) Burimi i te dhënave mjedisore për Shqipërinë

[Figura 7.](#) Mënyra e integritit të të dhënave të monitorimit, në sistemin GIS.

Lista e tabelave

[Tabela 1.](#) Kriteret e përzgjedhjes së treguesve mjedisore

[Tabela 2.](#) Klasifikimi treguesve mjedisorë në Shqipëri sipas DPSIR

[Tabela 3.](#) Numri i stacioneve të monitorimit dhe kostoja sipas fushave në PKMM 2018.

[Tabela 4.](#) Referenca të përgjithshme mbi monitorimin e ndotjes së ajrit dhe zhurmave.

[Tabela 5.](#) Referenca të përgjithshme mbi monitorimin e “ujërave sipërfaqësore”.

[Tabela 6.](#) Referenca të përgjithshme mbi monitorimin e “ujërave nëntokësore”

1 HYRJE



Edrejta e çdo personi për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij, përkon me detyrën e vetë individit për ta mbrojtur dhe përmirësuar mjedisin ku jeton. Në mënyrë që qytetarët ta realizojnë këtë të drejtë si dhe të përmbushin këtë detyrë duhet që fillimisht të jenë në dijeni të asaj që ndodh me mjedisin që i rrethon.

Aksesi në informacionin mjedisor vijon të jetë problematik, me gjithë zhvillimet pozitive të viteve të fundit në kuadrin ligjor. Mungesa e përditësimit, qartësisë së informacionit, transparencës dhe koordinimit mes institucioneve cenon menaxhimin e informacionit mjedisor sidomos në nivel vendor. Vlerësimi i situatës lidhur me monitorimin dhe menaxhimin e tij është i nevojshëm në kuadër të përfshirjes më të madhe dhe shpërndarjes më të lehtë tek qytetarët dhe të ndihmës ndaj institucioneve. Gjithashtu ky vlerësim i shërben edhe forcimit të rolit të shoqërisë civile në monitorimin dhe menaxhimin e informacionit mjedisor në Shqipëri.

Ky studim është i konceptuar në 3 pjesë:

1. **Analizë historike e kuadrit ligjor për informacionin mjedisor duke u fokusuar tek RGjMSh;**
2. **Analizë e Raportit të Gjendjes së Mjedisit në Shqipëri;**
3. **Analizë e komunikimit të informacionit mjedisor në RGjMSh.**

Studimi ka si qëllim kryerjen e një analize lidhur me monitorimin dhe menaxhimin e informacionit mjedisor në nivel vendor e qendror, duke u fokusuar tek ai i gjeneruar nga Raporti për Gjendjen e Mjedisit në Shqipëri. Analiza e procesit të hartimit të RGjMSh dhe kuadri mbi të cilin ai hartohet dhe vlerësohet synon nxjerrjen në pah të vlerave pozitive të tij nga njëra anë dhe mangësive e pikave të dobëta nga ana tjetër, e cila, do t'i shërbejë institucioneve në të ardhmen për përmirësimin e menax-

himit të informacionit mjedisor të prodhuar, sidomos në drejtim të komunikimit të tij për publikun.

Informacioni mjedisor i prezantuar në RGjMSh përditësohet çdo vit nga AKM. Ky Raport mbështetet mbi një paketë parametrash/indikatoreësh mjedisorë të përcaktuar me VKM (VKM Nr.1189/2009, “Për rregullat dhe procedurat për përgatitjen dhe zbatimin PKMM”. Ai përfaqëson një vlerësim të gjendjes së mjedisit në Shqipëri të bazuar tek të dhënat dhe informacioni mjedisor i siguruar nëpërmjet aktivitetit monitorues që zhvillohet nga institucionet e ngarkuara për këtë qëllim.

Në studim është paraqitur konteksti ligjor dhe institucional mbi të cilin hartohet RGjMSh duke ku janë evidentuar mangësitë dhe dobësitë e vërejtura në funksionimin e tij, procesi i vlerësimit të gjendjes së mjedisit i mbështetur tek treguesit mjedisorë duke u fokusuar tek qasja evropiane ndaj treguesve mjedisorë dhe kriteret e përzgjedhjes së tyre.

Aksesi i publikut në informacionin mjedisor mbetet një problematikë tejet e rëndësishme, e cila analizohet gjithashtu në studim. Ajo është e parë në dy këndvështrime kryesore: së pari në atë të pjesëmarrjes së publikut në procesin e hartimit të RGjMSh-së dhe së dyti në aksesin e tij në informacion mjedisor të kuptueshëm e të përditësuar.

Ky studim ofron një panoramë të situatës aktuale të menaxhimit të informacionit mjedisor në Shqipëri, duke vlerësuar mënyrën se si ky proces zhvillohet dhe cilët janë aktorët kryesorë. Në këtë mënyrë ai do të nxjerrë në pah rolin e qytetarit dhe kontributin e tij në këtë proces, jo vetëm si përdorues i informacionit mjedisor dhe RGjMSh-së në veçanti, por edhe si kontribues në prodhimin e këtij informacioni.

2 ANALIZA HISTORIKE E KUADRIT LIGJOR PËR INFORMACIONIN MJEDISOR DHE RGJMSH.



2.1 Fillesat e rregullimit të së drejtës për informacion mjedisor

Detyrimi ligjor i institucioneve publike për dhënie e informacionit mjedisor, në Shqipërinë e pas komunizmit daton në vitin 1993. Në disa shtete, e drejta për informim ka ekzistuar prej kohësh në legjislacionin kombëtar. Legjislacioni më i vjetër kombëtar që garantoj lirinë e informimit u miratua në Suedi mbi 200 vjet më parë.

Traktate dhe deklarata të ndryshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut njohin të drejtën për informacion, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Në shumë raste, e drejta për informacion është pjesë e lirisë së shprehjes. Deklarata Universale e Të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e vitit 1948 parashikon në nenin 19 të saj të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë *“për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacion dhe ide përmes çdo media dhe pavarësisht nga kufijtë”*. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966) garanton të drejtën për lirinë e mendimit dhe shprehjes, gjithashtu në Nenin 19, në një formulim të ngjashëm me atë të DUDNJ-së. Në nivel rajonal, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore (1950) parashikon në nenin 10: *“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pa marrë parasysht kufijtë”*.

Ndërkohë që referuar së drejtës për informim për çështjet e mjedisit ka autorë që mendojnë se gjeneza e saj lidhet me gjysmën e dytë të shekullit të XX-të dhe i përgjigjet nevojës për ndërgjegjësim për të penguar shkatërrimin e ekosistemeve të kërcënuar seriozisht nga shkatërrimi potencial i civilizimit modern. E drejta për mbrojtjen e mjedisit bën pjesë në të ashtuquajturën gjeneratë e tretë e të drejtave të njeriut, të cilat po njohin sot një vëmendje të veçantë në veprimtarinë e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, për rolin që ajo ka edhe për sigurimin dhe

mbrojtjen e të drejtave të tjera themelore për një qenien njerëzore.

E drejta për informim përbën një nga të drejtat themelore të individit të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 23 të saj. Kjo e drejtë realizohet duke marrë çdo informacion të nevojshëm i cili prodhohet apo mbahet nga organet publike si pjesë e veprimtarisë së tyre. Përveç sanksionimit të mbrojtjes së të drejtës së informimit, Kushtetuta në nenin 56, mbron gjithashtu të drejtën e çdo personi *“për informim për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij”*.

E drejta për informim për çështjet mjedisore është bazike për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm në të mirë të publikut. Ndërkohë që institucionet publike kanë detyrimin ligjor të marrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit, depërtimi i informacionit mjedisor deri tek qytetarët është pjesa më e rëndësishme për ta konsideruar të përmbushur qëllimin e përbashkët për mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e kushteve mjedisore të shëndetshme për çdo individ.

Në këndvështrimin historik, monitorimi i gjendjes së mjedisit në Shqipëri, mbështetur në programet përkatëse ka filluar qysh në vitet 1970, për t'u ndërprerë më tej për disa vite pas vitit 1990.

2.2 Legjislacioni për të drejtën e informacionit mjedisor në periudhën 1993-2000

Rregullimi i së drejtës për informacion mjedisor është pasqyruar në legjislacionin shqiptar të pas komunizmit fillimisht nëpërmjet Ligjit nr. 7664, datë 21.01.1993 *“Për mbrojtjen e mjedisit”*. Në zbatim të tij kanë dalë aktet nënligjore përkatëse si: VKM nr. 541, datë 25.09.1995 *“Për detyrat që kanë ministrinë, institucionet dhe personat juridikë e fizikë për monitorimin dhe kontrollin e mjedisit dhe Udhëzimi nr.7, datë 06.01.1998 “Për sigurimin e informacionit për mjedisin.*

E drejta e publikut për informacion”.

Ligji nr. 7664/1993 rregullon në mënyrë të detajuar organet kompetente të cilat janë përgjegjëse për grumbullimin, përpunimin dhe informimin e publikut me anë të mjeteve të përshtatshme për rezultatet e monitorimit në fushën e mjedisit. Ai përcakton organet kompetente për monitorimin mjedisit të cilat janë: Komiteti për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit, agjencitë rajonale, ministritë dhe institutet në varësi të tyre si dhe këshillat e komunave, bashkitë e rretheve sipas njërive territoriale përkatëse.

Të gjitha ministritë, insitucionet qendrore dhe Akademia e Shkencave me institutet në vartësi të tyre kanë detyrimin të organizojnë veprimtaritë monitoruese në varësi të fushës përkatëse që mbulojnë. Organet vendore si këshillat e komunave, të bashkive ose rretheve dhe njësitë përkatëse administrative ku veprojnë, përveçse kanë detyrimin të monitorojnë gjendjen e mjedisit kanë gjithashtu detyrimin të informojnë publikun për gjendjen e mjedisit . Ashtu si institucionet qendrore dhe ato vendore kanë detyrimin që çdo tre muaj ta transmetojnë informacionin tek Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit si organi kompetent për vlerësimin e gjendjes së mjedisit.

Më tej, edhe personat juridikë e fizikë, vendas e të huaj, çdo tre muaj dërgojnë informacion në ARM për shkarkimet e lëndëve ndotëse në tokë, ujë dhe ajër dhe këto të fundit ia kalojnë informacionin Komitetit të Mbrojtjes së Mjedisit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit përgatit raportin pas marrjes së informacionit të grumbulluar nga Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe ia paraqet Këshillit të Ministrave për shqyrtim . Këshilli i Ministrave ia paraqet këtë raport për miratim Kuvendit i cili më pas publikohet si Raporti Vjetor i Gjendjes së Mjedisit.

Ligji Nr. 7664/1993 parashikon në nenet 34 dhe 35 të tij detyrimin e shpërndarjes së informacionit mjedisor për gjendjen e

mjedisit. Përcjellja e informacionit mjedisor deri tek publiku bëhet nepërmjet mjeteve të informimit publik ose mjeteve të tjera të përshtatshme, në një formë të kuptueshme për shtetasit. Ky parashikim ka qënë tepër evaziv pasi nuk përcaktonte specifikisht mënyrat e shpërndarjes së informacionit, duke e lënë në dorë të institucioneve të vendosnin për mjetet që ata do të konsideronin më të përshtatshme për dhënien e informacionit publikut.

Vlen për t'u përmendur se neni 35 përmban një rregullim specifik që lidhet me detyrimin për informimin e publikut për ndryshimet mjedisore negative të ndodhura, masat e marra dhe mënyrën e veprimit të shtetasve për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e tyre. Kjo nënkupton se institucionet kompetente përveçse duhet të vënë në dispozicion të publikut çdo kategori të informacionit mjedisor, në rastin e ndryshimeve negative mjedisore, detyrimi për informimin e publikut është i dyfishtë duke kërkuar nga këto institucione që të orientojnë shtetasit për mënyrën e mbrojtjes së shëndetit nga efektet negative.

Më anë të udhëzimit nr. 7, datë 6.01.1998 “Për sigurimin e informacionit për mjedisin. E drejta e publikut për informacion” është përcaktuar në mënyrë të detajuar e gjithë procedura që duhet ndjekur deri në sigurimin e informacionit mjedisor nga publiku. Institucionet qendrore dhe vendore mbartin detyrimin për mbledhjen e informacionit nga institucionet që kanë në varësi çdo tre muaj. Ky Udhëzim përcakton se çfarë duhet të përmbajë informacioni që i dërgohet Agjencive Rajonale të Mjedisit. Deri para daljes së këtij udhëzimi institucionet ia dërgonin informacionin direkt Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit (KMM). Në këtë udhëzim del më qartë roli i Agjencive Rajonale të Mjedisit në raport me Komitetin e Mbrojtjes së Mjedisit. ARM-të bëjnë mbledhjen, përpunimin dhe dërgimin në KMM të të dhënave të dërguara nga institucionet. Njëkohësisht, të gjitha organet duhet të informojnë rregullisht nëpërmjet mjeteve të informimit publik dhe kontakteve direkte me shtetasit për ndry-

shime të cilësisë së mjedisit. Më anë të këtij udhëzimi garantohet e drejta e çdo qytetari për të patur informacion për gjendjen e mjedisit, përcaktohet formati i kërkesës për marrjen e informacionit, rastet e refuzimit të kërkesës, kostoja dhe afatet për dhënien e përgjigjes. Ky udhëzim përshfaq një panoramë më të qartë për garantimin e të drejtës së publikut për marrjen e informacionit mjedisor me apo pa kërkesë paraprake.

Raporti i Gjendjes së Mjedisit si dokumenti kryesor i prodhimit të informacionit mjedisor në Shqipëri është një dokument i mbështetur tek veprimtaria e monitorimit të treguesve mjedisorë. Në Shqipëri vihet re se në vite ka pasur mangësi të theksuara kapacitetesh financiare, njerëzore dhe infrastrukturore. Këto kanë ndikuar edhe në cilësinë e të dhënave dhe të informacionit mjedisor të prodhuar në funksion të procesit të vlerësimit mjedisor të sjellë në RGjMSh.

Përgjithësisht sistemi i monitorimit të mjedisit në Shqipëri ka qenë detyrë e Ministrisë së Mjedisit; objektivi kryesor i saj ka qenë siguria e informacionit mjedisor dhe vendosja e një kulture bashkëpunimi ndërinstitucionale, duke përfshirë në këto procese veçanërisht institucionet shkencore dhe

kërkimore kombëtare, meqenëse ato kishin kapacitetet e nevojshme. Deri në vitin 2000, Ministria përgjegjëse për hartimin e RGjMSh nuk kishte kapacitetet e nevojshme për monitorim; si rrjedhim ajo nuk mund të kryente asnjë aktivitet monitorues, duke bërë që t'i drejtohej institucioneve të tjera. Kjo bëhej nëpërmjet kontraktimit, si p.sh. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Instituti Hidrometeorologjisë, Instituti i Shëndetit Publik, Instituti i Fizikës Bërthamore, Universiteti i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, etj. Këto, asokohe kishin kapacitetet e nevojshme monitoruese për përbërës si ajri, ujërat (nëntokësore dhe sipërfaqësore), mbetjet urbane, ruajtja dhe mbrojtja e natyrës, ekosistemet, zonat e gjelbra dhe biodiversiteti etj. Monitorimi i gjendjes së mjedisit, për sa kohë nuk kishte ende një kuadër ligjor të posaçëm për këtë qëllim, bëhej në bazë të parametrave, të cilët lidheshin me raportimet ndërkombëtare dhe në përputhje me mundësitë reale për matje në nivel kombëtar. Në këto vite nuk kishte ende një Program Kombëtar Monitorimi që të përfshinte edhe parametra të tjerë mjedisorë mbështetur në qasjen e monitorimit gjithëpërfshirës mjedisor.




Figura 1. Skema e institucioneve përgjegjëse për Raportin e Gjendjes së Mjedisit

2.3 Legjislacioni për informacionin mjedisor në periudhën 2000-2011

Deri në fund të viteve '90 shumë nga këto akte ligjore, si konventa, protokolle, marrëveshje u janë kushtuar, përgjithësisht, anëve materiale të mjedisit dhe vetëm në vitin 1998 filloi nënshkrimi i Konventës së Aarhusit që i kushtohet aspekteve shoqërore të tij. Në këtë sens, krahas angazhimit shtetëror për mbrojtjen e mjedisit, Konventa futi në veprim edhe angazhimin gjithëpërfshirës të publikut, rritjen e ndjeshme të rolit të shoqërisë civile që do të sjellin demokratizimin e ndjeshëm të marrëdhënieve mjedisore. Si dokument juridik ndërkombëtar, Konventa përfaqëson një tërësi të drejtash, detyrimesh, rregullash e procedurash të detyrueshme për zbatim për shtetet që e nënshkruajnë dhe e ratifikojnë.

Secila prej të drejtave që Konventa i njej publikut, nënkupton në të njëjtën kohë edhe detyrime për shtetin dhe organet e tij. Mesazhi që transmeton Konventa është: “Çdo e drejtë që ajo i njej publikut, kërkon angazhime të gjera shtetërore që të garantojnë zbatimin e saj në praktikë; që publiku ta ushtrojë atë thjesht dhe natyrshëm, ashtu siç i takon atij”.

Republika e Shqipërisë e nënshkroi Konventën në vitin 1998 dhe Kuvendi e ratifikoi atë në vitin 2000.

Në kuadër të detyrimit për zbatimin e Konventës së Aarhusit në vitet 2000-2003 Shqipëria miratoi një paketë ligjesh për mbrojtjen e mjedisit dhe informimin e publikut si:

1. Ligji Nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
2. Ligji Nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;
3. Vendimi Nr. 103, datë 31.03.2002

“Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë;

4. Vendimi Nr. 34, datë 28.01.2002 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Vepërimit për Mjedisin”.

Me krijimin e Ministrisë së Mjedisit, si një institucion qendror i dedikuar për mbrojtjen e mjedisit, aspekti institucional i organeve mjedisore mori dimensione të reja. Në përbërje të strukturave të saj u ngritën drejtori, sektorë e organizma vartës që i shërbejnë drejtpërdrejt realizimit të detyrimeve që ka kjo ministri për mbrojtjen e mjedisit. Në këtë periudhë u krijua Drejtoria e Komunikimit (tashmë Drejtoria e Informacionit dhe Menaxhimit të të Dhënave) që kishte në përbërje edhe Qendrën Kombëtare të Informacionit Mjedisor, e cila organizon dhe drejton gjithë problematikën e informacionit mjedisor;

Me ndryshimet e bëra në Ligjin Nr. 8934/2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” nuk ekziston më Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit por strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit janë institucionet qendrore që raportojnë tek Ministria e Mjedisit, Agjencitë Rajonale të Mjedisit dhe Inspektoriati i Mjedisit. Institucionet qendrore dhe vendore vazhdojnë të mbajnë të njëjtat përgjegjësi përsa i përket grumbullimit të të dhënave për mbrojtjen e mjedisit dhe transmetimin e informacionit mjedisor drejt Ministrisë së Mjedisit një herë në tre muaj, por gjithashtu mbartin detyrimin që informacionin e grumbulluar ta publikojnë me mjetet më të përshtatshme. Raporti për Gjendjen e Mjedisit përgatitet çdo dy vjet nga Ministria e Mjedisit, i cili i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave. Ky raport në ndryshim nga parashikimi që bënte Ligji Nr. 7664/1993 nuk parashikon detyrimin për miratim nga Kuvendi por pas miratimit nga Këshilli i Ministrave bëhet publik përmes botimit në shtyp ose në rrugë elektronike.

Risia që solli ky ligj ishte sistemi kombëtar

i të dhënave mjedisore, i cili bëhet i aksesueshëm për publikun. Gjithashtu për herë të parë në ligj janë përfshirë palë të interesuara në procesin e mbrojtjes së mjedisit si media dhe organizatat jofitimprurëse.

Ky ligj njeh rolin e medias në:

- a) mbrojtjen e interesave kombëtarë në fushën e mjedisit;
- b) rritjen e dijeve dhe të kulturës bashkëkohore për mjedisin;
- c) realizimin e së drejtës të publikut për të marrë të dhëna për gjendjen e mjedisit;
- d) përhapjen e arritjeve teknike dhe shkencore në fushën e mjedisit dhe të veprimtarive kombëtare në këtë fushë.

Ndërkohë që organizatave jofitimprurëse u njihet e drejta për të marrë pjesë si anëtarë në këshilla e komitete, që krijohen për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe për të qenë faktor ndikues në:

- a) hartimin e politikave, të strategjive, planeve të zhvillimit, si dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
- b) hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të zonave të ndryshme;
- c) hartimin dhe zbatimin e programeve të monitorimit;
- d) kontrollet mjedisore;
- e) procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të miratimit të lejes mjedisore;
- f) hartimin e projektakteve normative mjedisore.

Me ndryshimet e bëra me Ligjin Nr.9890, datë 20.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar”, u krijua rrjeti i agjencive të mjedisit i përbërë nga Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve

si organ qendror dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit në nivel qarku. Pas informacionit të mbledhur nga institucionet qendrore dhe ato monitoruese, të cilat raportojnë çdo tre muaj, Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve harton Raportin Vjetor të Gjendjes së Mjedisit, të cilin ia paraqet Ministrin dhe më pas miratohet nga Këshilli i Ministrave. Agjencitë Rajonale të Mjedisit hartojnë raporte për gjendjen e mjedisit në bazë qarku i cili miratohet nga këshilli i qarkut. Të dy raportet pas miratimit publikohen në media. Një nga detyrat e përcaktuara për Rrjetin e Agjencive është edhe publikimi i të dhënave për mjedisin dhe kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave të bëra nga publiku për informacionet mjedisore që kërkohen.

RGjMSh 1999-2000 i hartuar nga Ministria e Mjedisit, mund të konsiderohet si një përpjekje serioze e parë, për t’i ofruar publikut dhe vendimmarrësve një vlerësim mjedisor të bazuar tek treguesit mjedisorë. Në atë kohë këta përzgjidheshin me qëllim plotësimin e dy kriterëve kryesorë: të ishin mbi baza shkencore dhe të përcillnin informacion të kuptueshëm për publikun e gjerë. Pavarësisht kësaj, vlerësohet se një sërë mangësish e karakterizonin këtë raport ndër të cilët: mungesa e një monitorimi të vazhdueshëm dhe afatgjatë e treguesve mjedisorë të përzgjedhur, duke pamundësuar përcaktimin e prirjeve mjedisore të nevojshme për të nxjerrë edhe përfundime më të sakta dhe të qarta mbi gjendjen e mjedisit për përbërës të caktuar. Si rrjedhim kishte pak mundësi në përcaktimin e burimit të ndotjes dhe propozimin e masave konkrete për vendimmarrësit, por edhe informimin e publikut mbi këto çështje. Megjithatë, duhet nënvizuar fakti se kjo mangësi vazhdon të jetë e pranishme në vite, lidhur me procesin e vlerësimit të gjendjes së mjedisit në Shqipëri.

Vitet që vijuan, RGjMSh vazhdoi të për-

gatitej mbështetur thuajse në të njëjtën qasje, (RGjMSh 2001- 2002; RGjMSh 2003- 2004; RGjMSh 2005- 2007; RGjMSh 2008; RGjMSh 2009; etj.), duke shënuar përpjekje serioze për të fuqizuar procesin e përgatitjes. Kjo u përforcua edhe me miratimin e VKM nr. 1189/2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe

zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit” si akti i parë nënligjor i miratuar që rregullonte këtë aktivitet. Ky është dokumenti bazë mbi të cilin zhvillohet aktiviteti monitorimit të gjendjes në mjedis ende sot, nga i cili sigurohen të dhënat dhe informacioni mjedisor që përdoret për hartimin e RGjMSh.




Figura 2.
Skema e institucioneve përgjegjëse për Raportin e Gjendjes së Mjedisit

2.4 Përafrimi i legjislacionit mjedisor me atë të BE-së

Me ratifikimin e Marrëveshjes së Stabizimit – Asociimit me Komunitetin Evropian në vitin 2006, Shqipëria përballet me detyrimin për përafrimin e legjislacionit mjedisor me legjislacionin e *acquis* të Komunitetit.

Referuar Raportit të Progresit të KE për Shqipërinë, të vitit 2015, Shqipëria ka bërë përpertime në përafrimin e legjislacionit horizontal përsa i përket aksesit në informacion: “Konsultimi publik, aksesit në informacion dhe bashkëpunimi me organizatat

e shoqërisë civile janë përmirësuar”¹. Në fushën e informacionit mjedisor Shqipëria ka detyrimin ta përafrojë legjislacionin me këto direktiva të BE:

- *Direktivën e BE për Aksesin Publik Nr. 2003/4/EC* e cila ka për qëllim të ndihmojë vendet të zbatojnë shtyllën e parë të Konventës së Aarhusit, institucionon të drejtën e publikut për të pasur akses për informacion dhe përcakton kushte të qarta për mënyrën se si informacioni mjedisor duhet të ofrohet.

1 KE, Raporti i Progresit për Shqipërinë 2015.

- *Direktiva për Pjesëmarrjen Publike, 2003/35/EC* – Kjo direktivë synon të ndihmojë vendet të zbatojnë shtyllën e dytë të Konventës së Aarhus-it, duke përcaktuar të Drejtën e Publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore dhe për të kontribuar në përmirësimin e legjislacionit mjedisor, strategjive, planeve ose programeve dhe duke siguruar demokracinë dhe legjitimitetin e politikave dhe projekteve qeveritare dhe institucionale².

Me nismat e ndërmarra për miratimin e Ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”; dhe Ligjit Nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, është mundësuar një kornizë ligjore kombëtare në përputhshmëri të plotë me Direktivën 2003/4/EC mbi aksesin e publikut në informacionin mjedisor, duke parashikuar detyrime të mirëpërcaktuara për të gjithë Autoritetet Publike në nivel qendror dhe vendor.

Ligji i ri, nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikon të drejtën e çdo qytetari për të kërkuar informacion nga çdo organ publik. Institucionit të cili i drejtohet kërkesa për informacion ka detyrimin t’ia vërë në dispozicion kërkuarit në mënyrën e kërkuar nga ky i fundit dhe brenda afatit ligjor të parashikuar në të.

Neni 46 i Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit” jep përkufizimin e informacionit mjedisor i cili është në përputhje me Konventën dhe Direktivën

² Shih: “Përmirësimi i qeverisjes lokale mjedisore në Bashkitë e Sarandës, Delvinës, Konispolit dhe Finiqit, Instituti për ndryshim dhe lidhshmëri në Shqipëri”, Instituti për Ndryshim dhe Lidhshmëri në Shqipëri, 2017, fq.9.

2003/4/EC për aksesin e publikut në informacion mjedisor dhe thekson detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në dispozicion të publikut informacionin mjedisor që ata posedojnë ose prodhojnë.

VKM nr. 16, datë 4.1.2012 “Për të drejtën e aksesit të publikut në informacionin mjedisor” e për afroi plotësisht legjislacionin shqiptar me kornizën ligjore evropiane, përkatësisht me Direktivën 2003/4/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian të 28 janarit 2003 “Aksesi i publikut në informacionin mjedisor”, dhe gjithashtu në mënyrë specifike përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ratifikimi i Konventës së Aarhus-it. Ky vendim garanton aksesin e publikut në informacionin mjedisor, përgjegjësinë e autoriteteve përkatëse publike për ta respektuar atë të drejtë, si në aspektin e afateve, formës dhe përmbajtjes, gjithashtu dhe në mënyrën e dhënies së informacionit.

2.5 Kuadri rregullator aktual për informacionin mjedisor

Legjislacioni aktual dhe përkatësisht Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit” i ka dhënë një rëndësi të madhe të drejtës për informim duke e ndarë në dy momente:

1. E drejta e publikut për të kërkuar informacion mjedisor dhe detyrimi i autoriteteve për ta dhënë këtë informacion në kohë;
2. Detyrimi i autoriteteve publike për të garantuar që publiku ka të gjitha mundësitë për t’u informuar pa bërë një kërkesë paraprakisht, në mënyrë që të ketë mundësi të marrë pjesë në procedurat për identifikimin e gjendjes së mjedisit, hartimin dhe miratimin e strategjive, planeve e programeve që kanë të bëjnë me

mbrojtjen e mjedisit.

Në Kreun VII të ligjit parashikohet qëlimi, funksionimi i sistemit të informacionit mjedisor dhe mënyra e dhënies së. Krijimi i sistemit të informacionit mjedisor shërben për mbrojtjen dhe menaxhimin e integruar të mjedisit dhe përbërësve të tij, për monitorimin e zbatimit të politikave mjedisore, raportimeve të ndërsjella, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe sigurimit të informimit të publikut. Ky sistem administrohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Të dhënat që përmban sistemi i informacionit mjedisor garantojnë nga informacioni i grumbulluar prej autoriteteve publike të cilat kanë detyrimin t'i dorëzojnë periodikisht pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Në sistemin e informacionit mjedisor publik gjë të dhëna për:

1. gjendjen e përbërësve të mjedisit, të mbledhura dhe të përpunuara në përputhje me këtë ligj dhe me akte të tjera të posaçme;
2. shkarkimet e ndotësve në mjedis, të përftuara nga Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;
3. karakteristikat natyrore dhe fizike të përbërësve të mjedisit dhe fenomenet natyrore që kanë ndikim mbi to;
4. mjedisin dhe përbërësit e tij, të përftuar nga projekte dhe programe kërkimore dhe vlerësuese;
5. burimet natyrore dhe përdorimin e tyre;
6. zonat e përcaktuara si të mbrojtura apo të rrezikuara, në bazë të akteve normative të posaçme apo konventave ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;
7. biodiversitetin dhe përbërësit e tij;
8. efektet e ndotjes në mjedis dhe shën-

detin e njeriut;

9. mbetjet dhe menaxhimin e ndotjeve;
10. substancat e rrezikshme;
11. aksidentet industriale dhe ekologjike;
12. masat e sigurisë dhe masat që duhen marrë në rast aksidentesh;
13. ndotësit e mjedisit;
14. masat e politikave mjedisore, planet dhe programet e mbrojtjes së mjedisit;
15. veprimtaritë e mbrojtjes së mjedisit;
16. lejet e lëshuara për kryerjen e veprimtarive ndotëse dhe përmbajtjen e tyre.

Ky ligj e bën më të qartë mënyrën e dhënies së informacionit mjedisor në krahasim me atë që parashikonin dy ligjet paraardhëse. Informacioni mjedisor paraqitet për publikun në formë audio, vizuale, elektronike, me shkrim ose në ndonjë mënyrë tjetër. Gjithashtu, kategoritë e informacionit mjedisor, të cilat bëhen publike janë më të detajuara dhe më gjithëpërfshirëse. Konkretisht informacioni mjedisor që bëhet publik lidhet me:

1. Gjendjen e përbërësve të mjedisit, të tillë si: ajri dhe atmosfera, uji, toka, peizazhi dhe zonat natyrore, përfshirë ligatinat, zonat bregdetare e detare, diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij, përfshirë Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht, dhe ndërveprimin ndërmjet tyre;
2. faktorë të tillë, si substancat, energjia, zhurmat, rrezatimi, vibracionet, erërat e pakëndshme apo mbetjet, përfshirë mbetjet radioaktive, shkarkimet në ajër dhe ujë, si dhe shkarkime të tjera në mjedis, të cilat kanë ose mund të kenë ndikim mbi përbërësit e mjedisit, të referuar në shkronjën "a" të kësaj pike;
3. Masa të tilla, si politikat, legjislativoni, planet, programet, marrëveshjet mje-

disore, si dhe veprimtaritë që kanë ose mund të kenë ndikim mbi përbërësit dhe faktorët e referuar më sipër, si dhe masat apo veprimtaritë e përcaktuara për të mbrojtur këta përbërës;

4. Raportet në lidhje me zbatimin e legjislacionit mjedisor;
5. Analizat kosto-përfitime dhe analiza të tjera ekonomike, si dhe parashikimet e përdorura brenda kuadrit të masave dhe veprimtarive, të referuara më sipër;
6. Gjendjen dhe sigurinë e shëndetit të njeriut, përfshirë ndotjen e zinxhirit ushqimor, atje ku është e nevojshme, kushtet e jetesës, objektet me vlera kulturore dhe arkeologjike, si dhe strukturat e ndërtuara, për sa kohë që ato ndikohen apo mund të ndikohen nga gjendja e përbërësve të mjedisit.

E drejta e çdo personi juridik dhe fizik për të kërkuar informacion mjedisor pa u detyruar të shpjegojë motivet, sanksionohet në nenin 47 të Ligjit nr. 10431/2011. Rregullat e zbatueshme nga ana e qytetarëve për paraqitjen e kërkesës për marrjen e informacionit dhe procedurat e zbatueshme nga organet publike për dhënien e informacionit janë të parashikuara në mënyrë më të detajuar në ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i cili është i zbatueshëm edhe për kërkesat për informacion mjedisor.

2.5.1 Institucionet kompetente për prodhimin e Raportit të Gjendjes në Mjedisit

Me krijimin e qeverisë së dalë nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, Ministria e Mjedisit u quajt Ministria e Turizimit dhe Mjedisit. Në fushën e mjedisit kjo ministri ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qën-

drueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe hartimin dhe zbatimin e politikave për turizmin. Ministria e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha: a) Sektorin e mjedisit, përfshirë politikat, standardet e trajtimit të mbetjeve dhe të efekteve që sjellin në drejtim të ajrit dhe të mjedisit, cilësinë e ajrit, zhurmat, ndotjen industriale, kimikatet, ndryshimet klimatike dhe monitorimin e treguesve të mjedisit dhe të cilësisë së ujërave, vlerësimin e ndikimit në mjedis; b) Natyrën dhe biodiversitetin, përfshirë florën dhe faunën, mbrojtjen e tokës nga erozioni e degradimi, mbrojtjen e peizazhit natyror, mbrojtjen e faunës së egër e të specieve të rrezikuara dhe zonat e mbrojtura; c) Sektorin e pyjeve dhe të kullotave.³

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është autoriteti kompetent për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit. Si institucion qendror publik në varësi të ministrit e ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore e degëve rajonale në qarqe që quhen Drejtoritë Rajonale të Mjedisit dhe ka pavarësi në vendimmarrje. Ndër funksionet e saj kryesore përfshihet edhe monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së mjedisit, përgatitja dhe publikimi i përvitshëm i RGjM-së, krijimi dhe menaxhimin e informacionit mjedisor dhe sigurimi i informacionit mjedisor për publikun në lidhje me çështjet mjedisore.

Procesi i monitorimit të gjendjes së mjedisit në Shqipëri bazohet në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për Mbrojtjen e Mjedisit”. Monitorimi i gjendjes së mjedisit në

³ VKM nr. 509, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit”.

vend, si një aktivitet i detyrueshëm ligjor kryhet në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit. Në zbatim të VKM nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”, Kreu IV, Pika 3, si dhe në zbatim të këtij Programi, AKM-ja me të dhënat e siguruar nga monitorimi i mjedisit, përgatit çdo vit Raportin e Gjendjes së Mjedisit. Në këtë të fundit, përcaktohet lista e treguesve mjedisorë, mbi të cilët kryhet monitorimi, të bazuar tek treguesit mjedisorë të listuar në aneksin e VKM-së, së sipërpërmendur. Duhet theksuar fakti që VKM nr. 1189/ 2009 është hartuar përpara fillimit të proceseve të lidhura me transpozimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian. Si e tillë kjo VKM duket se ka mangësi dhe mospërputhje të theksuar, përta të përket listës së treguesve mjedisorë të përfshirë, krahasuar me ato që zbatohen sot në nivel evropian, për metodologjinë e përcaktimit të tyre dhe shkallës së përfaqësimit në nivel kombëtar. Vlen të thuhet se vetë legjislacioni i BE-së në vitet e fundit ka përparuar ndjeshëm duke bërë të ndihet nevoja e rishikimit sa më të shpejtë të VKM-së nr. 1189/2009.

Në mënyrë që funksioni i monitorimit të gjendjes së mjedisit dhe përcjelljes së informacionit mjedisor tek publiku të realizohen me sukses, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka në brendësi të saj, përveç të tjerave edhe Drejtorinë e Informacionit dhe Menaxhimit të të Dhënave si dhe Drejtorinë e Gjendjes dhe Cilësisë së Mjedisit.

Drejtoria e Gjendjes & Cilësisë së Mjedisit ka këto përgjegjësi:

- Përgatit dhe publikon Raportin Vjetor të gjendjes së Mjedisit;
- Monitoron gjendjen e mjedisit;

- Përgatit dhe ndjek Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit;
- Mirëmban dhe zhvillon/përmirëson laboratorin për kryerjen e analizave mjedimore, në përputhje dhe duke përmbushur kërkesat e akreditimit.

Drejtoria e Informacionit dhe Menaxhimit të të Dhënave, ndër të tjera ka këto përgjegjësi:

- Ofron informacion mjedisor për publikun;
- Përgatit dhe mirëmban faqen e internetit të agjencisë me akses për publikun;
- Siguron dërgimin e informacionit sipas kërkesave të publikut;
- Merr përsipër ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e mjedisit;
- Ofron mbështetje teknike për raportimet tek AEM (Agjencia Europiane e Mjedisit)
- Kujdeset për organizimin dhe koordinimin e punës me gjithë drejtoritë edhe partnetrët e tjerë për grumbullimin dhe mirëmenaxhimin e të dhënave me karakter mjedisor;
- Merr përsipër konfigurimin e hartave dhe metodave të tjera të prezantimit të të dhënave që kanë referencë hapësinore;
- Përditëson informacionin teknik bashkëkohor në fushën e përdorimit;
- Hedh në sistemin GIS gjithë të dhënat mbi tregues të ndryshëm mjedisor të monitoruar nga AKM ose partner të tjerë me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi apo kontrata të lidhura.

Drejtoritë Rajonale të Mjedisit kanë zyrat e tyre në qarqet përkatëse pranë prefekturave dhe/ose bashkive përkatëse si dhe kanë këto përgjegjësi kryesore:

- Monitorime;
- Hedhja e të dhënave online në nivel qarku për t'u bërë të aksesueshme nga AKM;
- Përgatitje e Raportit të Gjendjes në Mjedis në bazë qarku;
- Publikimi i RGJM në bazë qarku në variantin elektronik.

Në zbatim të PKMM, Agjencia Kombëtare e Mjedisit grumbullon të dhënat dhe informacionin mjedisor nga:

- a. Raportet vjetore, që dorëzojnë ministritë e përmendura në VKM-në 1189/2009, ku jepen të dhëna e shpjegime për gjendjen e mjedisit që administrojnë. Afati i dorëzimit të këtyre raporteve është brenda tre mujorit të parë të vitit pasardhës.
- b. Raportet teknike, të përgatitura nga institucionet monitoruese, që dorëzohen në afatet 6-mujore dhe vjetore (të përcaktuara në kontratat përkatëse), si dhe sa herë që AKM-ja ua kërkon zyrtarisht, për arsye urgjente.
- c. Të dhënat e monitorimit, të dorëzuara nga personat fizikë dhe juridikë, vepërimtaritë e të cilëve janë subjekte të lejes mjedisore, në Drejtoritë Rajonale të Mjedisit. Të dhënat dorëzohen sipas afateve të përcaktuara në urdhrin e ministrit, çdo tre muaj, në çdo kohë për aksidentet industriale, si dhe kur u kërkohe zyrtarisht nga DRM-të për nevoja urgjente të qarkut, ku ato veprojnë.

Ka disa institucione, të cilat janë të përfshi-

ra në procesin e monitorimit të mjedisit, me qëllim përgatitjen e RGJM-së. Këto institucione janë të përcaktuara në përputhje me treguesit mjedisorë që secili prej tyre monitoron:

1. Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit (cilësinë e ajrit, biodiversitetin, cilësinë e ujërave, shëndeti në pyje etj.)
2. Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik dhe 'drejtorive të shëndetit publik' nëpërrrethe monitorojnë tregues që kanë të bëjnë me cilësinë e ujërave- treguesit mirkobiologjikë
3. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve (referuar emertimit siç ka qenë dhe citimit në VKM-në 1189-/2009) sot Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë për tregues të lidhur me menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe inerteve.
4. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (sot Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për tregues të lidhur me tokat, ndotësit e bujqësisë, ujitjen.
5. Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjisë (sot Ministria e Energjitikës dhe Industrisë), Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për tregues të lidhur me ujërat nëntokësore, tokat, erozioni etj.
6. Ministria e Mbrojtjes (presionet e shkaktuara nga kompanitë ushtarake që operojnë brenda sistemit).
7. Institucionet e specializuara që kryejnë monitorime nëpërmjet kontraktimit të këtyre të fundit.
8. Subjekte/Aktorë privatë të cilët janë të ngarkuar dhe kryejnë monitorim të ndotjeve që vijnë si rezultat i aktivitetit të tyre, subjekt i lejeve të mjedisit.

Të dhënat dhe informacionet mjedisore dorëzohen në AKM, në tre kopje (në “hard copy” dhe me CD)⁴. Drejtorja e informacionit dhe menaxhimit të të dhënave në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit bën regjistrimin e treguesve mjedisorë bazuar në të dhënat e mbledhura nga institucionet monitoruese. Regjistrat dhe baza e të dhënave janë të hapura për publikun. Agjencia Kombëtare e Mjedisit raporton tek Ministria e Turizmit dhe Mjedisit lidhur me të dhënat e mbledhura nga institucionet monitoruese. Me të dhënat e grumbulluara Agjencia Kombëtare Mjedisit përgatit çdo vit Raportin e Gjendjes së Mjedisit dhe e publikon atë në faqen zyrtare të saj dhe të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit.

Duke iu referuar bazës ligjore aktuale për pjesëmarrjen e publikut në procesin e monitorimit të mjedisit, nuk përmendet askund që publiku mund të bëhet pjesë e procesit të hartimit të RGJM-së. Publiku vetëm gjatë proceseve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedisit mund të marrë pjesë në proces monitorimi. Do të veçonim VKM nr. 247, datë 30.4.2014. “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, ku në Kreun III të saj citohet që **publiku mund të marrë pjesë në procesin e monitorimit të ndikimeve në mjedis të projektit**. Gjithashtu publiku mund të dërgojë mendime dhe komente për të dhënat e monitorimit pranë AKM-së dhe ARM-së (DRM). Kjo vetëm për projekte, të cilat janë subjekt i VNM-së por jo për procesin e monitorimit në kuadër të RGJM-së. Publiku duhet të luajë rolin e tij aktiv në procesin e monitorimit duke luajtur edhe rolin e oponentit të RGJM-së me qëllim arritjen e një Raporti sa më realist dhe më afër problemeve që e shqetësojnë publikun dhe OShC-të. Në RGJM analizohen dhe paraqiten probleme

4 Shih Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit për vitin 2017, AKM, Tiranë 2016, fq 17.

mjedisore që në disa raste nuk janë vërtetë ato që e shqetësojnë publikun në përgjithësi dhe atë të ndikuar.

2.5.2 Roli i njësive të qeverisjes vendore në transferimin e informacionit mjedisor tek qytetarët.

Ndarja e re administrativo-territoriale solli miratimin e një ligji të ri që rregullon funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e njësive të qeverisjes vendore. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikon ndër të tjera detyrimin e njësive të qeverisjes vendore për të bërë transparente për publikun veprimtarinë e tyre.⁵

Organet vendore duhet të publikojnë në faqen zyrtare të internetit si dhe të afishojnë në stendën e njoftimeve publike, çdo akt administrativ të prodhuar prej tyre. Vlen për t’u theksuar fakti se njësitet e qeverisjes vendore duhet të garantojnë akses për të gjithë, veçanërisht për shtresat më të varfëra të komunitetit. Ky parashikim e bën më të qartë faktin se njësitet e vetëqeverisjes vendore nuk mund ta konsiderojnë të përmbushur detyrimin për bërjen publike të informacionit vetëm duke e publikuar në faqen e internetit, por duhet të ndërmarrin veprime të tjera aktive për të përçuar informacionin edhe tek ajo pjesë e komunitetit që e ka të pamundur aksesin në faqen zyrtare të institucionit.

Neni 15 i Ligjit nr. 139/2015 referon tek Ligji 114/2014 “Për të drejtën e informimit” lidhur me detyrimin e njësive të qeverisjes vendore për të miratuar programin e transparencës dhe koordinatorin për të drejtën e informimit, nga ku rrjedh edhe detyrimi i organeve publike për të bërë publike një kategori informacionesh. Referuar nenit

5 Neni 15 i Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

17, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik në faqen zyrtare të internetit të institucioneve janë: struktura, funksionet dhe detyrat e autoritetit publik, ligjet dhe aktet nënligjore, procedura për kërkesë për informim, të dhëna në lidhje me punën për nëpunësit, të dhëna për buxhetin, për procedurat e prokurimit si dhe çdo informacion tjetër që autoriteti publik e konsideron të dobishëm.

Dhënia e informacionit mjedisor nuk parashikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë si pjesë e ndonjë prej kategorive të përcaktuara në nenin 17 të lartpërmendur apo në nenin 15 të Ligjit nr.139/2015, por kjo del si interpretim në tërësi i ligjit që rregullon kompetencat e organeve vendore ku parashikohet dhënia e informacionit në kuadër të përgjithshëm dhe ligjeve e akteve nënligjore që rregullojnë të drejtën e informimit, ku organet vendore bëjnë pjesë në subjekte të cilave ligji u drejtohet.

Në kushtet kur nuk ka akt normativ që të rregullojë të drejtat dhe detyrimet e organeve vendore për transmetimin e informacionit mjedisor tek publiku, atëherë duhet referuar në Ligjin nr. 10431/2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit" në të cilin parashikohet: "E drejta e qytetarëve për të marrë informacion mjedisor përbën një detyrim për organet publike". Nga një interpretim sistematik i ligjit, arrihet në konkluzionin se përsa kohë me konceptin autoritet publik kuptohen edhe organet vendore, atëherë detyrimin për dhënien e informacionit mjedisor e kanë edhe organet vendore. Në nenin 46, ashtu siç është përmendur edhe më sipër, parashikohet se mënyrat që përdoren për përcjelljen e informacionit mjedisor tek publiku janë në formë audio, vizuale, elektronike, me shkrim ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Në mënyrë të detajuar në VKM-në nr. 16, datë 14.01.2012 parashikohet mënyra sesi realizohet shpërndarja e informacioni mjedisor nga autoritetet publike, ku përfshihen edhe organet vendore.

Vënia dhe shpërndarja e informacionit të disponueshëm në shërbim të publikut realizohen, si më poshtë vijon:

a) Autoriteti publik përkatës vë në shërbim të publikut dhe ia shpërndan atij informacionin e mëposhtëm të cilin disponon:

i) Tekstet e konventave ose marrëveshjeve ndërkombëtare, tekstet e Komunitetit Evropian, aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare ose vendore që lidhen me mjedisin;

ii) Politikat, strategjitë, planet dhe programet që lidhen me mjedisin;

iii) Raportet për progresin e bërë në lidhje me zbatimin e nënndarjeve "i" dhe "ii", të kësaj pike, në rastet kur ato përgatiten dhe/ose disponohen nga autoriteti publik;

iv) Raportet për gjendjen e mjedisit;

v) Të dhënat ose përmbledhjen e të dhënave të mbledhura nga monitorimi i veprimtarive që ndikojnë ose që mund të ndikojnë në mjedis;

vi) Autorizimet, lejet dhe licencat për veprimtaritë me ndikim në mjedis dhe marrëveshjet mjedisore ose të dhëna për vendin se ku mund të kërkohet ose të gjendet ky informacion;

vii) Studimet për ndikimin mjedisor dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me elementet mjedisore, siç janë ajri dhe atmosfera, uji, toka, vendet piktoreske dhe natyrore, përfshirë ligatinat, zonat bregdetare, zonat e mbrojtura, diversiteti biologjik dhe përbërësit e tij, duke përfshirë këtu edhe organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe ndërveprimin midis këtyre elementeve, ose një referencë se ku mund të kërkohet ose të gjendet ky informacion.

Shpërndarja e informacionit mjedisor, në rastin e kërcënimeve të pashmangshme, realizohet, si më poshtë vijon: Autoriteti publik, kur gjykon se ekziston një kërcënim i pashmangshëm për shëndetin

e njerëzve apo mjedisin, i shkaktuar nga veprimtaria njerëzore apo si pasojë e shkaqeve natyrore, ia shpërndan menjëherë dhe pa vonesë publikut, që ndikohet apo mund të ndikohet nga ky kërcënim, të gjithë informacionin që disponon, me qëllim që publiku të marrë masa për të shmangur ose minimizuar dëmin e mundshëm dhe pasojat negative.

Bashkitë si pjesë e njësisive të qeverisjes si një nga funksionet e kompetencave të tyre kanë mbrojtjen e mjedisit, ku përfshihet:

- Mbrojtja e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja
- Marrjen e masave për mbrojtjen nga ndotja akustike
- Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.

Ky parashikim ligjor përbën një detyrim për Bashkitë që të ndërmarrin veprime aktive në interes të depërtimit të informacionit mjedisor te çdo qytetar. Kjo nënkupton që nuk është e mjaftueshme vetëm që informacioni mjedisor të publikohet në faqen zyrtare apo në ambientet e institucionit, por duhet që Bashkitë të angazhohen duke zhvilluar aktivitete edukuese dhe promovuese në kuadrin e mbrojtjes së mjedisit. Në këtë mënyrë informacioni mjedisor bëhet më i prekshëm për komunitetin.

Në një studim të kryer nga BIRN Albania, referuar nivelit të transparencës për 61 Bashkitë e vendit nga rezultatet në terren është konstatuar se vetëm 43% për vitin 2016 dhe 46% për vitin 2017 kanë arritur të plotësojnë detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”⁶. Duke iu referuar të dhënave të marra nga monitorimi online, 1/3 e Bash-

6 Birn Albania, Raport Kombëtar Raportimi. Pushteti Vendor nën Lenten e të drejtës për informim. Tiramë 2017, faqe 15.

kive nuk zotërojnë një faqe interneti. Nga ato 40 bashki që zotërojnë faqe interneti niveli i transparencës ka qënë 41%⁷.

Ky studim e bën më të qartë gjendjen e Bashkive në rang vendi përsa i përket detyrimit për të bërë publik një kategori të caktuar informacioni⁸. Kjo situatë na mundëson të kuptojmë vështirësitë që hasin qytetarët për të marrë informacion si nëpërmjet faqeve zyrtare ashtu edhe në ambientet e institucionit, përsa kohë mesatarja e performancës së bashkive nuk kalon as 50% të detyrimeve që kanë për publikimin e informacioneve. Në kushtet kur rreth 21 Bashki nuk zotërojnë faqe interneti dhe niveli i transparencës është më pak se 50% si në publikimet *on-line* ashtu edhe në mjediset e institucionit, arrijmë në konkluzion se informacioni tek publiku, përfshirë edhe ai mjedisor nuk arrin në nivelin e duhur.

Duke qenë se organet e qeverisjes vendore nuk janë subjekte monitoruese të gjendjes së mjedisit dhe as kanë kompetenca të hartojnë raportin e gjendjes së mjedisit është e nevojshme që të kryhen parashikimet në ligj ose akte nënligjore që rregullojnë raportin midis AKM-së dhe institucioneve të saj rajonale nga njëra anë dhe organeve të qeverisjes vendore nga ana tjetër në drejtim të menaxhimit të informacionit mjedisor.

Organet qendrore dhe vendore kanë detyrimin që të informojnë komunitetin për çdo informacion mjedisor që zotërojnë. Legjislacioni ka parashikuar një sërë mënyrash me anë të të cilave këto organe bëjnë të mundur informimin e publikut. Ofrimi i informacionit mjedisor do të konsiderohet si një detyrë ligjore e përmbushur nga organet qendrore dhe

7 Birn Albania, Raport Kombëtar Raportimi. Pushteti Vendor nën Lenten e të drejtës për informim. Tiramë 2017, faqe 79.

8 Ky studim i referohet informacionit që duhet të bëjnë publike bashkitë në bazë të nenit 17 të Ligjit 119/2014, të përmendur në faqen 12 të këtij raporti.

vendore vetëm kur ky informacion është mbledhur dhe publikuar në një mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme nga të gjithë. Një informacion i pakuptueshëm mbetet një informacion i paplotë dhe për pasojë një detyrim ligjor i papërbushur nga organet përgjegjëse.



3 ANALIZË E RAPORTIT TË GJENDJES NË MJEDIS NË SHQIPËRI



3.1 Konteksti institucional dhe mangësitë në funksionimin e RGjMSh-së

Raporti i Gjendjes së Mjedisit hartohet çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe mbështetet në të dhënat dhe informacioni mjedisor të prodhuar nga aktiviteti monitorues i vetë AKM-së, por dhe nga institucionet e tjera, përfshirë ato kërkimore-shkencore. Këto të dhëna mbështeten në Planin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit (PKMM), hartuar nga AKM në përputhje me VKM-në nr. 1189/2009, dhe miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Për të bërë të mundur zbatimin e PKMM, AKM duhet të bashkëpunojë me:

- a- Institucionet qendrore që lidhen me fushat përkatëse të trajtuara në RGjMSh, si ministri apo institucione varësie (në përputhje me fushën përkatëse që mbulon), për të përcaktuar të dhënat dhe treguesit që duhet të grumbullojë për mjedisin;
- b- Organet e qeverisjes vendore së bashku me të cilat përcaktohen të dhënat dhe treguesit mjedisorë që këto të fundit kanë nën administrim, sidomos për mjediset urbane, administrimin e mbetjeve, ujërave, pyjeve e kullotave komunale etj.;
- c- Institucionet monitoruese në vend (institute, universitete etj.) duke vlerësuar mundësitë e tyre për të monitoruar treguesit konkretë mjedisorë.

Lidhur me aspektin institucional, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duket sikur përgjegjësi i drejtpërdrejtë për hartimin e RGjMSh është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ndërsa AKM (ish Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve) luan rolin e autoritetit koordinues përgjegjës për hartimin, ndjekjen,

koordinimin, grumbullimin dhe vlerësimin, duke finalizuar gjithë procesin me hartimin e RGjMSh. Por në fakt, rolin kyç në gjithë procesin e përgatitjes së RGjMSh e ka AKM. Ajo harton PKMM mbështetur në VKM-në nr. 1189/2009; ia përcjell atë MTM-së për shqyrtim të mëtejshëm dhe miratim, për të vazhduar më tej me lidhjen e kontratave të monitorimit me institucionet e tjera për tregues të caktuar mjedisorë. Më tej është po AKM-ja, që kryen aktivitetin monitorues të mjedisit për përbërës mjedisorë të caktuar, që monitorohen pranë laboratorit të saj. Po ashtu ajo ndjek ecurinë e monitorimit nga institucionet e tjera në bazë të kontratave të lidhura me to, po nga AKM-ja. Gjithë të dhënat e grumbulluara nga monitorimi grumbullohen në AKM dhe i nënshtrohen përpunimit, analizës dhe vlerësimit mjedisor, proces që finalizohet me hartimin e RGjMSh. Ky Raport i nënshtrohet një procesi konsultimesh me institucionet e linjës (përfshirë MTM-në) dhe rivlerësimesh, duke reflektuar sugjerimet dhe propozimet e bëra mbi bazë të dorëshkrimit të përgatitur.

RGjMSh ofron të dhënat bazë të përpunuara dhe me vlerësime e interpretimet përkatëse në lidhje me gjendjen e mjedisit. Këto më pas përdoren për t'ia komunikuar politikëbërjes dhe publikut të gjerë brenda vendit, por njëkohësisht edhe për të kryer detyrimet raportuese ndërkombe-tare. RGjMSh është një instrument i rëndësishëm, që i shërben politikëbërjes duke e ndihmuar me informacionin e nevojshëm, lidhur me gjendjen e mjedisit dhe veçanërisht me shqetësimet që vihen re nga vlerësimet e kryera; kjo ndihmon për të tërhequr vëmendjen për shqetësimet, si dhe për domosdoshmërinë e masave të nevojshme për ndërhyrje, në ato fusha ku ato vihen re. Njëkohësisht, ajo shërben edhe për të matur/testuar shkallën e sukse-

sit të politikave mjedisore të hartuara dhe të zbatuara në nivel kombëtar. RGjMSh shërben si burim informacioni në shërbim të detyrimeve raportuese që vendi ka ndaj Konventave apo marrëveshjeve ndërkombëtare ku është palë. Këto janë gjithmonë në rritje, si ndaj BE-së, ndaj Agjencisë Evropiane të Mjedisit, apo organizatave të tjera ndërkombëtare. Me këto vendi ka një bashkëpunim të gjatë dhe të përforcuar dhe duhet të raportojë rregullisht të dhëna mjedisore, të cilat janë edhe pjesë e RGjMSh-së.

Këto janë arsytet pse duhet vënë në dukje nevoja e unifikimit të metodologjive të përdorura për monitorimin e çdo parametri mjedisor, me atë të vendeve të tjera të BE-së, të përcaktuar edhe në secilën prej direktivave evropiane përkatëse. Kjo do të bënte që procesi i raportimit të jetë i besueshëm, i pranueshëm, i saktë, dhe do të ofronte mundësinë e vlerësimeve krahasuese me atë të vendeve të tjera të BE-së. Edhe pse duhet theksuar se, monitorimi i mjedisit nuk është një kapitull specifik dhe dedikuar sot në legjislacionin mjedisor *Acquis* të BE-së. Nuk ka në fakt asnjë akt ligjor sot në BE, që të mbulojë gjithë çështjet që lidhen me monitorimin e mjedisit të trajtuara në mënyrë të përbashkët, sikundër VKM nr. 1189/2009 priret të bëjë. Nëse do të bënim një krahasim të mënyrës se si është trajtuar në legjislacionin e BE-së kjo çështje, do të vërenim faktin që çështje mjedisore të ndryshme janë objekt i akteve ligjore të ndryshme, ku secili mbulon një fushë të caktuar, që lidhet me atë tematikë dhe të ndara prej tyre. Çështja e monitorimit dhe standardeve përkatëse janë objekt i akteve të lidhura me një tematikë të caktuar dhe brenda kontekstit të përgjithshëm të asaj fushe; p.sh. monitorimi i cilësisë së ajrit ndodhet brenda direktivave përkatëse që adresojnë

cilësinë e ajrit në nivel evropian.

Në Shqipëri vitet e fundit është punuar seriozisht në drejtim të përshtatjes së direktivave evropiane në legjislacionin shqiptar; disa prej këtyre akteve ligjore kanë hyrë në fuqi. Duhet gjithashtu të konsiderohen si detyrime ligjore kombëtare edhe çështjet që janë të lidhura dhe kanë të bëjnë me procesin e monitorimit të mjedisit dhe standardizimin e tyre mbështetur në standardet dhe kërkesat e BE-së; kjo duhet si në fushën e cilësisë së ajrit, ashtu edhe për fusha e tjera që janë objekt i vlerësimit të gjendjes së mjedisit; këtu duhet vëmendje si për metodologjitë dhe për teknikat e nevojshme të zbatuara. Këto çështje, që sot janë objekt edhe i VKM-së nr.1189/2009 për monitorimin, e nxjerrin atë jashtë funksioni, relativisht i vjetër, dhe që vihet në zbatim me vështirësi, duke krijuar mbivendosje që shpesh mund të krijojnë përplasje dhe konfuzion.

Në legjislacionin aktual mjedisor *Acquis* të BE-së, si dhe në aktet ligjore të miratuara së fundi në Shqipëri, kërkesat e monitorimit të gjendjes së mjedisit janë të shpërndara përmes akteve ligjore të ndryshme. Ato përfshijnë kriteret, standardet, metodikën, përzgjedhjen e stacioneve, shpeshitë e matjeve, teknikat e kampionimit, formulat që duhen përdorur gjatë këtij procesi, duke përcaktuar në këtë mënyrë standarde mbi të cilat duhet të kryhet ky aktivitet. Në çdo akt ligjor mjedisor të përafëruar deri sot me atë të BE-së, ku përcaktohet qartë një objektiv që duhet të arrihet aty, nevojitet të kryhet monitorim i lidhur me ato objektiva dhe fusha të lidhura me to me qëllim raportimin e shkallës së zbatimit dhe përmbushjes së këtyre objektivave. Në të vërtetë, ky është edhe qëllimi i RGjMSh: nëpërmjet vlerësimit të gjendjes së mjedisit, të japë informacion

mbi shkallën e veprimit të politikave mjedisore kombëtare sot, matjen e cilësisë dhe zbatimit të tyre.

Në çastin që legjislacioni evropian është përafëruar me atë kombëtar mjedisor dhe ka hyrë në fuqi, ai automatikisht duhet të konsiderohet si i detyrueshëm për t'u zbatuar nga gjithë institucionet zbatuese si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel vendor. Zbatimi korrekt i tyre do të bëjë të mundur që të dhënat e përfituara nga procesi i monitorimit dhe treguesit e gjeneruar apo furnizuar prej tyre të kenë një shkallë të lartë ndërveprimi me politikat mjedisore sot, të jenë të besueshme dhe të krahasueshme me ato të BE-së.

Duhet theksuar gjithashtu fakti që ndërkohë që legjislacioni shqiptar po përshtatet gjithmonë e më shumë me atë evropian, duke përfshirë këtu edhe çështjet e monitorimit të gjendjes së mjedisit, mbi të cilin kryhet vlerësimi dhe hartimi i RGjMSh, atëherë gjithmonë e më shumë del si domosdoshmëri rishikimi i VKM-së nr. 1189/2009. Ajo duhet zëvendësuar me një akt tjetër ligjor ku të adresohen çështjet e monitorimit mjedisor në mënyrë më gjithëpërfshirëse dhe në përputhje të plotë me paketën ligjore mjedisore sot në fuqi në Shqipëri dhe të parafruar me atë të BE-së. Një VKM e re duhet të pasqyrojë ndryshimet institucionale të ndodhura në Shqipëri dhe detyrimet e tyre përpara i përket kontributit në këtë proces.

Për më tepër, duhet theksuar gjithashtu se ka një mungesë të theksuar kapacitetesh financiare në dispozicion të institucioneve në përgjithësi dhe AKM-së në veçanti, përpara i përket zbatimit me përpikmëri të PKMM, ashtu si ai është konceptuar deri sot. Nga raporti fundit i Kombeve të Bashkuara EPR (*Environmental Performance Review - Third Part*), vlerësohet se

burimet financiare në funksion të aktivitetit monitorues të mjedisit që i jepen AKM-së si institucioni përgjegjës për hartimin e RGjMSh mbulojnë vetëm 3% të asaj çka nevojitet për të përmbushur gjithë kërkesat e PKMM sot.

3.2 Procesi i Vlerësimit të Gjendjes së Mjedisit mbështetur tek treguesit mjedisorë

3.2.1 Qasja evropiane ndaj treguesve mjedisorë dhe kriteret e përzgjedhjes

Veprimtaria monitoruese dhe vlerësimi i mjedisit mbështetet tek treguesit mjedisorë. Treguesit janë përbërës mjedisorë të domosdoshëm që përdoren për vlerësimin e prirjeve mjedisore, të dukurive të caktuara, ndjekjen në vazhdimësi, arritjet lidhur me përmbushjen e objektivave apo afatet e vendosura. Ato gjithashtu shërbejnë për të vlerësuar efektivitetin e politikave mjedisore të caktuara dhe bërjen publike të dukurive mjedisore, për gjithë publikun jo teknik dhe të përfshirë në këto procese.

Treguesit mjedisorë japin në mënyrë të përmbledhur dhe të thjeshtuar një kompleks të dhënash mjedisore. Ato shërbejnë si njësi matëse, në përgjithësi sasiore, që mund të përdoren më tej për të treguar e bërë me dije kompleksitetin e një dukurie mjedisore, duke përfshirë edhe prirjen dhe progresin e tij, kohë pas kohe, duke sjellë njohuri që lidhen edhe me pasqyrimin e gjendjes së mjedisit në përgjithësi dhe në tërësinë e tij (*burimi: AEM, 2005*). Treguesit kanë një rëndësi që shkon përtej vlerës së parametrut të lidhur direkt me të. Agjencia Evropiane e Mjedisit (AEM) është institucioni mjedisor më i rëndësishëm në

nivel evropian. AEM përdor një paketë treguesish mjedisore të dakordësuar mes vendeve anëtare, me qëllim hartimin e Raportit European të Gjendjes në Mjedis. Në këtë mënyrë, treguesit e publikuar nga AEM janë një ose disa grafikë me të dhëna të qarta, të cilat shoqërohen gjithmonë me interpretime dhe analiza në formën e vlerësimeve të politikave kryesore mjedisore, që ato pasqyrojnë. Kjo logjikë bën të mundur sigurimin e informacionit dhe udhëzimeve që lidhen me treguesit; kjo është ndihmë e madhe për nivelin e njohjes mjedisore, njohjen e gjendjes së mjedisit në vend, drejtuar veçanërisht për politikëbërësit, por jo vetëm.

Përpyekjet e para, për zhvillimin dhe konsolidimin e treguesve në nivel ndërkombëtar, janë bërë nga OECD në vitin 1990. Puna për hartimin e tyre përfshiu vendosjen e kriterëve të përgjithshme, ku duhet të mbështet përzgjedhja e treguesve. Këto kriterë u përdorën për përcaktimin e karakteristikave bazë të një treguesi mjedisor të mirë. Sipas kësaj logjike, një tregues duhet të jetë i konsoliduar dhe përfaqësues, ndërsa nga pikëpamja analitike, i shëndetshëm. Ndërkohë që, jo të gjithë treguesit e konsideruar si të 'konsoliduar' janë të mbështetur në të dhëna zyrtare statistikore. Ndjekja e parimeve statistikore në përcaktimin e një treguesi ka përfitimet e veta, pasi bën të mundur sigurimin e informacionit objektiv, të qëndrueshëm në kohë dhe përhapje gjeografike, duke ofruar përfaqësim të gjerë për gjithë vendet.

Treguesit përgjithësisht kombinohen në mënyrë të tillë, që të paraqiten në formën e një pakete, ku secili tregues ofron ose pasqyron një pjesë të pamjes së përgjithshme. Në këto paketa elementi 'tregues', paraqitet i veçuar dhe i mbështetur në veçoritë dhe karakteristikat e tij. Ato përmbushin dy funksione kryesore: a) zvogëlojnë numrin

e matjeve dhe parametrave që normalisht kërkohen për të bërë të njohur një situatë të caktuar, dhe b) lehtësojnë procesin e komunikimit nëpërmjet të cilit rezultatet e matjeve ju bëhen të ditura përdoruesve (OECD 2011). Përveç kësaj, treguesit ofrojnë një platformë, që ndihmon në strukturimin dhe stabilizimin e fluksit të të dhënave mjedisore. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në drejtim të politikëbërjes efektive dhe koherente. Nëpërmjet tyre sigurohet informacion i përzgjedhur, i kompletuar dhe i shoqëruar me interpretimet përkatëse që kanë për qëllim:

- 1-Dhënie informacioni të nevojshëm për probleme mjedisore të caktuara, me qëllim ndërgjegjësimin e politikëbërësve, që të reagojnë dhe marrin masat e nevojshme.
- 2-Krijim kushtesh të përshtatshme për nxitjen e reformave dhe politikave mjedisore, si dhe vendosjen e përparsive, duke nënvizuar faktorët kyç që ndikojnë në zinxhirin shkak-pasojë dhe efektet që ato kanë, duke bërë të mundur trajtimin e tyre nga politikëbërja me masa dhe vendimmarrje konkrete.
- 3-Matjen e arritjeve në drejtim të politikave dhe vlerësimin e efektivitetit të tyre.

Por, duhet pranuar se është mjaft e vështirë të monitorohet shkalla e ndikimit të politikave dhe instrumentave menaxhuese, nëse ajo nuk bëhet e lidhur me treguesit përkatës.

Sipas AEM, cikli politik për hartimin e një vendimmarrje të duhur dhe nevojshme duhet të kalojë në gjashtë faza (Fig. 3):

- 1-Njohja e shqetësimit;
- 2-Përkufizimi i shqetësimit;

3-Njohja e politikave që nevojiten për trajtimin e tij;

3-Përpilimi i politikave;

4-Zbatimi i politikave të hartuara;

5-Matja e ndikimit të këtyre politikave.




Figura 3.
Cikli politik për hartimin e një vendimmarrje të duhur sipas AEM

Treguesit në përgjithësi, përfshirë ato mjedisore luajnë secili rolin e tij, në të gjashtë fazat e ciklit politik (Fig. 1). Por më shpesh ato përdoren për monitorimin e progresit të bërë; kjo lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e politikave të ndërmarra dhe vlerësimin e efektivitetit të tyre në raport me të dhënat e përfuara si rezultat i tyre. Aty ku janë përcaktuar masat e tipit sasior të tilla, si: objektivat politike, kufijtë apo vlerat kufi, treguesit kanë luajtur e vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në matjen e progresit dhe cilësisë së politikave të caktuara mjedisore. Kjo ka shërbyer për

të matur 'largësinë nga kufiri', kalimin e kufirit, si dhe ndryshimet ndaj kushteve të referencës. Vendosja e kufijve, është ngushtësisht e lidhur me njohjen e pikave të duhura të referencës, dhe si rrjedhim të treguesve të duhur me qëllim monitorimin e performancës së tyre.

Përzgjedhja e treguesit bëhet në mënyrë të tillë që të kryejë dy funksione kryesore:

a-Të ulë në sa më shumë numrin e matjeve dhe parametrave që normalisht nevojiten për të paraqitur një situatë të caktuar mjedisore dhe

b-Të thjeshtojë sa më shumë rezultatet e matjeve në çastin e komunikimit të tyre te përdoruesit. Përveç kësaj ata ofrojnë një platformë që në thelb bën strukturimin dhe sistemimin e të dhënave.

Por, treguesit mjedisorë kanë edhe kufizimet e tyre dhe që duhet të merren parasysh në procesin e përzgjedhjes. Kjo sepse, jo gjithçka që shërben për të matur, mund të jetë e matshme. Treguesit nuk mund të sigurojnë një pamje të kuptueshme e të qartë mbi një çështje të caktuar mjedisore

nëse ato nuk mund të paraqesin arritjet (pra ndryshimet) dhe të sigurojnë informacion në lidhje me arsyet pse kjo apo ajo gjë ndodh. Ata kanë një përdorim të kufizuar nëse nxirren nga ky këndvështrim. Njëkohësisht në rastet kur nevojitet të bëhet një analizë më e thellë, atëherë nevojiten tregues të tjerë shtesë, me qëllim sigurimin e informacionit shtesë sasior dhe cilësor. Kriteret e përzgjedhjes së treguesve mjedisore jepen në tabelën 1.

<p>Rëndësia politike & shkalla e përdorimit të tyre</p>	<p>Treguesi mjedisor duhet të : a-Japë një pamje të plotë të kushteve mjedisore, presioneve dhe përgjigjes së shoqërisë ndaj tyre; b-Jetë i thjeshtë, e lehtësisht i interpretueshem, dhe të japë prirjet kohë pas kohe; c-T'u përgjigjet ndryshimeve të mjedisit të lidhura me aktivitetet njerëzore. d-Japë një bazë të nevojshme të dhënash, të nevojshme për të bërë krahasime në nivel kombëtar e ndërkombëtar; dh-Përbushë qëllimin në nivel kombëtar si dhe të jetë i aplikueshëm në nivel rajonal; e-Ketë një referencë me të cilën të krahasohet, kështu përdoruesit do të mund të gjykojnë domethënien e vlerësimit të bërë.</p>
<p>Qëndrueshmëria analitike</p>	<p>Treguesi mjedisor duhet të: a-Jetë teorikisht i mbështetur në terma teknike dhe shkencore. b-Krijojë lidhje me modelet ekonomike, parashikimet dhe sistemin e informacionit. c-Jetë i mbështetur në standarde e marrëveshje kombëtare/ndërkombëtare me rëndësi për njohjen dhe shkallën e vlefshmërisë së tyre.</p>
<p>Matshmëria</p>	<p>Të dhënat e nevojshme për treguesit mjedisore duhet të: a-Jenë në gjendje ose bëhen të gjendshme mbështetur në një vlerësim të arsyeshëm kosto-përfitim. b-Jenë të dokumentuara në mënyrën e duhur dhe me cilësi të çertifikuar. c-Rishihen vazhdimisht dhe në mënyrë të rregullt e mbështetur në procedura të besueshme.</p>

Tabela 1.

Kriteret e përzgjedhjes së treguesve mjedisore, sipas OECD

Shënim: Këto janë kriteret që një tregues ideal duhet të përmbushë, por në realitet jo të gjithë mund të përmbushen.



Treguesit mjedisorë, përgjithësisht përdoren për të raportuar zhvillime të caktuara, që kanë ndodhur në të kaluarën si dhe të sigurojnë historikun e tyre kohë pas kohe. Afatet kohore të treguesve ndikojnë mbi aspektin politik duke çuar në një dëshirë e nevojë në rritje, për të kryer si `vlerësime të hershme` ashtu edhe `të tashme` për dukuri mjedisore të caktuara. Megjithatë, numri i treguesve mjedisorë që shërbejnë për të përcaktuar prirjet në perspektivë, është ende i ulët, ndërkohë që shumë studiuues pranojnë se qëllimi i treguesve duhet të fokusohet tek dhënia e prirjeve të kaluara.

Çdo tregues mjedisor i analizuar në vetvete ka të mirat dhe të këqiat e veta. E rëndësishme është të merret parasysh kjo gjë; si dhe të shihet edhe mënyra se si treguesit mund të kombinohen dhe formojnë një paketë me qëllim që të mbulojnë sa më mirë dhe në gjithë shtrirjen e vet një çështje të caktuar mjedisore. Kjo, kërkon qartësi në lidhje me adresimin e drejtë dhe të saktë të çështjes që treguesi/t kanë marë përsipër të trajtojnë; në të kundërt, nëse ky kriter nuk zbatohet, atëherë rrezikohet që treguesi i përdorur të japë informacion jo të saktë dhe çorientues rreth çështjes që ka qenë objekt matjeje. Si shembull për këtë mund të merret një tregues që përdoret për të matur ndryshimet në periudhë afatgjatë, ndërkohë që politikëbërjes mund t'i nevojiten ndryshimet e bëra në periudhë afatshkurtër.

Një kriter tjetër i rëndësishëm që kihet parasysh kur përzgjidhen treguesit mjedisorë, është prania e të dhënave; p.sh shtrirja e tyre në kohë (prania e të dhënave që mbulojnë periudha kohore të ndryshme) dhe në hapësirë gjeografike. Megjithatë, vetëm prania e të dhënave, si kriter i veçuar, nuk mund të jetë përcaktues për procesin e përzgjedhjes së treguesve. P.sh në rastin e një

treguesi të rëndësishëm për aspektin politik, mund të pranohet edhe sasia e pakët e të dhënave, ndërkohë që për një tregues tjetër për të cilin aspekti politik është më pak i ndjeshëm, atëherë sasia e të dhënave këtu duhet të jetë e më e madhe.

Përdorimi i një kuadri bindës, me qëllim njohjen dhe përzgjedhjen e treguesve, për një çështje që lidhet me politikat mjedisore ose vlerësimin mjedisor, mund të ndihmojë në tejkalimin e disa kufizimeve, që kanë treguesit e veçantë ose të shkëputur. Kuadri bindës, mund të sigurojë një proces të arsyeshëm të përzgjedhjes së treguesve mjedisorë, duke bërë të mundur sigurimin e mbulimit të gjithë aspekteve të rëndësishme të një çështje të caktuar, si dhe marrëdhënien mes tyre. Kjo, mund të ndihmojë gjithashtu në kufizimin e numrit të treguesve, gjë që përbën një përfitim mjaft të rëndësishëm; kjo sepse mund të ndodhë që një paketë treguesish, që përmban shumë të tillë brenda tij, mund të shkaktojë vështirësi interpretimi të theksuara. I tillë është kuadri analitik i metodologjisë DPSIR, i cili ndihmon në qartësimin e qëllimit të një vlerësimi të bërë, si dhe përcaktimin e shkallës së mundësisë së një vlerësimi të integruar të faktorëve shkak-pasojë, ose ngushtësisht të fokusuar; si p.sh tek përshkrimet e thjeshta të gjendjes së mjedisit.

3.2.2 Kriteret e përzgjedhjes së treguesve mjedisorë sipas metodologjisë DPSIR⁹

Në Shqipëri, përcaktimi i treguesve mjedisorë që janë objekt monitorimi dhe mbi të cilët bëhet vlerësimi mjedisor është tërësisht atribut i akteve dhe dokumenteve ligjore të hartuara dhe miratuara nga institucionet përgjegjëse në vend, të

⁹ (DPSIR-D-Forcat Shtytëse, P-Prisionet, S-Gjendja, I-Impakti/Ndikimi, R-Përgjigjet)

përmendur në fillim të këtij studimi. Nga sa është pohuar edhe më lart, vitet e fundit shumë prej tyre kanë qenë objekt rishikimesh e amendimesh të vazhdueshme me qëllim përafrimin sa më shumë me legjislacionin dhe kërkesat që vijnë nga institucionet ndërkombëtare dhe BE ku Shqipëria ka detyrime raportimi. Megjithatë duhet theksuar fakti që disa nga këto akte ligjore rishtazi të përafuara duhet edhe të fillojnë të zbatohen, çka përbën edhe sfidën e madhe me të cilën do të duhet të përballen institucionet. Disave prej tyre u është lënë një periudhë tranzitore deri në fillimin e zbatimit të tyre. Kjo periudhë duhet të shfrytëzohet në fakt nga autoritetet, bizneset dhe aktorët e tjerë të përfshirë, për t'u informuar dhe për t'i kuptuar ato, e më tej për të marrë masat e nevojshme institucionale dhe ngritur kapacitetet e duhura për zbatimin e tyre në të ardhmen e afërt.

Treguesit mjedisorë, që vendi ynë monitoron në kuadër të vlerësimit të gjendjes në mjedis, janë të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi të përmendura më herët në këtë studim. Ky vendim ka hyrë në fuqi në fund të vitit 2009 (VKM nr. 1189/2009) dhe ofron zgjidhjen për ngritjen e një sistemi kombëtar monitorimi në përputhje me 'kontekstin politik' të vendit në atë kohë. Ai përcakton edhe listën e treguesve mjedisorë të ndarë në tre kategori të cilët vazhdojnë të përdoren edhe sot për hartimin e PKMM, mbi të cilin harrohet RGjMSh.

Ndarja e treguesve mjedisorë në Shqipëri është bërë duke u mundur të respektojë metodologjinë DPSIR të përdorur gjerësisht në nivel evropian dhe nga vendet anëtare të BE në nivelet e tyre kombëtare për hartimin e vlerësimeve të tyre mjedisorë. DPSIR në vetvete është një metodë që u projektua me qëllim strukturimin e procesit të përzgjedhjes së treguesve mjedisorë dhe kryerjes së vlerësimeve mjedisorë, të bazuar tek treguesit, duke integruar në këto procese, ndërveprimin e

aktiviteteve apo faktorëve më karakter social-ekonomik me ato me karakter mjedisor. Në këtë kuadër, zhvillimet shoqërore dhe ekonomike (D-Forcat vepruese) udhëheqin ndryshimet, që shkaktojnë presione (P-Presionet) në mjedis. Si pasojë, ndryshimet shfaqen edhe tek gjendja (S- Gjendja) e mjedisit, e cila shkakton ndikime (I-Ndikim) tek funksionimi i ekosistemeve, tek shëndeti i njeriut dhe në zhvillimet ekonomike. Në fund të këtij zinxhiri, vërehen edhe përgjigjet (R-Përgjigjet) që janë masat me karakter shoqëror dhe politik, e që ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në mjedis, apo pjesë të caktuara të tij. Nga një këndvështrim politik, vërehet një nevojë e qartë për tregues mjedisorë të tillë, që të mund të përfaqësonin gjithë hallkat e këtij zinxhiri.

Treguesit e forcave vepruese (D-Drivers), shërbejnë për të përshkruar zhvillimet ose sektorët me karakter social, demografik dhe ekonomik të një shoqërie, dhe njëkohësisht edhe ndryshimet që lidhen me mënyrën e jetesës dhe me nivelin e përgjithshëm të konsumit dhe prodhimit etj.

Treguesit e presioneve (P-Pressure), përshkruajnë zhvillimet ekonomike që kanë të bëjnë me shkarkimet e lëndëve të ndryshme ndotëse (p.sh. shkarkimet në ajër ose ujë), agentët fizikë dhe biologjikë, përdorimi i burimeve natyrore dhe tokave etj. Shembuj të përdorur sot për këtë janë sektorë të tillë ekonomikë dhe përdorimit të tokës, si të zhvillimit urban, bujqësor, trafiku, etj., prej të cilëve mund të ndodhin shkarkime të CO₂ (dyoksid karboni), pluhra, dhe ndotës të tjerë.

Treguesit e gjendjes (S-State), japin një përshkrim sasior dhe cilësor të përbërësve me natyrë fizike, kimike dhe biologjike të dukurive mjedisorë të caktuara, me ndikim në mjedis dhe të ushtruara në zona të caktuara. Shembujt për këtë, përfshijnë: tempera-

turën mesatare globale, larminë e specieve, apo përqendrimin e CO₂ në ajër.

Treguesit e ndikimit (I-Impacts), përshkruajnë rëndësinë e ndryshimeve të ndodhura në gjendjen e mjedisit, si dhe pasojat e shkaktuara për ekosistemet, ekonominë, mirëqënien dhe shëndetin e njeriut. Shembuj të ndryshëm, përfshijnë përqindjen e popullsisë së ekspozuar ndaj niveleve të larta ose të lejuara të zhurmave, të grimcave në ajër etj.

Treguesit e përgjigjes (R-Response), janë të lidhura me përgjigjet që vijnë nga shoqëria apo politikëbërja. Këto janë masa që synojnë të parandalojnë, kompensojnë, përmirësojnë ose përshtatin ndryshimet e ndodhura në gjendjen e mjedisit. Shembuj që kanë lidhje me këtë janë përpjekjet e bëra për mjedisin apo treguesit për normat e përpunimit apo riciklimit të mbetjeve urbane, të ngurta apo të lëngëta. Treguesit, mund të përdoren edhe

për të lidhur elementët e DPSIR me tregues të përshtatshëm, duke përshkruar ndërveprimin midis forcave shtytëse, presioneve dhe përgjigjeve (Fig 2). Ky lloj informacioni, ndihmon më së shumti edhe në dhënien e përgjigjeve, për çështje me karakter politik, të tilla si: A jemi duke e trajtuar me kujdes dhe pa i ndarë nga njëra-tjetra, çështjen e përdorimit të burimeve dhe presioneve mjedisore nga rritja ekonomike; si dhe dhënien e informacionit të nevojshëm mbi zhvillimet politike dhe zbatimin e tyre.

Në një vlerësim të përgjithshëm, DPSIR përdoret gjithashtu nga AEM edhe me qëllim konfigurimin e vlerësimit mjedisor, si një proces mjaft i rëndësishëm i mbështetur tek treguesit, përzgjedhjen e treguesve, si dhe komunikimin e rezultateve. Kjo është një skemë në përputhje të plotë me ato të përdorura nga organizata të tjera në nivel ndërkombëtar, si OECD dhe UN (Fig. 4).




Figura 4. Treguesit dhe informacionet e lidhura me metodologjinë DPSIR

Sot treguesit mjedisorë në Shqipëri ndahen në kategoritë e pasqyruara në tabelën 2:

TREGUESIT	Numri përbërsave për çdo tregues
GJENDJE (S)	
1-Ndryshimet klimatike	4
2-Precipitimet atmosferike	4
3-Ajri urban	10
4-Ujërat sipërfaqësor	13
5-Detet dhe bregdetet	11
6-Ujërat nëntokësorë	6
7-Ujërat me burime të fuqishme të ndotjes industrial e bujqësore	3
8-Biodiversiteti	11
9-Pyjet	15
10-Kullotat	7
11-Bimët Aromatiko Mjekësore	6
12-Tokat	3
13-Tokat me burime të ndotjes industriale	2
14-Ujërat për ujitje	5
NDIKIMI (I)	
1-Ndryshimet klimatike	2
2-Për dukuritë e aciditetit të mjedisit	1
3-Ujërat sipërfaqësorë	4
4-Për cilësinë e detit dhe bregdetit	5
5-Për ujërat nëntokësorë	4
6-Biodiversiteti	7
7-Për tokën dhe ujërat për vaditje	9
PRESIONI (P)	
1-Për ndryshimet klimatike	2
2-Për ajrin urban	5
3-Për mbetjet e ngurta	4
4-Për shkarkimet e lëngëta urbane	2
5-Për shkarkimet e ngurta industriale dhe inerte	5
6-Për shkarkimet e lëngëta industriale	3
7-Për burimet e ndotjes shkarkuese në ajër	2
8-Sasia vjetore e plehrave kimike	1
9-Sasia vjetore e kimikateve të rrezikshme të importuara	1
10-Ujërat sipërfaqësore	1
11-Ujratë nëntokësore	2
Gjithsej	160

Tabela 2.

Klasifikimi treguesve mjedisorë në Shqipëri sipas DPSIR (burimi: VKM nr. 1189/2009, Aneksi I si dhe PKMM)

Si shihet, kuadri ligjor shqiptar, për treguesit mjedisorë nuk është ndërtuar plotësisht në përputhje me standardet e përdorura nga institucionet mjedisore evropiane. Në këtë mënyrë, sistemi i treguesve mjedisorë është i organizuar vetëm në tre kategori, ndërkohë që ai evropian është i organizuar në pesë të tilla, mbështetur në skemën DPSIR. Ndërkohë, disa nga treguesit e gjendjes (S) janë konsideruar sot si tregues të përgjigjes (R). Ka mungesë totale të treguesve, që përfaqësojnë forcat vepruese (D). Këta tregues, së bashku me ata të përgjigjes (R) janë mjaft të rëndësishëm, sepse ata përmbajnë informacion rreth pasojave ose përfitimeve që vijnë nga zhvillimet dhe progresi i lidhur me politikat mjedisore të ndërmarra nga politikëbërja në Shqipëri. Këta tregues, duhet me patjetër të jenë të përfshirë në skemën e treguesve mjedisorë shqiptarë, me qëllim përmirësimin e monitorimit të mjedisit. Gjithashtu, ka një trajtim mjaft të përgjithshëm të praktikave koordinuese dhe atyre të menaxhimit të monitorimit të treguesve mjedisorë në Shqipëri, duke bërë që të ketë paqartësi në lidhje me përcaktimin e qartë të përgjegjësisve dhe detyrave që çdo institucion ka. Kjo çënon në mënyrë domethënëse rezultatin dhe cilësinë e monitorimit në vetvete, por njëkohësisht edhe të etapave të tjera të lidhura më të: analiza dhe vlerësimi mjedisor si dhe raportimi.

Në përgjithësi monitorimi në Shqipëri, vuan nga mungesa e procedurave që kanë të bëjnë me Sigurimin e Cilësisë (QA-*Quality Assurance*) dhe Kontrollin e Cilësisë (QC-*Quality Control*), si dhe mungesë të përfshirjes dhe përdorimit të teknikave të GIS, në përpunimin dhe analizat e informacionit mjedisor të grumbulluar nga proceset monitoruese. Treguesit mjedisorë në Shqipëri, mund të thuhet që mbulojnë

gjithë tematikat mjedisore kryesore të përfshira edhe në politikat mjedisore aktuale në vend. Megjithatë dhe pavarësisht kësaj, ka nevojë sot për rishikimin dhe rifreksimin e tyre, në përputhje me tematikat dhe politikat e reja, të konsideruara së fundi si me përparsi në vend dhe më gjerë, të tilla si: 'Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike', 'Efiçenca Energjitike dhe RES'¹⁰, Strategjia Detare etj.

3.2.3 Situata e treguesve mjedisorë: tematika dhe problematikat

Në mënyrë analitike, nëse do të bënim një vlerësim të përgjithshëm të treguesve mjedisorë që ka sot për çdo fushë dhe shkallës së përafrimit të tyre më atë të BE-së, do të kishim një situatë të tillë:

Treguesit *mjedisorë të ajrit*, përfshirje në mënyrë të kënaqshme të parametrave kryesorë të përcaktuar edhe nga Regullorja e BE për ajrin (Direktiva 2008/50/EC), përfshirë edhe monitorimin e rrezatimit.

Treguesit mjedisorë të ujërave (sipërfaqësore dhe nëntokësore) janë gjithashtu të mbuluar mirë nga parametrat përkatës që duhen monitoruar. Megjithatë, ka shumë parametra fiziko-kimikë, si dhe disa biologjikë të papërfshirë, duke bërë kështu që të mungojnë treguesit e përparuar, të cilët do të ndihmonin në sigurimin e një panorame të plotë të gjendjes dhe vlerësimit të mjedisit në Shqipëri.

Sa i përket treguesve të *biodiversitetit*, zgjedhja e tyre nuk paraqitet shumë e balancuar. Ka mbizotërim të treguesve të shendetit në pyje, gjë që lidhet me rëndësinë ekonomike të pyjeve dhe burimeve që

¹⁰ Renewable Energy System/ Zbutja e efekteve të Ndryshimeve Klimatike

ato ofrojnë për ekonominë shqiptare. Ndërsa, sa i takon treguesve të 'florës', 'faunës', 'habitave' dhe 'zonave të mbrojtura' janë të përfshirë në mënyrë më të përgjithësuar. Këto mangësi reflektojnë situatën dhe kushtet ende të papërshtatshme, të periudhës kur kjo listë, që ende sot vazhdon të jetë në fuqi, u hartua. Qysh atëherë, kanë ndodhur një seri zhvillimesh dhe ka pasur progres në lidhje me politikat mjedisore dhe qasjen e shoqërisë shqiptare ndaj këtyre problematikave. Ripërcaktimi i treguesve mjedisorë të biodiversitetit, përbën sot një përparsi me qëllim që të sigurojë një pasqyrë të plotë e të qartë të statusit ekologjik të Zonave të Mbrojtura dhe specieve në Shqipëri.

Në fushën e *menaxhimit të mbetjeve*, ka një mungesë të treguesve, që do të ndihmonin në mbulimin e monitorimit në përputhje me Direktivën e BE 2008/98/BE-së. Në mënyrë më veçantë, treguesit e matjes së uljes së vëllimit të mbetjeve, riciklimit dhe ripërdorimit të mbetjeve dhe trajtimit të mbetjeve të veçanta (p.sh. mbetjet spitalore), të cilat nuk janë përfshirë.

Në një vlerësim të përgjithshëm bërë mbi paketën e treguesve mjedisorë, rezulton se mangësia kryesore në lidhje me përcaktimin e tyre, ka të bëjë me qasjen e përgjithshme të zbatuar në Shqipëri për treguesit e të përdorur. Sipas kësaj qasjeje, përkufizimi i treguesit mjedisor nuk ka përfshirë e marrë parasysh edhe dimensionin e 'përdorimit' sikundër përkufizohet dhe përskruhet nga AEM: *si një matës, përgjithësisht sasior, që mund të përdoret me qëllim ilustrimin dhe komunikimin e kompleksitetit të dukurive mjedisore në mënyrë të thjeshtë, duke përfshirë prirjet, dhe progresin e bërë kohë pas kohe, të cilat ndihmojnë në sigurimin e informacionit për përcaktimin dhe vlerësimin e gjendjes së mjedisit (AEM 2005).*

Sot, në paketën e treguesve mjedisorë shqiptarë, ka shumë prej tyre, që shërbejnë për të monitoruar parametrat 'shkencorë', mjaft të rëndësishëm për studime shkencore, por që ofrojnë një përdorim mjaft të kufizuar për politikëbërjen dhe publikun. Kjo gjë çon në mungesën e lehtësive të komunikimit të këtyre treguesve tek publiku, si p.sh. 'cilësia e ujërave larës'. Edhe pse në listën e treguesve mjedisorë, përfshihet monitorimi i gjithë parametrave mikrobiologjikë që përdoren për këtë tregues, vlerësimi gjendjes bëhet i vështirë dhe mjaft teknik, pasi edhe parametrat e monitoruar janë të tillë dhe nuk mund të interpretohen lehtësisht nga të gjithë, por vetëm nga grupe të caktuara njerëzish, që kanë ekspertizën e duhur. E kundërta ndodh me treguesit mjedisorë të AEM. Kjo e fundit përdor kryesisht tregues të përbërë të mbështetur në parametrat fiziko-kimikë, por me qëllim ofrimin e një pamje sa më të plotë për publikun, dhe ndërgjegjësimin e tij, si dhe 'politikëbërjen'. Kjo përmbush në këtë mënyrë edhe misionin kryesor të treguesve mjedisorë, atë të 'një mjeti që përdoret për të ilustruar dhe komunikuar dukuritë e ndërlikuara mjedisore në mënyrë të thjeshtë...'. Në kushtet e realiteteve mjedisore të ndryshueshme, përdorimi i një liste të paracaktuar, pjesë e paketës së treguesve mjedisorë, e vështirëson suksesin e misionit që ata kanë, duke e bërë të vështirë pasqyrimin e këtyre dukurive mjedisore të reja dhe përfshirjen e tyre në një listë të paracaktuar me një akt ligjor, në çastin dhe kohën e duhur. Kjo vetëvetiu çon edhe në zbehjen e rolit dhe misionit të tyre.

Gjithsesi, vlerësohet se e vetmja e fortë e paketës së treguesve mjedisorë në Shqipëri, ka të bëjë me faktin, që ajo nuk vendos ndonjë pengesë apo mospërputhje lidhur me Kuadrin Evropian të Politikave Mjedisore, duke lënë të hapur përshtatjet e nevo-

jshme në këtë drejtim dhe sa herë ato nevojiten. Mbështetur në mënyrën e ndërtimit dhe konceptimit të kësaj pakete, dhe tek kapacitetet ekzistuese monitoruese dhe administrative, pa bërë një rivlerësim të kontributit dhe përgjegjësi të partnerëve të përfshirë, duke përdorur praktikat aktuale dhe institucionet aktuale bashkëpunuese, për monitorimin e treguesve mjedisorë, me gjithë të mirat dhe mangësitë e tyre, mund të arrihet në përfundimin, se kjo paketë treguesish mjedisorë, rezultojnë të jetë më shumë `realiste` sesa `ambicioze` apo `inovative`. Ajo që është gjithashtu e rëndësishme, ka të bëjë me faktin që ajo është krijuar mbi parimet themelore, mbi të cilat është ngritur dhe funksionon sot Evropa dhe institucionet e saj: detyrimi për të informuar publikun si dhe nevoja e harmonizimit të politikave evropiane (*acquis communautaire*) në nivel kombëtar si një hap i rëndësishëm, drejt përfshirjes së vendit dhe institucioneve në sistemin evropian. Megjithatë duhet theksuar gjithashtu fakti që nevojitet rishikimi dhe rihartimi i një pakete treguesish mjedisorë në nivel kombëtar që të pasqyrojnë përparsitë e politikave mjedisore sot në Shqipëri dhe të atyre të BE, mbështetur në metodologjitë e përdorura sot gjerësisht. Vetëm duke ndjekur këto modele do të mund të ketë një vlerësim të gjendjes së mjedisit në vend në përputhje me standardet e BE, dhe mesazhe të qarta e të kuptueshme në lidhje me të, jo vetëm për politikëbërjen, por edhe për publikun e gjerë.

Si përfundim, mund të konfirmohet fakti që Raporti Vjetor i Gjendjes në mjedis që hartohet çdo vit mbi bazën e treguesve mjedisorë të sipërpërmendur, nuk pasqyron në tërësinë e tij vlerësime të kryera në përputhje me zinxhirin e plotë konceptual mbi të cilin klasifikohen treguesit mjedisorë sot në Evropë. Kjo e bën këtë raport jo

të plotë dhe të cunguar sa i takon shkallës së përfaqësimit të gjithë treguesve mjedisorë të aplikuar gjerësisht. Njëkohësisht kjo e bën të vështirë lidhjen midis gjetjeve të RGjMSh dhe politikave mjedisore kombëtare dhe matjes së efikasitetit të tyre. Kjo bën që raporti të mos përmbushë misionin e tij kryesor dhe veçanërisht të mos ofrojë informacion të plotë dhe të kuptueshëm për publikun e gjerë. Në raport mungojnë thujtja tërësisht vlerësime dhe analiza të integruara me të dhëna dhe informacioni që vjen jo vetëm nga monitorimi i treguesve mjedisorë, por njëkohësisht dhe nga ai që duhet të furnizohet, nga subjektet e operatorët privatë, që janë objekt i e lejeve mjedisore në nivel vendor dhe problematikat e aktivitetit që ata ushtrojnë.

3.3 Vlerësimi i aktivitetit të monitorimit të gjendjes së mjedisit në Shqipëri

Monitorimi i mjedisit, është një program periodik studimesh sistematike, të cilat bëjnë të mundur njohjen e gjendjes së mjedisit. Aspekte të veçanta të mjedisit, që për arsye të ndryshme nevojitet të studiohen, përcaktohen në përputhje me objektivat mjedisorë dhe legjisllacionin mjedisor në fuqi. Synimi i monitorimit të mjedisit, është që të vlerësojë progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara si dhe të ndihmojë në identifikimin dhe adresimin e çështjeve të reja mjedisore, që kërkojnë vëmendje. Rezultatet e monitorimit, janë të një rëndësie të veçantë për menaxhimin në tërësi të mjedisit, si dhe përgatitjen dhe prioritarizimin e politikave mjedisore, të mbështetura në gjetjet dhe rezultatet e monitorimit mjedisor. Ky i fundit luan rol vendimtar në hartimin e Raporteve të Gjendjes në Mjedis. Nëse do të bënim një vlerësim paralel të raporteve

të tilla në nivel evropian rezulton se këto raporte pasqyrojnë më së miri axhendën evropiane në fushën e mjedisit, e cila lidhet jo vetëm më çështjet e mjedisit, por edhe me ato të klimës, këto të përputhura edhe me faktorët socio-ekonomikë. Kjo qasje bën të mundur që RGJM të jetë burimi kryesor i informacionit, mbi mënyrën sesi Evropa po ecën drejt objektivave të vitit 2020, dhe se si ajo do të duhet të punojë në drejtim të hartimit të udhërrëfyesve të nevojshëm, drejt zbatimit të objektivave afatgjatë (2020- 2050) dhe nxitjes së tranzicionit drejt një shoqërie më të përshtatur dhe përgatitur në rrugën drejt ekonomisë së gjelbër dhe asaj të *'karbonit të ulët'*, e përshtatshme në përdorimin e burimeve dhe të ekosistemeve ripërtëritëse.

Këto raporte, synojnë gjithashtu, të venë në pah faktin, nëse këto objektiva janë të lidhur me faktorë të tillë, si biodiversiteti, klima dhe energjia ose edhe më tej, me çështjet e lidhura me ekonominë e gjelbër, për të cilën gjithnjë e me shumë po flitet sot në Evropë si një nga drejtimet (i dyti) strategjike. Problematikat e hershme, më të cilat po përballet sot shoqëria njerëzore, të tilla si ndotja e ajrit, ndryshimet klimatike dhe pasojat e tyre, si dhe rënia dhe dëmtimi i biodiversitetit, janë të gjitha të lidhura me njëra-tjetrën dhe nuk mund të trajtohen në mënyrë të ndarë. Ajo që i lidh këto problematika, janë sistemet socio-ekonomike, të cilat na ndihmojnë që të sigurohemi mbi atë se çfarë duhet të presim, që të ndodhë në shoqërinë moderne: sistemet e transportit, strehimi, sistemet e energjisë, të ushqimit, etj. Tranzicioni në të cilin kanë hyrë këto sisteme sociale, do të duhet të vendoset në një trajektore të besueshme drejt vitit 2050 dhe të trajtohet si e tillë. Sigurisht që ky këndvështrim e qasje, për mënyrën sesi duhet të zhvillohet aktiviteti i monitorimit të gjendjes në mjedis mbi të cilin do të

ngrihet më tej vlerësimi mjedisor, si pjesë e hartimit të raporteve mjedisore është mjaft sfidues dhe ka karakter jo vetëm shkencor duke i shërbyer sistemit të njohurive mjedisore të nevojshme, por ka edhe karakter shoqëror. Është kjo një arsye më shumë pse nevojitet një rrjet i bazuar tek qasja e bashkëpunimit të ngushtë, me qëllim përbushjen e misionit të saj; ngritjes së një baze të dhënash dhe njohurish në nivel kombëtar, të bazuar tek të dhënat e siguruar në mënyrë të vazhdueshme dhe të sigurta, tek treguesit mjedisorë të hartuar në përputhje të plotë me politikat mjedisore kombëtare, si dhe raportimin mbi një paketë të qartë dhe kuptueshme të tematikave mjedisore prioritare, sot në Shqipëri dhe në një pjesë të mirë të tyre të përafëruara me ato mjedisore Evropiane.

Qëllimi i RGJM-së është që, ndër të tjera të krijojë një shkallë të lartë të të kuptuarit të fenomeneve mjedisore dhe të klimës, në mbarë vendin dhe duke i parë këto edhe në dritën e zhvillimeve mjedisore sot në mbarë botën. Ky proces, është i lidhur pikë së pari me sfidat mjedisore me të cilat shoqëria po përballet sot, të cilat në thelb nuk është se janë shumë të ndryshme, nga ato të një dekade më parë. Kështu, ndryshimet klimatike, humbja e biodiversitetit, përdorimi i paqëndrueshëm i burimeve natyrore si dhe presionet e shkaktuara nga mjedisi tek shëndeti njeriut, duhet të jenë në thelb dhe fokus të programit të punës së hartimit të RGJM-së dhe zhvillimit të aktiviteteve monitoruese dhe vlerësim-it të gjendjes së mjedisit, si në dekadën e kaluar, ashtu edhe tani. Ndërkohë që, shumë sfida me natyrë mjedisore, të lidhura me klimën, shoqëruar këto edhe me një forcim të lidhjes mes sfidave dhe rolit të tyre ndërveprues nga njëra anë, me një numër të madh të atyre që sot njihen si *'mega- trendet globale mjedisore'*, të



gjitha këto duke synuar drejt gjetjes së zgjidhjeve, kryerjes së analizave dhe dhënies së përgjigjeve, ndaj problematikave mjedisore, ngelen ende pa përgjigje dhe larg pritshmërive dhe ende të patrajtuara e papërfshira në programet kombëtare të monitorimit të gjendjes në mjedis.

Objektivi kryesor i politikëbërësve kombëtarë, sikundër dhe atyre evropianë, duhet të jetë përshpejtimi i kontributit të politikave mjedisore drejt qëndrueshmërisë, të kuptuarit mbi burimet efçente, ekonominë e karbonit të ulët, në të cilën kapitali natyror mbrohet dhe forcohet, si dhe sigurimin e shëndetit dhe mirëqënies së qytetarëve, i cili duhet të ruhet dhe mbrohet me fanatizëm. Në programin kombëtar të monitorimit të gjendjes së mjedisit duhet të përfshihen prioritetet mjedisore kombëtare të cilat reflektojnë gjithashtu edhe axhendën e konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare ku Shqipëria aderon si p. sh. 'Rio 2020', Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), Protokollit Montrealit, Konventa e Diversitetit Biologjik (CBD) si dhe një sërë aktivitetesh në nivel evropian, të cilat po rriten gjithmonë e më shumë dhe janë vendosur në perspektiva afatgjata (2050). Progresi drejt këtyre objektivave, duhet të monitorohet vazhdimisht dhe në mënyrë konsistente, nga ana e institucioneve shqiptare, gjë që duhet bërë nëpërmjet mekanizmave të saj, të ngritura për këtë qëllim. Këto mekanizma, mbështeten dhe funksionojnë, duke u mbështetur tek treguesit mjedisorë dhe monitorimi i tyre. Këta tregues, monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme progresin drejt një shoqërie dhe ekonomie të rregullt, si rezultat i politikave të ndërmarra dhe zbatimit të tyre nga ana e vendit tonë dhe gjithnjë në përpjekje për t'u anëtarësuar. Por njëkohësisht, ato shërbe-

jnë edhe për të matur e vlerësuar, cilësinë dhe gjendjen e mjedisit, të mbështetur tek treguesit mjedisorë dhe monitorimi i tyre në nivel kombëtar.

Mbështetur në këto monitorime, përgatiten raportet e gjendjes së mjedisit, të cilët duhet të ofrojnë një vlerësim dhe njohje të bazës së nevojshme të njohurive dhe informacionit mjedisor të grumbulluar nga procesi i monitorimit, me qëllim vlerësimin mbi gjendjen e mjedisit në vend dhe ofrimin e informacionit mbi zbatimin dhe efektivitetin e politikave mjedisore sot. Raportet e Gjendjes së Mjedisit, si në nivel evropian, ashtu edhe ato në nivel kombëtar, duhet të japin ndihmesë të vyer, mbi njohjen e gjendjes së mjedisit, të mbështetur tek treguesit mjedisorë. Njëkohësisht, ato ndihmojnë edhe në drejtim të mbivendosjes, fuqizimit dhe forcimit në të ardhmen, të lidhura me objektivat afatgjata, në punën e çdo vendi, duke vepruar mbi qasje dhe metodologji të përbashkëta të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mjedisit.

3.3.1 **Kuadri konceptual MDIAK¹¹ dhe zbatimi i tij në kontekstin shqiptar**

Roli dhe misioni i një raporti të gjendjes së mjedisit është pikërisht të mbështesë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Ai duhet të ndihmojnë në arkivimin e përmirësimeve të dukshme dhe të matshme të mjedisit në vend, nëpërmjet informacionit dhe rekomandimeve të dhëna në kohën e duhur, mbi tematikat e duhura dhe të bazuara në informacione dhe vlerësime mjedisore të besueshme dhe të sakta, të siguruar nga

¹¹ <https://pdfs.semanticscholar.org/presentation/4fef/4f499469549940dfaba4ce57da56311b4c84.pdf>

procese të bazuara në metodologjitë dhe standardet e përdorura, prej institucioneve përgjegjëse për këtë. Për këtë qëllim, nevojitet një bashkëpunim dhe bashkëveprim kompleks mes institucioneve të niveleve të ndryshme, aktorëve të ndryshëm qeverisës në nivel kombëtar dhe vendor njëkohësisht. Këto funksione duhet të përfshijnë gjithashtu edhe institucione kërkimore, biznese dhe OJF të ndryshme. Roli i veçantë i raportit është që të mbështesë politikëbërjen si dhe të ndërtojë kapacitetet e nevojshme në vend, duke përdorur rrjetin kombëtar të institucioneve dhe aktorëve që mund dhe duhet të japin ndihmesën e tyre për këtë qëllim. Nga këta duhet të sigurohen të dhëna dhe informacion mjedisor i besueshëm dhe i siguruar si rrjedhojë e përdorimit dhe zbatimit të standardeve e metodologjive të unifikuara dhe çertifikuara. Duke qenë se, mënyra e të menduarit dhe kuptuarit të sfidave mjedisore ka ndryshuar shumë sot në Evropë, veçanërisht në dhjetëvjeçarët e fundit, kjo ka sjellë edhe nevojën e përshtatjes ndaj këtyre ndryshimeve. Ato mund të pasqyrohen te `fluksi i të dhënave të grumbulluara` me qëllim hartimin e një raporti mjedisor, si dhe kryerjen e vlerësimit mjedisor të mbështetur tek këto të dhëna. Njëkohësisht këto shoqërohen edhe me pasqyrimin e tyre tek procesi që qëndron në themel të gjenerimit të këtyre të dhënave dhe informacioneve mjedisore nga ana e vendit, që është procesi i monitorimit të mjedisit. Ky gjithashtu duhet të përputhet me kërkesat dhe pritjet e vëna re, kohë pas kohe.

Duke parë gjithmonë përpara dhe vlerësuar sfidat mjedisore me të cilat po përballen sot vendet e Evropës, përfshirë edhe Shqipërinë ekziston një nevojë për të përshpejtuar procesin e përshtatjes së fluksit të informacionit dhe vlerësimit mjedisor si dhe monitorimit mjedisor. Kjo bëhet në përputhje me këto

objektiva tranzitorë afat mesëm-afatgjatë, duke përmirësuar dhe mirëmbajtur bazën e të dhënave dhe njohurive të grumbulluara, si dhe duke zhvilluar politika mjedisore, që duhet të kalojnë e trajtohen përmes ciklit politik. Kjo çon në nevojën e forcimit të bashkëpunimit mes aktorëve të politikës me ekspertët, veçanërisht ata që kanë të bëjnë me kryerjen e këtyre kërkimeve dhe monitorimeve, grumbullimin dhe vlerësimin e të dhënave dhe informacionit mjedisor, analizën tyre, për të shkuar më tej, tek ofrimi i gjendjes së mjedisit në tërësi dhe vlerësimit të politikave mjedisore të caktuara në veçanti. Vetëm një qasje e tillë, do të siguronte suksesin e proceseve të lidhura me punën për hartimin e RGjMSh që kanë të bëjnë me monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e të dhënave mjedisore. Ky përbën edhe një kusht të domosdoshëm, që synon shndërrimin e Raportit në:

- a- Një mjet që shërben si burimi i parë kombëtar i njohurive mjedisore, që informon mbi zbatimin e politikave mjedisore kombëtare, por njëkohësisht edhe atyre evropiane, ku aspirojmë të shkojmë;
- b- Të jetë instrumenti kryesor, që arrin të performojë në mënyrë të jashtëzakonshme, funksione që kanë të bëjnë me shkëmbimin dhe ndarjen e të dhënave, informacionit dhe njohurive mbi mjedisin, si dhe ndërtimin e kapaciteteve në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar;
- c- Informon mbi zbatimin e politikave mjedisore evropiane nga vendet, nëpërmjet ofrimit të informacionit mbi proceset politike mjedisore, objektivat e procesit të monitorimit të gjendjes së mjedisit, të bazuar tek treguesit mjedisorë, duke përfshirë edhe ato sektorë, që



janë burime kryesore të dhënash për presionet mjedisore, duke u bazuar fort dhe përdorur metodologjinë DPSIR;

d- Siguron gjendje, cilësi, akses dhe qëndrueshmëri të procesit të monitorimit të mjedisit, të dhënave të siguruara prej tij, dhe informacionit të nevojshëm, për të ngritur bazën e njohurive, duke u mbështetur tek politikat mjedisore dhe ato të klimës.

Kjo, ka të bëjë direkt me mirëmbajtjen dhe përmirësimin e efikasitetit të të dhënave ekzistuese, respektimit dhe kryerjen e proceseve të “Kontrollit të Cilësisë” dhe “Sigurimit të Cilësisë”, menaxhimit të treguesve mjedisorë dhe prodhimit të hartave dhe grafikëve, duke siguruar akses dhe shërbime në përputhje me politikat aktuale mjedisore. Këto procese kanë në themel të tyre aktivitetin e monitorimit të gjendjes së mjedisit, i cili siguron dhe ofron garancinë e suksesit, për proceset e sipërshënuara.

Procesi monitorimit të mjedisit, është hallka e parë bazë e procesit zinxhir MDIAK, që aplikohet sot gjerësisht në Evropë dhe vendet anëtare të saj, dhe që ndihmon në specifikimin dhe dallimin mes llojeve të ndryshme të informacionit, që nevojitet për hartimin e një raporti mjedisor. Kuadri MDIAK (Fig. 5), duhet t’u përgjigjet pyetjeve kyç, të lidhura me secilën hallkë të tij dhe finalizohet me hartimin e Raportit të Gjendjes në Mjedis:

M (Monitoring) - Monitorime direkt në vend, vëzhgime, vrojtime satelitore;

D (Data) - Të dhëna vendore, kombëtare, evropiane, globale;

I (Indicators) - Tregues, të dhëna mjedisore, informacion;

A (Assessments) - Vlerësime gjithëpërfshirëse të përshkallëzuara;

K (Knowledge, understanding, action) - Komuniteti dhe akademikët.




Figura 5. |
Mënyra e ndërveprimit të faktorëve brenda sistemit MDIAK.

Monitorimi i mjedisit (M), përgjithësisht përkufizohet si grumbullim, vlerësim dhe raportim i informacionit mjedisor, të siguruar nëpërmjet analizave periodike, vrojtimeve dhe analizave të ndryshimeve natyrore dhe presioneve me natyrë njerëzore si dhe ndikimeve të këtyre ndryshimeve tek njeriu dhe mjedisi. Sot, ndryshimi midis monitorimit të mjedisit dhe prodhimit të llojeve të tjera të informacionit mjedisor, është bërë gjithmonë e më i vogël. Mjaft të rëndësishme konsiderohen, sistemet e monitorimit të mjedisit, të cilat janë thelbësore për politikën mjedisore. Ato përbëjnë "syrin" dhe "veshin" për politikëbërësit, studiuesit dhe publikun, në përpjekjet e tyre për të kuptuar dhe përmirësuar cilësinë e mjedisit. Politikën mjedisore kombëtare, institucionet dhe mekanizmat e financimit sigurojnë mjedisin e nevojshëm për sistemet e monitorimit. Politikën kombëtare mjedisore, gjithashtu shërbejnë, për të përcaktuar qëllimet e sistemeve të monitorimit të mjedisit, në përputhje me përpjesitë e vendosura prej tyre. Përveç kësaj, sigurimi i informacionit të nevojshëm për politikën kombëtare mjedisore, përbën një nga objektivat themelore të sistemeve të monitorimit.

3.3.2 Parimet themelore të procesit të monitorimit të gjendjes së mjedisit

Procesi i monitorimit të mjedisit, është mjaft i rëndësishëm dhe si i tillë, duhet të jetë i planifikuar mjaft mirë dhe në përputhje, me objektiva të përcaktuara qartë, me qëllim shpërthimin e tyre të plotë deri në momentin final, të dhënies së rekomandimeve të bazuara tek vlerësime të sakta, të besueshme dhe në përputhje me standartet e kërkuara. Parimet themelore,

ku duhet të bazohet procesi i planifikimit të monitorimit janë:

- a- *Respektimi i kontekstit politik*, i cili ka të bëjë me faktin që monitorimi do të shërbejë si mjeti, nëpërmjet të cilit autoritetet kombëtare dhe vendimarrësit do të arrijnë objektivat e tyre, të lidhura me përmbushjen dhe hartimin e politikave mjedisore të qëndrueshme. Për këtë, nevojitet zgjedhja e treguesve mjedisore më të përshtatshëm, të cilët nga njëra anë, janë në përputhje me angazhimet e marra dhe nga ana tjetër përmbajnë informacione, që janë të nevojshme për politikëbërësit dhe mbështesin zbatimin e axhendave të tyre brenda dhe jashtë vendit.
- b- *Qëllimi*, i cili shërben për të lidhur me njëra-tjetrën, çështjet apo paqartësitë që kanë të bëjnë me atë se "çfarë jemi duke monitoruar" me atë se "si dhe për çfarë do ta përdorim këtë monitorim". Këtu, përdorimi i kuadreve logjike DPSIR dhe MDIAK do të ndihmonë shumë, për krijimin e lidhjeve të duhura.
- c- *Shkalla*, që do të shërbejë për të vendosur kufijtë, brenda të cilëve do të orientohen përpjekjet që do të nevojitet të bëhen në këtë kuadër.

Konteksti politik është mjaft i rëndësishëm për planifikimin e monitorimit. Monitorimi në vetvete, si përkufizim nënkupton një grumbullim sistematik të informacionit, duke ju mundësuar palëve të interesuara të kontrollojnë, nëse nisma e ndërmarrë është në rrugën e duhur dhe është duke përmbushur objektivat e vendosur. Konteksti politik është burimi kryesor, që përcakton këto objektiva. Një kontekst i gjerë i politikave mjedisore, shërben për të lidhur politikën mjedisore kombëtare me

kuadret e zhvillimit të qëndrueshëm, duke ofruar kështu guidat e nevojshme për të hartuar një proces monitorimi të përshtatshëm. Objektivat e përgjithshëm ose të veçantë, apo politikat që adresojnë zhvillimin e qëndrueshëm, mund të zbatohen dhe mund të përfshihen në një mandat për aktivitetin monitorues. Instrumenti politik kryesor që ekziston sot në Shqipëri, nëpërmjet të cilit mund të identifikohet konteksti politik, është VKM-ja e monitorimit të gjendjes në mjedis, veçanërisht e rëndësishme për monitorimin e atyre treguesve mjedisorë, e shoqëruar edhe nga një paketë e tërë aktesh ligjore mbi përbërësit mjedisorë, objekt detyrimesh monitorimi dhe raportimesh në kuadër të instrumentave ndërkombëtarë të miratuar nga Shqipëria, si në nivel evropian edhe Pan-Evropiane e më gjerë. Në këto akte ligjore vendosen objektivat parësorë të monitorimit, që në thelb kanë të bëjnë me implementimin efektiv të politikave kombëtare të mbrojtjes së mjedisit, sikundër përcaktohen edhe në ligjin aktual, për mbrojtjen e mjedisit¹². Përveç kësaj, aty parashikohet gjithashtu edhe shtrirja e sistemit kombëtar të monitorimit mjedisor, si një prej kërkesave që vjen nga institucionet e BE-së, por pa përcaktuar në mënyrë të qartë se cilat janë ato. Për këtë qëllim, do të duhej reflektimi në strategjitë e dokumentat ligjorë kombëtare edhe të objektivave dhe kërkesave, në kuadër të pranimit të Shqipërisë në BE dhe AEM (procese të lidhura me njëra-tjetrën), të cilat janë gjithashtu të lidhura edhe me përshtatjen dhe përputhjen e politikave të BE (*Acquis Communautaire*).

Parimet kryesore, që duhet të ndiqen për hartimin e një sistemi monitorimi kombëtar që të pasqyrojë përparsitë e mësipërme janë:

- Respektimi i linjës së përcaktuar qartësisht në dokumentat strategjike kombëtarë ligjore mbi monitorimin.
- Të asistojë autoritetet kombëtare dhe vendimarrësit me qëllim përmbushjen nga këta të fundit, të objektivave të lidhura me zhvillimin e qëndrueshëm, duke siguruar informacion të besueshëm, të qëndrueshëm dhe rifreskim të vazhdueshëm të tij, me qëllim vlerësimin e progresit dhe efektivitetit të lidhur me zbatimin e politikave mjedisore mbi mjedisin dhe cilësinë e tij.
- Nxitjen e menaxhimit përshtatës dhe rritjen e kapaciteteve të administratës.
- Përmbushjen e standardeve ndërkombëtare, si dhe sigurimin e informacionit, lehtësisht të kuptueshëm dhe të përdorshëm për inventaret ndërkombëtarë.
- Dhënies përparësi ndaj sektorëve mjedisorë të klasifikuar si të rëndësishëm dhe në përputhje me karakteristikat dhe axhendën kombëtare, për zhvillimin e qëndrueshëm.
- Përfshirjes dhe motivimit të operatorëve dhe publikut, si dhe nxitjen e ndërgjegjësimit të tyre mbi mjedisin.
- Ofrimi i një pamjeje të plotë të gjendjes së mjedisit, duke u fokusuar në çështje të caktuara, apo duke trajtuar në thellësi zona të caktuara me interes të veçantë.
- Përdorimi i kapaciteteve sot, si dhe njohuritë e përvetësuara më parë, pa kosto shtesë.

Qëllimi si përkufizim është i vendosur në qendër të sistemit të monitorimit. Në këtë pikë, është mjaft e rëndësishme të ketë një dakordësi të plotë, në lidhje me përcakim-

12 Ligji Nr. 10.431, 2011 'Për mbrojtjen e Mjedisit'

in e qartë të përkufizimit 'të qëllimit', si dhe mënyrës sesi është menduar, që të përdoren rezultatet e monitorimit, qysh në fazat e hershme të zhvillimit të sistemit të monitorimit. Pyetja kryesore, që shërben për të përcaktuar qëllimin, është sesi do të mund të lidhen më mirë me njëra - tjetrën pyetjet: 'çfarë monitorojmë' dhe 'si mendojmë t'i përdorim rezultatet e monitorimit'. Tre janë përdorimet kryesore të rezultateve të monitorimit: a- për të mësuar; b- për të vlerësuar; dhe c- për të menaxhuar.

Shkalla, identifikimi i niveleve të zbatimit dhe shkallës së grumbullimit të tyre, do të ndihmojë në përcaktimin e qëllimit të sistemit të monitorimit dhe sigurisë, që të gjithë aktorët, të jenë përfshirë në hartimin dhe zbatimin e tij. Niveli i zbatimit të sistemit, i referohet nivelit, në të cilin pritet të jenë rezultatet që do merren p.sh. nivel kombëtar, lokal etj. Niveli i zbatimit, mund të jetë i specifikuar, në mandatin që do t'i jepet sistemit të monitorimit, që synohet të hartohet.

3.3.3 Vlerësimi i infrastrukturës aktuale të monitorimit të gjendjes së mjedisit

Monitorimi i gjendjes së mjedisit në Shqipëri, bëhet në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar, i cili përcakton edhe institucionet përgjegjëse, të përfshira në performimin dhe kryerjen e këtij procesi. Në këto dokumente ligjore, përcaktohen edhe treguesit mjedisorë/komponentët dhe institucionet e ngarkuara për monitorimin e tyre, duke u bazuar çdo vit, tek Programi Kombëtar Monitorimit të Mjedisit (PKMM), i cili përfshin në mënyrë analitike gjithë elementet e nevo-

jshëm, për kryerjen e këtij aktiviteti: lista e treguesve mjedisorë që duhen monitoruar të ndarë sipas tematikës, metodologjitë që do të përdoren për monitorimin e secilit tregues dhe parametër, kostot përkatëse të monitorimit, institucionet e ngarkuara, mënyra e vlerësimit dhe menaxhimit të të dhënave, shoqëruar këto dhe në përputhje me Rrjetin Kombëtar të Monitorimit, për secilin komponent mjedisor kryesor (ajër, tokë, ujë, biodiversitet, pyje e vitet e fundit edhe zhurma). Kërkesat dhe standardet, mbi të cilat hartohet PKMM, janë në përputhje me ato të vendosura nga Direktivat e BE-së për fushat dhe komponentët përkatës: ajër, ujëra, toka, pyje dhe biodiversitet.

Një nga elementet më të rëndësishme të infrastrukturës së monitorimit në Shqipëri, është Rrjeti Kombëtar i Monitorimit, i cili është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor të zbatuar sot në Evropë. Rrjeti Kombëtar i Monitorimit për komponentët: ajër, ujëra, tokë dhe biodiversitet, është i përbërë nga një numër i caktuar stacionesh monitorimi të shpërndara sipas fushave përkatëse pasqyruar në hartën e mëposhtme (*ajër, ujëra sipërfaqësore, ujëra nëntokësore, biodiversitet*) (Fig. 4):




Figura 6.

Harta e rrjetit të monitorimit të mjedisit për vitin 2018 (PKMM, 2017)

Monitorimi i komponentëve mjedisorë, duhet të mbështetet tek ky rrjet, sipas stacioneve, frekuencave standarte, parametrave të përcaktuar, metodës së kampionimit etj. Çdo stacion monitorimi, është i lidhur me një grup parametrash, që maten dhe analizohen, në bazë të të cilave, janë treguesit mjedisorë të gjendjes, ndikimit dhe trysnisë¹³. Aktualisht në Shqipëri, nuk arrihet të monitorohen të gjithë stacionet e parashikuar nga Rrjeti Kombëtar i Monitorimit. Kjo shkaktohet, si rezultat i pamjaftueshmërisë së burimeve financiare, të nevojshme për të mbuluar plotësisht me monitorim, gjithë rrjetin. Për këtë arsye, zbatohet parimi i përparësisë së stacioneve, duke përzgjedhur për

monitorim, vetëm ato stacione që janë më të rëndësishme, nisur nga një vlerësim i gjithanshëm i problematikës dhe rëndësisë që ka secili prej tyre, në raport me kryerjen e vlerësimeve mjedisore, përcaktimin e prirjeve në vite dhe parashikimin e prirjeve mjedisore për të ardhmen. Rrjeti Kombëtar i Monitorimit 2018, është i përbërë nga 775 stacione monitorimi gjithsej, të shpërndara në të gjithë vendin sipas sektorëve (Tabela 3. Numri stacioneve të monitorimit sipas fushave). Në varësi të tij dhe instrumentave financiare në dispozicion të monitorimit, si dhe kriterëve të mësipërme të përzgjedhjes, bëhet shpërndarja e buxhetit, sipas komponenteve mjedisore dhe numrit të stacioneve të monitorimit.

Sektori	Numri i stacioneve sipas fushave	Kostoja në milionë lekë	Kostoja në %
Ajër	121	50	20
Zhurmat	51	17	6.8
Ujëra			
Ujë lumi	151	75	30
Ujë liqeni	36		
Ujë lagune	33		
Ujë deti	102		
Ujë bio-cilësi	95	23	9.2
Ujë nëntokësor	59	5	2
Tokat	26	20	8
Pyjet	99	35	14
Biodiversiteti	76	25	10
Gjithsej	849	250	

Tabela 3.

Numri i stacioneve të monitorimit dhe kostoja sipas fushave në PKMM 2018.

13 Referuar listës zyrtare të treguesve mjedisorë dhe klasifikimit të tyre në legjislacionin aktual

Monitorimi i ajrit, ujërave, tokës, biodiversitetit dhe pyjeve, duhet të bëhet në përputhje me standardet dhe kërkesat e Direktivave të BE-së dhe kritereve Evropiane e Pan-Evropiane, sipas fushave përkatëse, të përafuara në masë të konsiderueshme edhe me legjislacionin aktual shqiptar. Por, sfidë e madhe ngelet ende, zbatimi me përpikmëri i gjithë parashikimeve ligjore të lidhura me mjedisin në tërësi dhe monitorimin në veçanti. Kjo duhet shoqëruar, me ngritjen dhe konsolidimin e një Sistemi të Integruar të Monitorimit Mjedisor,

mbështetur tërësisht, në standardet e vendosura nga legjislacioni mjedisor evropian dhe ai kombëtar (i cili duhet t'i pasqyrojë plotësisht ato) dhe funksionimin e tij si një i tërë. Kjo do të bëjë të mundur, sigurimin e të dhënave mjedisore të besueshme, të sakta, të vazhdueshme dhe të mbështetura mbi vlerësimin e treguesve mjedisorë, në përputhje me përparsitë politike mjedisore dhe të gjeneruara, nga një sistem monitorimi modern dhe me standarde evropiane.

**Kosto e PKMM me stacionet dhe indikatorët për vitin 2018 (në milion/lekë)
Totali 250 milionë lekë**




Figura 7.
Shpërndarja e buxhetit sipas komponentëve mjedisorë në PKMM 2018

Sigurimi i të dhënave mjedisore dhe raportimi i tyre, drejt institucioneve evropiane, në përputhje me standardet e vendosura nga këto të fundit, është i lidhur ngushtë edhe me gjenerimin e tyre, nga një sistem kombëtar të dhënash, i konsoliduar, i bazuar në rrjetin kombëtar të integruar të monitorimit të mjedisit, të ngritur në përputhje me kërkesat e standardet e përcaktuara nga Direktivat Evropiane. Njëkohësisht, ngritja dhe funksionimi i një Sistemi të Integruar të Informacionit Mjedisor, do të bënte të mundur dhe siguronte, mbulimin me të dhëna dhe informacion mbi statusin mjedisor, presionet e ushtruara, ndikimin në mjedis dhe reagimin e publikut ndaj dukurive me ndikim në mjedis (skema DPSIR), që përbën edhe konceptin bazë, ku duhet të mbështetet monitorimi i treguesve mjedisorë, të cilët edhe klasifikohen, sipas kësaj skeme konceptuale.

Ndërkaq, Sistemi i Integruar i Informacionit Mjedisor (SIIM), është një sistem, që do të siguronte të dhëna të besueshme për mjedisin në kohën dhe cilësinë e duhur. Misioni i tij, ka të bëjë gjithashtu edhe me ruajtjen, menaxhimin, verifikimin, mbrojtjen, përdorimin dhe arkivimin e të dhënave mjedisore. Të dhënat grumbullohen, në një bazë të dhënash si dhe përpunohen në programin GIS. Objektivi i këtij sistemi është sigurimi i një cilësie të lartë të dhënash si dhe aksesit në çdo kohë tek ato, nga ana e përdoruesve të ndryshëm. Njëkohësisht, ngritja e tij bën të mundur shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit mjedisor, që sigurohet nga gjithë institucionet monitoruese në vend, gjë që do ta kompletonte infrastrukturën e grumbullimit dhe menaxhimit të informacionit dhe të dhënave mjedisore në nivel kombëtar, si dhe do ta njësonte me atë të vendeve të tjera evropiane. Por kjo kërkon më shumë kapacitete teknike, financiare,

njerëzore dhe administrative në shërbim, gjë që do të bënte të mundur edhe kryerjen e vlerësimeve mjedisore mbështetur në të dhënat e grumbulluara dhe në përputhje të plotë me standardet evropiane, duke përmirësuar ndjeshëm performancën e raportimeve mjedisore të Shqipërisë, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. Aktualisht, ky sistem është duke u ngritur dhe përpilimi i tij po bëhet nga ekspertë të huaj, në bashkëpunim edhe me institucionet shqiptare.

Pavarësisht, mungesës ende të një SIIM në Shqipëri, vlerësohet se sistemi aktual i monitorimit të mjedisit, pavarësisht faktit, që ende nuk arrin të ofrojë të dhëna të vazhdueshme për të gjithë treguesit, duket se, të paktën ekspertizën ka filluar ta përcjellë tek ekspertët vendorë dhe institucionet monitoruese. Përdorimi i treguesve mjedisorë në të ardhmen, duhet patjetër të përbushë kërkesat dhe nevojat kombëtare, si dhe t'u shërbejë politikëbërësve, duke ofruar vlerësimet e duhura mbi cilësinë e mjedisit në vend, me qëllim marrjen e masave ligjore të nevojshme nga këta të fundit, në shërbim të mirë-menaxhimit të mjedisit, ruajtjen dhe mbrojtjen e tij, në të ardhmen. Por kjo gjë, ende në Shqipëri, nuk po funksionon siç duhet dhe është ende në faza fillestare. Vlerësimi i gjendjes së mjedisit, mbështetur në përfshirjen e plotë në të, të faktorëve mjedisorë me ata social-ekonomikë, duhet të funksionojë më mirë dhe në mënyrë më të plotë, e alternuar me analizat e natyrës ndërsektoriale. Kuadri konceptual i DPSIR, i përdorur për analizat dhe vlerësimet mjedisore në Shqipëri, zbatohet sistematikisht prej vitesh, por ai fokusohet, vetëm tek përshkrimi i situatës aktuale të mjedisit dhe jo tek analiza e ciklit politik, vlerësimi i integruar i mjedisit në Shqipëri, ofrimi i skenareve mjedisore që parashikohen të



ndodhin në të ardhmen (kjo lloj analize thuhet mungon), duke bërë që të mungojë theksi ndaj problematikës mjedisore, ofruar për politikëbërësit dhe si rrjedhim edhe proceset politike mjedisore në vend dhe vlerësimi i efikasitetit të atyre ekzistuese. Duhet vënë në dukje se nga ana procedurale përgatitja e RGJMSH është një traditë e mirë qysh pas krijimit të AKM. Megjithatë ka ende shumë punë për të bërë në lidhje me anën përbajtëse të RGJM dhe me shkallën e informimit të publikut mbi gjetjet e raportin dhe komunikimit me të. Kontributi që mund të japin projektet e ndryshme që sjellin të dhëna mbi cilësinë e mjedisit në Shqipëri kanë nevojë që të kjojnë në filtra përpara se të bëhen pjesë e RGJMSH.

3.3.4 Sistemet aktuale të Monitorimit të gjendjes së mjedisit

Nga një vështrim i hollësishëm, i situatës aktuale të treguesve mjedisorë, tek të cilët bazohet monitorimi në Shqipëri, rezulton se ato ndahen në kategori që mbulojnë 15 tematika kryesore. Edhe pse, fluksi i të dhënave aktuale, mbulon të gjitha kategoritë kryesore mjedisore, intensiteti, mbulimi gjeografik, afati kohor, brenda të cilëve ato grumbullohen si dhe cilësia e të dhënave, tregojnë se ka luhata të konsiderueshme dhe paqëndrueshmëri në monitorimin e tyre dhe fluksin e të dhënave që sigurohen prej këtij procesi. Prioritare, në përcaktimin e strukturës së përgjithshme të komponentëve kryesorë mjedisorë, si dhe të procedurave aktuale të monitorimit, ka qenë fusha e monitorimit të ajrit dhe ujërat, për të cilat ka pasur disa zhvillime, sa takon përbushjes së standardeve të monitorimit të tyre. Në lidhje me situatën e ndotjes së ajrit dhe monitorimit të saj, ka një vlerësim

mbi progresin e bërë, i cili lidhet me mbulimin me monitorim nga stacionet automatikë (24 orë monitorim) të gjashtë qyteteve kryesore të vendit me popullsi mbi 80.000 banorë. Duke marrë në konsideratë, mungesën e qendrave të mëdha urbane (vetëm Tirana ka mbi 500.000 banorë), zhvillimi i rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit, vlerësohet si relativisht i kënaqshëm, vlerësim ky i bërë në raport me shkallën e mbulimit me monitorim të bazuar në parimin e prioritarizimit dhe njëkohësisht në raport me kapacitetet monitoruese dhe ato financiare në dispozicion të këtij aktiviteti. Por ai, nuk mund të konsiderohet kursesi i 'mjaftueshëm' po të kemi parasysh nevojën për zgjerim të mbulimit me monitorim të vazhdueshëm të cilësisë së ajrit në ato pika që konsiderohen si burime kryesore të ndotjes së ajrit në qytete me aktivitet të spikatur industrial apo qytetet e mëdha dhe me nivel të lartë mobiliteti Mendohet që, në të ardhmen e afërt, fokusi i monitorimit të jetë drejt zgjerimit të njohurive edhe mbi kushtet atmosferike, shoqëruar kjo edhe me shpërndarjen e rrjetit të monitorimit të stacioneve të ajrit drejt zonave urbane, rurale dhe ato pyjore. Monitorimi ajrit, gjatë vitit 2016-të¹⁴, u zhvillua në 113 pika të reja krahasuar me një vit më parë, të mbuluara nga stacione gjysmë automatike dhe tuba pasivë matjesh (tabelat e mëposhtme japin referenca të përgjithshme mbi monitorimin e ndotjes së ajrit dhe zhurmave, referuar vitit 2016-të si një nga vitet me performancën më të mirë të viteve të fundit). Ndotësit që maten janë: SO₂, NO₂, (NO_x), CO, O₃, Benzene, PM₁₀ (PM_{2,5}) dhe metalet e rënda. Monitorimi i tyre, kryhet nëpërmjet stacioneve automatikë, përfshirë ato të lëvizshëm, gjysëm automatikë dhe tubave pasivë (ky i fundit i organizuar në disa fushata, një për çdo stinë).

14 Programi Kombëtar i Monitorimit 2016, AKM.

Tabela 4.

Referenca të përgjithshme mbi monitorimin e ndotjes së ajrit dhe zhurmave

Tematika	Ndotja Ajrit
Referenca ligjore / Kombëtare Ndërkombëtare	VKM nr. 1189/2009` Rregullat dhe procedurat për hartimin e zbatimin PKM-së Ligji Nr. 162/2014 ` Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit urban` dhe VKM nr.352/ 29.4.2015 ` Mbi vlerësimin e cilësisë së ajrit urban dhe per disa ndotës që lidhen me to` Direktiva AQ BE-së (2004/107/KE&2008/50/KE), e përcaktuar në Vendimin (2011/850/BE)
Mbulimi gjeografik me të dhëna	Gjashtë qendrat urbane, të zgjeruara me 113 stacione të tjera (2016)
Treguesi (t)	SO ₂ , NO ₂ (NOx), CO, O ₃ , Benzene, PM ₁₀ (PM _{2.5}), metalet rënda
Autoritetet përgjegjëse / institucionet	AKM dhe ISHP
Frekuenca dhe disponueshmëria në kohë	6 stacione automatike të instaluar në pocizione fikse që monitorojnë me pajisje automatike gjate 24 orëve pa ndërprerje e gjenerojnë të dhëna orare mbi të cilat kalkuloohen mesataret mujore për gjithë parametrat e mësipërm. Tubat pasive përdoren për monitorimin e Benzenit (C ₆ H ₆), O ₃ , SO ₂ , NO ₂ në katër fushata (një për çdo stinë) në periudha 2-3 javore. Stacionet gjysëm automatikë monitorojnë PM ₁₀ (dhe përqëndrimet e HM) në qytete të ndryshme dhe analizat e rezultateve të tyre do të asistohen nga 9 laboratorë.

Tematika	Zhurmat
Referenca ligjore kombëtare/ ndërkombëtare	Ligji nr. 9774,datë12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin zhurmës” VKM nr. 1189/2009 `Rregullat dhe procedurat për hartimin e zbatimin PKM-së Direktiva BE-së 2002/49/KE
Mbulimi gjeografik me të dhëna	Në tetë Qendra Urbane (deri në 2014), dhe zgjerimi tyre deri në 10-të në 2016, (51 pika monitorimi)
Treguesi (t):	Leq, L10, L90
Autoritete përgjegjëse /institucionet	AKM
Frekuenca dhe disponueshmëria në kohë	14 ditë / 24 orë. Vlerat koresponduese ditë/natë për ditë. Mestarja bi/javore ditë/ natë

Në vlerësimet e bëra mbi monitorimin e viteve të fundit, *rezultun se vlerësimi i cilësisë së ujërave në lumenjtë Drin, Bunë, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjosë*

është bërë, bazuar tek parametrat fizikë dhe kimikë (temperatura, transparenca, pH, alkaliniteti, përçueshmëria elektrike, oksigjeni tretur, COD, BOD₅, nitrite, ni-

trate, ammoniak, Ptotal) në 18 stacione. Ndërsa në vitin 2016, monitorimi u zgjerua duke shtuar më shumë stacione monitorimi (151 stacione) e duke specifikuar, se ku ato do të vendoseshin dhe cilat do të ishte shpeshtia e mostrimit. Gjithashtu, konstatohen paqartësi dhe mungesë evidencash në lidhje me sigurimin e monitorimit të vazhdueshëm, të të njëjtëve tregues apo parametra, për të njëjtët stacione apo komponentë mjedisore, vit pas viti. Kështu p.sh. nuk është e qartë nëse stacionet e propozuara në vitin 2016 (151), kanë përfshirë edhe 35 stacionet, që në vitin 2011, kanë monitoruar shkarkimet e ujërave të zeza (në lumenj apo grykëderdhje). Ndërkohë, që në vitin 2016 u planifikua edhe monitorimi i 35 stacioneve në liqene dhe 33 në laguna, në

vitin 2014 u raportua si i monitoruar vetëm liqeni Butrintit, ndërsa në vitin 2011 ishin vetëm shtatë stacione monitorimi në liqene (2 Ohri, 4 Shkodra dhe 1 Prespa Madhe). Bazuar në këto të dhëna dhe fakte, evidentohej lehtësisht mungesa e monitorimit të vazhdueshëm dhe të rregullt nga institucionet e monitorimit në Shqipëri, duke bërë që edhe të dhënat e gjeneruara nga ky proces, në jo pak raste, të jenë të cungëta duke kushtëzuar kryerjen e vlerësimeve komplekse, mbi cilësinë e ujërave dhe faktorëve që ndikojnë tek to dhe njohjen e burimeve të ndotjes dhe pasojat e tyre mbi përbërs të tjerë mjedisore apo njerëzorë. (Tabela e mëposhtme jep referenca të përgjithshme të monitorimit të ujërave sipërfaqësore).

Tematika	Ujërat Sipërfaqësorë (liqene, lumenj, laguna)
Referencat ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare	WFD Direktiva 2006/44/EC e Parlamentit Europian dhe këshillit në 6 Shtator 2006 mbi cilësinë e ujërave të ëmbla që kanë nevojë për mbrojtje ose përmirësime me qëllim mbrojtjen e peshqve ujorë` VKM nr. 1189, 2009 `Rregullat dhe procedurat për hartimin e zbatimin PKM-së. Ligji Nr. 111/2012 ` Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore` VKM nr.267/2014 `Mbi aprovimin e substancave prioritare për mjedisin ujor` VKM nr. 246/2014 `Mbi përcaktimin e normave të cilësisë në mjedis për ujërat sipërfaqësorë`.
Mbulimi gjeografik me të dhëna	Mbulimi është relativ. Në përgjithësi gjashtë lumenj dhe tre liqene monitorohen rregullisht, por jo të mbuluar çdo vit. Një shpërndarje hapësirë e rrjetit nevojitet të bëhet me qëllim vlerësimin e qëndrueshmërisë dhe mjaftueshmërisë
Treguesi (t)	TOC, pH, P-total, NO ³⁻ , NO ²⁻ , NH ₄ , BOD, COD, PO ₄ , kripshmëria, lënda pezull, përmbajtja, oksigjeni tretur Analizat mikrobiologjike (Faecal Coli, Faecal, Streptokoku)
Autoritetet përgjegjëse/ institucionet	AKM dhe ISHP
Frekuenca dhe diponueshmëria në kohë	Disa herë në vit , së paku 4 herë vit /çdo sezon

Tabela 5.

Referenca të përgjithshme mbi monitorimin e ujërave sipërfaqësore

Ndërkohë që, *monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësore*, është një nga komponentët me historinë më të gjatë të monitorimit e me traditë në këtë drejtim, përgjithësisht e kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. Ky monitorim kryhet në një numër, relativisht të qëndrueshëm stacionesh (40 në vitin 2011, 39 në vitin 2016, 59 stacione monitorimi 2017), të cilat mbulojnë shtatë basenet ujëmbajtëse të vendit

(Shkodra, Lezhë - F. Kuqe, Tirana - F. Krujë, Elbasan - Lushnjë, Korçë, Gjirokastrë - Kafaraj - Novoselë, Vurg - Mursi dhe Ori-kum). Parametrat e monitoruar, mjaftojnë për të përcaktuar 'kushte kimike' të tyre, sikundër përcaktohet edhe në Anexin 5, të WFD 60/2000/ KE¹⁵. (Tabela e mëposhme përmban referenca të përgjithshme të monitorimit të ujërave nëntokësore).

Tematika	Ujërat nëntokësore
Referenca Kombëtare/ Ndërkombëtare	WFD, Direktive 2006/118/KE, Për mbrojtjen e ujërave nëntokësore ndaj nditjeve dhe demtimit` VKM nr. 1189, 2009 `Rregullat dhe procedurat për hartimin e zbatimin e PKM-së
Mbulimi gjeografik me të dhëna	Programi monitorimit për ujërat nëntokësore në 59 stacione.
Treguesi (t):	Parametrat e matur në 2016 janë: pH, temperaturat, TOC, PD, ushqyeshit (N, P), metalet rënda, parametrat bazë organikë dhe mikrobiologjikë. Analiza e parametrevë bazë (përbërësit e klorurit dhe PCB-të, si dhe pesticidet dhe PAHs janë përfshirë
Autoritetet përgjegjëse	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
Frekuenca dhe disponueshmëria në kohë	Disa herë në vit, së paku 4 herë/ vit (çdo stinë)

Tabela 6.

Referenca të përgjithshme mbi monitorimin e ujërave nëntokësore

Monitorimi i parametrevë, që mbulojnë tokat dhe ujërat për ujitje, nuk monitorohen rregullisht, ndërkohë, që monitorohet intensiteti i përdorimit të plehrave kimike dhe pesticideve, të cilat tregojnë forcat e konsideruara si shtytëse dhe ndikimin e tyre tek tokat dhe përcaktimin e shkallës së ndotjes të ujërave për ujitje.

Ndërkohë, *erozioni i tokave*, një tjetër komponent mjedisor detyrim monitorimi (referuar vetëm legjislationit kombëtar), bazohet në vlerësime përgjithësisht teorike,

të nivelit potencial të erozionit në tokat bujqësore dhe për këtë përdoren katër stacione eksperimentale, të cilat shërbejnë për të rifreskuar fondin teorik të evidencave dhe vlerësimeve të këtij fenomeni. Rrëshqitjet e tokave, monitorohen në zona, ku fenomeni është konstatuar (duke shkak-tuar pasoja në banesa apo infrastrukturë). Rezultatet e këtij monitorimi janë gjithashtu pjesë e RGJM-së, por monitorimi i erozionit të tokave dhe cilësia e tyre, të

15 WFD/ Direktiva Kuadër e Ujit

integruara me monitorimin e zbatimit të politikave të adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike, do të sillnin një kontribut mjaft cilësor, në vlerësimin e interguar mjedis-or në Shqipëri dhe trajtimin e saj si pjesë e raportit gjithashtu.

Monitorimi i mbetjeve të ngurta në vend, kufizohet vetëm tek regjistrimi i mbetjeve urbane të gjeneruara. Kompletimi i ndërtimit të landfilleve, në përputhje me standartet e BE-së, do të bëjë të mundur, përveç të tjerash, edhe matjen e treguesit të 'përqindjes së mbetjeve të ngurta urbane të hedhura në mënyrë të sigurt'¹⁶. Monitorimi i parametrave të tjerë (në kuadër të po kësaj Direktive), kërkon instalimin e ripërdorimit, riciklimit dhe skemave të rikuperimit si dhe adaptimit të politikave minimizuese, që aktualisht në Shqipëri mungojnë.

Mbetjet helmuese dhe të rrezikshme: sot në nivel kombëtar vlerësohet të jenë 14 vende (*hot spote*)¹⁷ të rrezikshme të depozitimit të mbetjeve të rrezikshme. Monitorimi i tyre, është bërë në kuadër të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe Planit të Veprimit për Rehabilitimin e tyre, dokumenta këto diskret dhe të përdorura për qëllime specifike. Objektivat specifike për monitorimin e tyre, do të duhej të trajtoheshin si 'çështje specifike' të programit kombëtar të monitorimit, nëse kjo do të duhet të bëhet dhe vlerësohet si prioritet, për shkak të lënies së monitorimit të tyre, jashtë fokusit dhe objektit të kuadrit ligjor aktual të monitorimit në Shqipëri.

Një komponent tjetër mjedisor, detyrim monitorimi dhe raportimi si në kuadrin ligjor shqiptar ashtu edhe në atë referuar BE-së, është *biodiversiteti*. Ai karak-

terizohet nga një pasuri biologjike mjaft domethënëse: rreth 3200 bimë të larta dhe 2350 të ulta: 15.600 specie vertebrorësh dhe invertebrorësh (përfshirë insektet, molusqet, peshqit, amfibët, zvarranikët, shpendët dhe gjitarët). Në gjithë vendin sot gjenden rreth 91 specie të kërcënuara globalisht, disa prej të cilave me një rëndësi e domethënie të veçantë rajonale (Pelikani kaçurel, *Pelecanus crispus*, karabullaku, *Phalacrocorax pygmeus* dhe blini, *Acipenser sturio*).

Monitorimi i biodiversitetit, është i orientuar në dy drejtime kryesore: a- monitorimi pyjeve dhe b- monitorimi i ekosistemeve dhe specieve. Monitorimi pyjeve, bëhet në përputhje me standartet dhe kriteret Pan-Evropiane dhe treguesit për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, të përcaktuar nga Kombet e Bashkuara. Parametrat e monitoruar përfshijnë: sipërfaqen totale të tokave pyjore, prodhimin pyjor (volumi) dhe vlerësimin e biomasës totale, përbërësit, struktura e klasave moshore dhe shpërndarja diametrike etj. Indeksi prodhimit, shërben për të vlerësuar shkallën e sekuestrimit të karbonit nga biomasa pyjore. Gjithashtu, ka edhe të dhëna mbi vlerësimin e shkallës së kërcënimit nga zjarret dhe mbikullotja.

Treguesit e monitoruar, përfshijnë gjashtë kritere që janë: C1 'Mirëmbajtja, përmirësimi dhe rritja e burimeve pyjore, kontributi tyre në ciklin global të karbonit', C2 'Ruajtja e ekosistemeve pyjore, shumëfishimi i pyjeve', C3 'Mirëmbajtja dhe inkurajimi i funksioneve prodhuese në pyje, C4 'Mirëmbajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i diversitetit biologjik të ekosistemeve në pyje, C5 'Mirëmbajtja, përmirësimi dhe stimulimi i funksioneve mbrojtëse në menaxhimin e pyjeve, C6 'Mirëmbajtja e funksioneve dhe kushteve

16 Referuar Direktivës Kuadër për Mbetjet/
2008/98/EC

17 RGJM 2014

të tjera social-ekonomike`. Në vitin 2016, fokusi i monitorimit ishin kriteret Pan - Evropiane C2 dhe C4, të cilat u kryhen nga AKM. Monitorimi i këtyre kriterëve, jep një kontribut të rëndësishëm në vlerësimin e shëndetit në pyje edhe pse, ky monitorim nuk kryhet i plotë për të gjithë treguesit, duke cënuar kështu krijimin e një situatë e panoramë të plotë të gjendjes në pyje, bazuar në një seri të plotë treguesish mjedisore të gjendjes në pyje, të integruar edhe me tregues të tjerë e faktorë social ekonomikë që ndikojnë.

Zonat e mbrojtura dhe speciet. Në raportet e viteve të fundit të gjendjes në mjedis, nuk ka ndonjë informacion domethënës në lidhje me biodiversitetin. Po ashtu edhe në raportin e pestë të CBD-së¹⁸, nuk ka ndonjë informacion sasior, ku mund të mbështetet përshkrimi apo vlerësimi, mbi situatën aktuale të biodiversitetit dhe statusin e mbrojtjes së specieve, përveçse referenca të përgjithshme mbi rifreskimin e `Librit të Kuq`. Speciet e mbrojtura në Shqipëri (405), sipas Listës së Kuqe (Red List) të florës dhe faunës, të miratuar në Dhjetor të vitit 2013, është rritur me 44 specie në krahasim me atë të vitit 2007, duke treguar kështu se përpjekjet për të përcaktuar kushtet e premisat bazë, të cilat do të çojnë drejt krijimit të sistemit të monitorimit të biodiversiteti, janë në proces kompletimi e sipër. Ndërkaq, speciet e mbrojtura të faunës sot në Shqipëri, numerohen të jenë 575, i njëjti numër si me vitin 2007.

Të gjitha burimet, tregojnë se monitorimi dhe menaxhimi i biodiversitetit, deri më tani ka qenë kryesisht i lidhur me zbatimin e projekteve ndërkombëtare të financuara nga donatorë të ndryshëm, duke mos ndikuar në rritjen e kapaciteteve të duhura, të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e

monitorimit të tij. Rezultatet e këtyre projekteve, duhet të ishin grumbulluar dhe vlerësuar dhe më pas të bëheshin pjesë e data bazës kombëtare të të dhënave mjedisore e përdorëshin për qëllime vlerësimesh e raportimesh mjedisore dhe rifreskoheshin në mënyrë sistematike. Sot ato ose nuk ekzistojnë ose kanë humbur nëpër agjencitë, organizatat, subjektet, që i kanë implementuar, ndërkohë që të dhënat e tyre mund të ishin një kontribut mjaft i mirë, për integrimin e informacionit mbi biodiversitetin në sistemin e monitorimit të mjedisit. Kështu, një shembull mjaft i mirë për këtë është p.sh. ngritja e sistemit ndër-kufitar të monitorimit, për Parkun Kombëtar të Prespës (mes Shqipërisë- Greqisë dhe Maqedonisë), për monitorimin e peshkut dhe peshkimit, vegjetacionit ujqor, pyjeve dhe habitateve tokësore etj. Një aplikacion tjetër, shembull i një sistemi monitorimi në zonat e mbrojtura, është ai i deltës së lumenjve Drin-Mat. Sistemi i Integruar i Monitorimit të kësaj delte, ishte e fokusuar tek evidentimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike mbi ekosistemet bregdetare të saj, si një kontribut që ndihmoi në të kuptuarit më mirë të mënyrës, sesi përgjigjen ekosistemet ndaj këtyre ndikimeve, efekteve që shkaktojnë ndryshimet klimatike mbi habitatet, bimët dhe kafshët si dhe mënyrën sesi ekosistemet dhe elementet e tyre përbërëse, po adaptohen ndaj këtyre ndryshimeve, nëpërmjet vendosjes së një pakete treguesish, nën-treguesish dhe parametrash, që nevojitet të monitorohen si dhe disenjimit dhe implementimit të masave mbrojtëse dhe menaxhuese dhe monitorimit të efektivitetit të këtyre masave. Tematika kryesore e treguesve dhe nën-treguesve ose parametrave të këtij sistemi monitorimi janë: meteorologjike (presioni ajrit, temperatura dhe lagështira, rreshjet, erërat, regjimi diellor (nëse është e mundur), hidrologjike (niveli detit, niveli ujërave dhe prurjet e lumenjve,

18 Convention on Biological Diversity

niveli ujërave nëntokësore, ndryshimet në nivelin e detit dhe regjimit të lagunave), fizike (pH, aciditeti, alkaliniteti, oksigjeni tretur, COD, BOD₅, azoti, fosfori, karboni organik total, metalet e rënda, plehrat kimike dhe pesticidet), hidrobiologjike (fitoplanktoni, fitobenthos, zooplanktoni, zoobenthosi, diversiteti peshqve, habitate të listuara në listën e Direktivës Kuadër të Habitave të BE-së, speciet prioritare etj.

Vendosja e një sistemi monitorimi të plotë të biodiversitetit, kërkon gjithashtu edhe implementimin e Nenit 17 të Direktivës së Habitave, e cila ju kërkon vendeve anëtare të saj, që të raportojnë çdo gjashtë vjet, rreth progresit të bërë në zbatimin e saj. Duke qenë se, fokusi kryesor i kësaj direktive, është ruajtja dhe mbrojtja e një statusi të favorshëm të mbrojtjes së habitave dhe specieve me interes për komunitetin, monitorimi dhe raportimi i kërkesave që vijnë nga Direktiva, do të bëhet i mundur vetëm nëse do të merren masat e duhura për këtë qëllim. Monitorimi i statusit të mbrojtjes, është një detyrim që vjen nga Neni 11, i Direktivës së Habitave për të gjitha habitatet (e listuara në Anexin I) dhe specieve (të listuara në Anexin II, IV, V) me interes komunitar. Si rrjedhojë, ky parashikim nuk është e kufizuar vetëm tek Natura 2000¹⁹ për të dhënat që vijnë nga vendet anëtare, por edhe ato jashtë saj, më qëllim arkivimin e një vlerësimi të plotë të statusit të mbrojtjes. Rezultatet kryesore të monitorimit, duhet të raportohen tek Komisioni Evropian, çdo gjashtë vjet në përputhje me kërkesat e Nenit 17 të Direktivës.

19 Shenim: 'Natura 2000' është programi i BE-së, për ngritjen e rrejtjet të site-ve të mbarështrimit dhe mbrojtjes së specieve të rralla dhe në rrezik zhdukje dhe habitateve të rralla natyrore, të mbrojtura. Synimi i tij është sigurimi afatgjatë i mbijetesës së këtyre specieve dhe habitateve në Evropë, të listuara si në Direktivën e Shpendëve ashtu dhe në Direktivën e Habitave.

Inventari Gazeve Serë (GHG-të) dhe monitorimi i tyre në vendin tonë, kryhet çdo shtatë vjet, nëpërmjet Komunikimit Kombëtar të UNFCCC²⁰. Parashikimet e kësaj Konvente, janë në përputhje me kërkesat dhe detyrimet e përcaktuara, të lidhura edhe me raportimin ndaj adoptimeve në kuadër të kësaj Konvente të tilla si: manuali raportimeve të UNFCCC, (Aneksi I), inventaret dhe përgatitja e komunikimeve kombëtare. Të dhënat e inventarit, ofrohen në inventarin vjetor të GHG-ve si dhe në Komunikimet Kombëtare, në kuadër të Konventës. Vlerësimi i GHG-ve, bëhet kryesisht i bazuar, tek të dhënat statistikore të INSTAT-it mbi aktivitetet ekonomike, statistikave të transportit si dhe konsumit final, të energjisë dhe burimeve natyrore. Komunikimi i Tretë Kombëtar në Shqipëri, është finalizuar dhe prezantuar për publikun në vitin 2016. Ndërkohë, që raportimi i tij drejt UNFCCC (GHG-të janë detyrim raportimi i Shqipërisë drejt këtij institucioni) si dhe gjetjet e tij janë përfshirë vitet e fundit në RGJM- të e publikuara nga AKM.

3.3.5 Burimet e aktivitetit të monitorimit mjedisor dhe problematikat e grumbullimit të të dhënave

Karakteristika kryesore e mjedisit ekzistues mbi monitorimet në vend, është fragmentarizimi i theksuar i këtij procesi. Ka një mozaik të vërtetë institucionesh, të përfshira në monitorimin e gjendjes së mjedisit në vend dhe institutesh të specializuara, të cilat kanë në qendër të kësaj marëdhënie dhe aktiviteti (që lidhet me monitorimin e gjendjes së mjedisit), Minis-

20 United Nations Framework Convention on Climate Change / Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

trinë e Mjedisit dhe Turizmit dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Kjo e fundit, përfaqëson institucionin përgjegjës për monitorimin e mjedisit, supervizionin, kordinimin dhe monitorimin e aktivitetit monitorues, nga ana e institucioneve apo instituteve të kontraktuara prej saj, në lidhje me monitorimin e treguesve mjedisorë, të cilët nuk mund të mbulohen nga AKM-ja dhe kapacitetet e saj. Njëkohësisht, ajo është edhe institucioni kryesor, që posedon dhe administron gjithë të dhënat mjedisore të grumbulluara nga proceset e monitorimit, të performuara nga ajo vetë apo institucionet e kontraktuara prej saj (dhe Ministria Mjedisit dhe Turizmit) apo institucionet e tjera në nivel kombëtar, që kanë detyrim të ndajnë dhe ofrojnë të dhënat e tyre për AKM-në, me qëllim përdorimin nga kjo e fundit, për kryerjen e vlerësimeve mjedisore të plota dhe gjithë përfshirëse. Kjo agjenci, është autoriteti kompetent për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, i cili përfshin në aktivitet, gjithë institucionet që kryejnë monitorim mjedisor. Aktualisht, AKM është institucioni që merret edhe me hartimin e Raporteve Vjetore të Gjendjes në Mjedis, si dhe raportimin e të dhënave mjedisore dhe ofrimin e tyre për publikun. Gjithashtu, ajo performon, funksionet e saj monitoruese të gjendjes së mjedisit dhe njëkohësisht, atë të grumbullimit, procesimit dhe shpërndarjes (raportimit) së vlerësimeve mjedisore, të bëra prej saj, mbi cilësinë e mjedisit dhe pyjeve. Aktiviteti i saj monitorues, bazohet tek: *monitorimi i cilësisë së ajrit në Shqipëri, për parametrat kryesorë të cilësisë: PM₁₀, PM_{2,5}, SO₂, NO₂, CO, O₃, benzeni, e cila bëhet në përputhje me Programin Vjetor të Monitorimit (Kapitulli `Ajri`)*. Aktualisht, monitorimi cilësisë së ajrit në vend, bëhet në gjashtë qytete kryesore të vendit: Tiranë (dy stacione monitorimi të cilësisë së ajrit urban), Korça (një stacion), Shkodra (një

stacion), Vlora (një stacion), Durrësi (një stacion) dhe Elbasani (një stacion). *Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore*, për parametrat kryesorë: pH, kripshmëria, metalet e rënda, temperatura, O₂ etj., dhe *ujërat bregdetare* (veçanërisht dhe në frekuencë më të lartë gjatë stinës verore). Njëkohësisht edhe *monitorimi tokave, pyjeve dhe biodiversitetit* në mbarë vendin, është pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit (PKMM). Por duhet theksuar, se jo të gjithë parametrat e komponentëve kryesorë mjedisorë, monitorohen nga AKM, pasi ajo nuk ka gjithë kapacitetet teknike monitoruese dhe njerëzore, të duhura për mbulimin e plotë të tyre në përputhje me PKMM, si dhe mjetet financiare të nevojshme, për këtë qëllim. Për këtë arsye, AKM-së i nevojitet të kryejë edhe funksione kordinuese, mes institucioneve të tjera monitoruese në vend, si dhe të bashkëpunimit të vazhdueshëm me to, për shfrytëzimin e pajisjeve të tyre të monitorimit, rrjeteve rajonale dhe laboratorëve të analizave, që rregullisht ushtrojnë funksione monitorimi, duke ofruar në mënyrë të vazhdueshme, një nivel të lartë ekspertize, mbi çështje të caktuara mjedisore. Këto institucione, janë struktura shtetërore dhe kontraktohen nga AKM, çdo vit (përgjithësisht, por ka edhe përjashtime që lidhen me mungesën e fondeve të mjaftueshme për t'i kontraktuar ato rregullisht dhe kërkuar të kryejnë monitorime mjedisore për llogari të saj) me qëllim kryerjen e vlerësimeve mjedisore dhe raportimeve në një fazë të mëtejshme. Në këtë mënyrë për shembull, Instituti i Shëndetit Publik, i cili vazhdimisht kontraktohet për kryerjen e analizave, që kanë të bëjnë më së shumti me monitorimin e cilësisë së ujërave të ëmbla dhe atyre bregdetare, monitorimin e zhurmave, cilësisë së ajrit (vitet e fundit nuk ka kryer monitorim të ajrit) etj., Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, i ngarkuar vazhdimisht

dhe pothuajse rregullisht me monitorimin e cilësisë së ujërave nëntokësore, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti Bujqësor etj., kanë ofruar aktivitetin e tyre monitorues, për tregues të caktuar mjedisorë. Megjithatë, duhet theksuar një përpjekje serioze e AKM, si institucioni përgjegjës për monitorimin e gjendjes së mjedisit në Shqipëri (veçanërisht në vitet e fundit), për të fuqizuar kapacitetet e saj monitoruese, gjë që është shoqëruar edhe me mbulimin

me monitorim të disa treguesve shtesë nga ana e saj, të cilët më parë mbuloheshin nga institucionet e sipër përmendura të monitorimit, të kontraktuara prej saj. Megjithatë e pavarësisht kësaj, ka ende shumë për të bërë në drejtim të mbulimit të plotë me monitorim mjedisor të gjithë treguesve nga ana e AKM, çka duhet të shoqërohet me rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të saj monitoruese, teknike, njerëzore e financiare, të nevojshme për këtë qëllim.




Figura 8.
Burimi i të dhënave mjedisore per RGjMSh

Fakti që çdo vit, ka një proces tenderimi, për institucione që do të ngarkohen me monitorim mjedisor, krijon vështirësi që lidhen kryesisht me procesin e monitorimit dhe të dhënat që gjenerohen nga ky proces, duke bërë që ato të jenë të paqëndrueshme dhe krijuar vështirësi, për mundësinë e përmirësimeve si dhe ngritjen dhe funksionimin e mirë të një mekanizmi të duhur, të shpërndarjes së këtyre të dhënave, shkëmbimit të tyre si dhe ruajtjes dhe menaxhimit të mirë dhe të qëndrueshëm, pjesë e një baze të dhënash të konsoliduar kombëtare të të dhënave mjedisore. Duke qenë se çdo vit, nga buxheti i shtetit, akordohet edhe fondi në dis-

pozicion të monitorimit, i cili është direkt në varësi të vendimarrjes politike, që jo gjithmonë ndodh ta kanë në fokus të tyre, çështjen e mjedisit dhe monitorimit të saj, kjo çon në krijimin e situatave të vështira dhe të paqëndrueshme sa i takon, sigurimit të një monitorimi të qëndrueshëm dhe afatgjatë, të sigurtë në kohë, shtrirje gjeografike dhe mbulim të plotë të treguesve mjedisorë me monitorim, duke çuar kështu, në sigurimin prej saj të të dhënave jo shumë të rregullta, sistematike e koherente. Kjo lloj situatë, (që lidhet si me mungesën e kapaciteteve njerëzore, ashtu edhe me mungesën e mjeteve financiare), ka bërë që AKM, në cilësinë e agjencisë pose-

duese dhe përdoruese e parë e të dhënave të monitorimit dhe raportimit të tyre drejt institucioneve kombëtare dhe ndërkom-bëtare (INSTAT, EUROSTAT, AEM etj.), të gjendet në vështirësi të vazhdueshme, të lidhura pikërisht me këtë panoramë. Ngarkimi i saj me qaq shumë funksione, të cilat janë të vështira për t'u menaxhuar, ashtu siç janë planifikuar si dhe në kushtet e mungesës së kapaciteteve të nevojshme, do të kishte qenë më mirë një ndarje e funksioneve monitoruese të saj, nga ato të lidhura me koordinimin dhe menaxhimin e bazës së të dhënave mjedisore dhe përdorimit të tyre, për analiza dhe vlerësime të mëtejshme mjedisore si dhe raportimin e tyre në mbështetje të politikëbërësve si në nivel evropian, ashtu edhe në nivel kombëtar.

Nga ana tjetër, institucionet e specializuara që punojnë me AKM në bazë të kontratave të monitorimit, nuk kanë ndonjë interes të veçantë, që të krijojnë dhe mirëmbajnë bazat me të dhënat mjedisore të siguruar nga monitorimet, t'i ruajnë dhe grumbullojnë ato, si dhe të furnizojnë, për nevojat e saj të vazhdueshme me to. Kjo situatë e konsideruar si e fragmentarizuar, me një cilësi jo shumë të mirë të të dhënave të monitorimit, ka ndikuar duke kushtëzuar edhe cilësinë e të dhënave dhe performancën e tyre, të përfshira edhe në RGJM. Për momentin, nuk ka një panoramë të plotë dhe të qartë, nga ana e gjithë institucioneve monitoruese në vend, në lidhje me llojin e informacionit dhe të dhënave të disponueshme mjedisore nga secili prej tyre si dhe mbulimit gjeografik. Ndërtimi i një panorame të tillë, është një nga prioritetet e sotme si dhe një nga orientimet kryesore të bëra nga programet e asistencave të huaja, që kanë vepruar e vazhdojnë ta bëjnë këtë gjë në Shqipëri. Proceset e tenderimit të aktiviteteve monitoruese vjetore, bazuar

në specifikime teknike të përgatitura mirë, duke nënvizuar qartësisht edhe kërkesat ndaj kontraktuesve, me qëllim shmangien e magësive të mësipërme të evidentuara, do të ndihmonin në sigurimin e vazhdimësisë dhe koherencës së proceseve monitoruese, edhe në rastet kur mund të ndryshojnë, kontraktorët e aktiviteteve monitoruese.

Krijimi i Sistemit të Integruar të Monitorimit të Mjedisit, do të bëjë të mundur rritjen e stabilitetit të procesit të monitorimit të mjedisit nga njëra anë dhe rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë e sigurimitin e vazhdimësisë e bashkëpunimit mes partnerëve të ndryshëm, nga ana tjetër.

Gjatë viteve të fundit në Shqipëri, është vërejtur një përmirësim i ndjeshëm në drejtim të aktiviteteve monitoruese të regjistruara, përmirësim i kapaciteteve monitoruese (rritja e numrit të stacioneve të monitorimit të ajrit) si dhe specializimit e trajnimit të kapaciteteve njerëzore të angazhuara në këto aktivitete. Partnerët tradicionale, vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e treguesve mjedisorë, duke përmirësuar pajisjet dhe metodologjitë, që ata përdorin. Rolin vendimtar në këto procese e luan AKM, që pavarësisht vështirësive, e ka forcuar ndjeshëm rolin e saj monitorues, në mënyrë të veçantë (monitorimi i ajrit, liqeneve dhe lumenjve, ujërave bregdetare larës, pyjeve dhe biodiversitetit në pyje, zhurmave, etj.) si dhe rolit të saj koordinues në raport me institucionet e tjera monitoruese në vend. Megjithatë, ende nuk ka një monitorim sistematik, të biodiversitetit në tërësi në gjithë vendin si dhe çështjes së monitorimit të tokave gjithash-tu. Aktivitetet monitoruese, shpesh herë kryhen në funksion dhe përputhje me legjisllacionin aktual kombëtar si dhe obligimet raportuese ndaj institucioneve



dhe marëveshjeve ndërkombëtare. Ende në Shqipëri, nuk ka monitorim të mbetjeve urbane në vend. Edhe ato të dhëna që disponohen mbi këto, janë siguruar nga vlerësimet të përafërta dhe jo si rezultat i monitorimit të rregullt të tyre, të bazuar në kriteret e metodologjitë ndërkombëtare. Vërehet, një panoramë mjaft e ndërlikuar, sa i takon përdorimit të normave dhe standardeve të përdorura për parametra dhe tematika të ndryshme, duke filluar nga ato në nivel Evropian ose ndërkombëtar (ajrin, biodiversitetin, ujërat dhe ujërat e zeza), deri tek ato në nivel kombëtar (për ujërat nëntokësore) ose një mungesë totale e stadardeve (p.sh. në fushën e mbetjeve dhe tokave). Janë shtuar gjithashtu stacionet e monitorimit të ajrit si numër, edhe pse ka pasur probleme që lidhen me mos kalibrimin e tyre të vazhdueshëm vjetor, si dhe kryerjen e rregullt nga ana e institucioneve të shërbimeve, të mirëmbajtjes së stacioneve, për shkak të kostove mjaft të larta të këtyre proceseve. Vitet e fundit, ka një përmirësim të këtyre proceseve, të cilët janë kryer rregullisht, pavarësisht kufizimeve buxhetore të vazhdueshme. Monitorimi i cilësisë së ajrit urban, aktualisht po kryhet rregullisht në qytetet kryesore të vendit dhe të dhënat e siguruar nga ky proces përfshihen rregullisht në RGJM. AKM monitoron gjithashtu në mënyrë të rregullt, shkarkimet urbane, nëpërmjet stacioneve manuale të vendosura përgjatë qyteteve kryesore të vendit. Frekuenca e kampionimit dhe parametrat e matur, janë në përputhje me kërkesat ndërkombëtare. Të gjitha të dhënat e grumbulluara nga monitorimi ujërave, janë pjesë e bazës kombëtare të të dhënave, që menaxhohet nga AKM, së bashku me të dhënat, që vijnë nga institucione të tjera, duke bërë të mundur në këtë mënyrë, furnizimin me të dhëna sistematike të bazës së të dhënave.

Vërehet gjithashtu se edhe pse në vitet e fundit, janë ngritur disa struktura lokale në varësi të AKM (12 Drejtoritë Rajonale të Mjedisit), ende këto nuk janë në gjendje (kapacitete të kufizuara) të ofrojnë aktivitete monitoruese në nivel vendor. Të vetmet agjenci varësie, në gjendje për ta bërë një shërbim të tillë, janë ato të ISHP²¹, që veprojnë në nivel vendor, nëpërmjet të cilave ISHP mund të monitorojë, si cilësinë e ajrit (rivendosur në funksion vetëm vetë para një viti), ashtu edhe atë të ujit të pijshëm. Edhe pse kampionimi kryhet manualisht, frekuencat janë brenda normave dhe standardeve të kërkuara, pavarësisht numrit të kufizuar të parametrave. Ka gjithashtu një mungesë të theksuar bashkëpunimi midis institucioneve, si në nivel lokal, ashtu edhe në nivel kombëtar, që ka të bëjë me të punuarit së bashku, ndarjen e të dhënave dhe informacionit mjedisor që secili prej tyre disponon, vënies në dispozicion të pajisjeve të monitorimit të njërit institucion për nevoja të tjetrit, atëhere kur nevojitet, si dhe kryerjes së inspektimeve apo monitorimeve të përbashkëta. Madje shpesh herë, aktiviteti i tyre mer format e një konkurrence të dukshme. Vetë - monitorimi, nga ana e subjekteve private, vetëm në tre vitet e fundit ka filluar të funksionojë, edhe pse ende ka pjesë të procesit që janë të paqartësuara, nga baza ligjore përkatëse Megjithatë, aktiviteti i vetë-monitorimit po funksionon rregullisht dhe në përputhje me parashikimet përkatëse. Por, konstatohet një mungesë reale e kontributit të këtij procesi në atë të hartimit të vlerësimeve të gjendjes së mjedisit nga të dhënat që vijnë nga subjektet, objektet leje mjedisore, pasi në shumicën e rasteve subjektet raportojnë për shkarkime brenda normave dhe laboratorët që përdorin edhe pse janë të akredituar të dhënat që prodhojnë nuk janë tërësisht të besueshme.

21 Instituti i Shëndetit Publik

Vërehet se për herë të parë janë përfshirë të dhëna mbi ndotjen industriale në 'RG-jMSh 2017' por ato kufizohen vetëm tek të dhëna statistikore sa i takon numrit të subjekteve raportuese dhe shpërndarjes së tyre sipas aktiviteteve dhe asaj gjeografike. Por, sa i takon kontributit që këto raporte vetë-monitorimi më të dhëna mbi treguesit apo parametrat e monitoruar për efekt të matjes së sasisë së shkarkimeve, nga subjektet që janë objekt leje mjedisi, mungojnë. Kjo bën që të ketë një mungesë reale në vlerësimin e gjendjes së mjedisit në vend duke përdorur edhe të dhënat që ofrojnë raportet e vetë-monitorimit të subjekteve. Kjo so të ishte një vlerë e shtuar e RGjMSh nëse një gjë e tillë do të aplikohet, duke e pasuruar atë dhë bazën e të dhënave që sot përdoren për vlerësimin mjedisor, si pjesë integrale e raportit.

Duke qenë se, ka një larmi të madhe institucionesh, që operojnë në nivel lokal, një bashkërendim dhe bashkëpunim më efektiv mes tyre, do të ndikojë shumë në drejtim të kryerjes së funksioneve monitoruese, në nivel më të mirë dhe duke e bërë procesin edhe më shumë efektiv e me përfitime, si nga pikëpamja e forcimit të kapaciteteve njerëzore, ashtu edhe të atyre monitoruese dhe rritjes së rolit dhe influencës së strukturave lokale, në drejtim të menaxhimit më të mirë, të aktiviteteve të caktuara mjedisore si dhe furnizimit me informacion dhe të dhëna mjedisore që mund të pasurojnë dhe furnizojnë më mirë dhe cilësisht procesin e përgatitjes së RGjMSh.

3.4 Menaxhimi i të dhënave dhe zbatimi i Sistemit të Përbashkët të Informacionit Mjedisor

Grumbullimi i të dhënave mjedisore në funksion të hartimit të një raporti të mirë të vlerësimit të gjendjes së mjedisit ka të bëjë me mbledhjen e të dhënave në një shkallë të përshtatshme. Ka dy nivele grumbullimi të cilat duhet të funksionojnë në këtë proces:

a- Horizontale (përmes zonave tematike dhe sektorëve), ku sektorët prioritarë mund të identifikohen në dokumenta politikë ose plane strategjik dhe/ose në një vlerësim sektorial. Për shembull, Inventari Kombëtar i GHG, grumbullon gjithë inventaret e shkarkimeve të sektorëve, me qëllim përcaktimin e indekseve të përgjithshme,

b- Vertikale (përmes shkallës gjeografike), e cila nevojitet, aty ku sistemi ka nevojë të marrë në konsideratë, të dhënat që ekzistojnë në një shkallë më lokale, për shembull nga qeverisjet vendore, komunitetet apo organizatat menaxhuese. Grumbullimi vertikal, është kryesisht i përdorshëm në monitorimin e bazuar tek hapsira, të tilla si biodiversiteti apo vlerësimi cilësisë së ujërave.

Grumbullimi i të dhënave nuk është i kufizuar vetëm tek analizat sasiore, por ai mund të përfshijë edhe rezultate cilësore të përmbledhura. Një tjetër dimension i shkallës, është ai i afateve kohore. Këto janë shumë të rëndësishme në sistemet e monitorimit, në mënyrë të veçantë, në rastet kur dukuritë e hulumtuara, kanë shkallë jo të njëjtë ndryshimesh. Ekzistojnë edhe situata rastësore, në të cilat faktori 'kohë' duhet të merret patjetër në konsideratë, për procesin e programimit, të një sistemi monitorimi. Në shumë raste nevojitet, që përshkrimi i

dukurive natyrore në mënyrë të besueshme, duhet të shoqërohet nga parashikimet kohore përkatëse, të cilat në këto raste, kanë një rëndësi të veçantë. Në këtë mënyrë p.sh. ka monitorime, për të cilat nevojitet monitorim i vazhdueshëm dhe vjetor (sezonal, mujor ose ditor), me qëllim grumbullimin e informacionit të nevojshëm (cilësia ujërave sipërfaqësore, ujërat bregdetare, cilësia e ajrit etj.), ndërsa në raste të tjera, si p.sh. monitorimi i specieve, mund të jetë i dobishëm, veçanërisht në periudha të caktuara. Shpeshia e raportimeve, është një element tjetër i rëndësishëm, që duhet marrë parasysh në një proces programimi. Kjo sepse, monitorimi shërben për të shpehur një ndryshim, apo stabilitet të një situate të caktuar, në një kohë e vend të caktuar. Në një situatë më pak të zakonshme, mund të ndodhë që të humbim luhatjet apo ndryshimet e ndërmjetme që mund të ndodhin mes frekuencave. Një situatë e zakonshme, sigurisht që kërkon më shumë burime financiare dhe njerëzore, por na siguron çdo gjë që na nevojitet të dimë.

Teknikisht, sistemi i informacionit të monitorimit duhet të kalojë nëpër disa etapa:

- a- Marrja e të dhënave nga burimi i informacionit (që mund të jetë një sensor automatik ose regjistër manual) dhe përcjellja e tij tek sistemi pritës i monitorimit.
- b- Para procesimi i të dhënave, duke përdorur hapa të tillë si kalibrimi, kontrolli dhe formatimi i të dhënave.
- c- Ruajtja e të dhënave në formatin e duhur.
- d- Paraqitja e të dhënave në formën e duhur për përdoruesit.

Pothuajse, gjithë të dhënat mjedisore që janë sot, mund të klasifikohen si të dhëna

hapsinore. Këto të fundit, na tregojnë se çfarë është duke ndodhur, ku po ndodh dhe janë përgjithësisht, të thjeshta për t'u kuptuar nga publiku dhe politikëbërësit. Vlerësohet si mjet shumë eficient, transferimi i të dhënave të monitorimit në sistemin e informacionit GIS. Ky model dhe aplikimi i tij, do të bënte të mundur matjen dhe integrimin e gjithë këtyre të dhënave dhe ndërtimin e një panorame të plotë, të gjithë asaj që po ndodh (figura 9 e ilustron mënyrën e mbivendosjes dhe integrimit të të dhënave të monitorimit në GIS). Aktualisht në Shqipëri, transferimi i të dhënave në sistemin GIS, aplikohet pjesërisht dhe në nivele jo shumë të larta.




Figura 9.
Mënyra e integrit të të dhënave të monitorimit, në sistemin GIS

Të dhënat hapësinore në vetvete, janë të dhëna vektoriale, të cilat përmbajnë referenca gjeografike, të tilla si koordinatat, forma e sipërfaqes fizike por njëkohësisht përfshijnë edhe shumë attribute të tjera. Ato, afrojnë më shumë kontekstin e informacionit mjedisor me procesin e të kuptuarit dhe vlerësuarit, të asaj se çfarë është duke ndodhur. Teknologjia GIS, bën të mundur që të punohet me të dhënat hapësinore, që vijnë nga shumë burime. Disa prej tyre, vijnë nga imazhet satelitore (*remote sensing*), disa të tjera nga sensorët automatikë dhe të tjerët nga lidhjet manuale, duke lidhur kështu programet e monitorimit me terrenin. Teknologjitë e reja, mund të grumbullojnë të dhëna edhe nga qytetarët, duke përdorur aplikacione specifike telefonike. Me qëllim, krijimin dhe funksionimin e një sistemi monitorimi të bazuar tek GIS, duhen plotësuar disa kushte. Kërkesa e parë është teknologjia, që ka të bëjë me pajisjen dhe instalimin me *hardware* dhe *software* të përshtatshëm. Ato, duhet të jenë gjithashtu të lidhura, me sistemin qëndror të të dhënave që do të marrë, ruajë, menaxhojë dhe procesojë nga sistemet periferike, që do të përdoren për të futur dhe shfaqur të dhëna, nga përdoruesit dhe rrjeti. Kushti tjetër, që duhet plotësuar, është krijimi i protokolleve të `hyrjes` dhe `kontrollit të cilësisë` dhe `sigurimit të cilësisë`, që mundësojnë certifikimin e cilësisë dhe kompatibilitetin e të dhënave. Kushti i tretë, është trajnimi dhe certifikimi i përdoruesve si dhe krijimi i mjedisit të favorshëm.

Sistemi i monitorimit i bazuar tek GIS, ka tre funksione kryesore:

1-Analiza e të dhënave (analizë hapësinore të të dhënave gjeografike për vlerësimin ose modelimin e proceseve dhe situatave);

2-Menaxhimi i të dhënave (ruajtjen dhe sistemimin e volumit të madh të dhënave të monitorimit, krijimi i bazës së të dhënave (*database*) dhe zbatimi i sistemeve kompjuterike);

3-Parqitja e të dhënave (publikimi i hartave dhe rezultateve shkencore në formate digjitale etj.)

Përpilimi i një sistemi monitorimi të mirë, ka për qëllim ndër të tjera, të asistojë përpjekjet e autoriteteve, që të veprojnë me një Sistem të Integruar të Monitorimit Mjedisor²², duke mbuluar gjithë komponentët: ajër, ujëra, tokë, pyje dhe biodiversitet, në formën e një pakete të stacioneve të monitorimit, për secilin komponent, të shoqëruar nga një paketë treguesish, që nevojitet të raportohet në vazhdimësi. Të tilla rrjete, duhet të jenë në përputhje, me kërkesat e legjislationit *aquis* të BE-së. Planifikimi dhe krijimi i tij, mbështetet tek parashikimet ligjore kombëtare, duke çuar tek përcaktimi i mekanizmave të nevojshëm, për programimin e monitorimit. Bazuar në këtë qasje dhe duke marrë në konsideratë, rëndësinë e procesit të monitorimit, si hallka e parë e rëndësishme e zinxhirit MDIAK dhe themelin e hallkave të tjera që vijnë pas saj, vlerësohet se sot në Shqipëri, nevojitet një rishikim i thellë i procesit të planifikimit të aktivitetit monitorues të gjendjes në mjedis, të bazuar tek treguesit mjedisorë, në përputhje me kriteret e sipër përshkruara i karakterizuar nga:

1- Riorientimi i klasifikimit tematik të treguesve mjedisorë dhe procesit të monitorimit, nëpërmjet rishikimit të akteve ligjore kombëtare, mbi të cilat bazohet monitorimi dhe treguesit

22 IEMS- Integrated Environmental Monitoring System

mjedisorë, në përputhje me tematikat e politikave mjedisore të BE.

- 2- Konvertimi i parametrave të monitorimit me treguesit mjedisorë, të cilët ofrojnë informacion lehtësisht të kuptueshëm dhe njëkohësisht përcaktimi i treguesve shtesë, që mund të dalin nga kombinimi i të dhënave ekzistuese.
- 3- Rishikim dhe zgjerim i plotë i listës aktuale së treguesve mjedisorë, në përputhje të plotë me kuadrin konceptual DPSIR, me qëllim sigurimin e një kuadri të nevojshëm për vlerësimin e politikave aktuale mjedisore në Shqipëri.
- 4- Integrimi i mekanizmave paralele (UNFCCC, CBD, AEM), ndaj të cilëve kemi detyrime monitorimi, që sot janë të mbivendosura me ato të AEM.

Planifikimi i një procesi të tillë monitorimi do të ishte tërësisht në përputhje me kriteret dhe standartet evropiane ekzistuese dhe do të siguronte, të dhëna cilësore dhe reale të gjendjes së mjedisit në Shqipëri, të bazuara tek treguesit mjedisorë, mbi të cilët do të mund të bëheshin vlerësime, gjykime dhe jepeshin konkluzione e rekomandime me vlerë, në ndihmë të publikut e politikëbërësve, por njëkohësisht edhe duke përmbushur kërkesat dhe obligimet e raportimeve, që vendi ka drejt institucioneve evropiane, duke mbyllur kështu ciklin e plotë (MDIAK) e duke trajtuar gjithë hallkat e tij, me cilësi dhe standard të padiskutueshëm.

4 ANALIZË E KOMUNIKIMIT TË INFORMACIONIT MJEDISOR NË RGJMSH



4.1 Tipologjia e komunikimit publik në Shqipëri

Konceptet e sotme të komunikimit publik e pozicionojnë qytetarin në zemër të procesit të komunikimit, ku energjitë dhe burimet financiare janë të gjitha të orientuara drejt tij. Në këtë këndvështrim, është institucioni ai që duhet ta gjurmojë qytetarin dhe jo detyrimisht qytetari duhet të trokasë pranë institucionit për të pasur akses në informacion. Integrimi i qytetarit në procesin e vendim-marrjes është detyrim ligjor dhe nuk mundet që një titullar institucioni ta shmangë këtë detyrim me justifikimin e mospërgjigjes apo interesit të ulët të publikut. Është detyrë e institucionit që ta gjejë qytetarin, ta informojë, ta përfshijë në vendim-marrje, edhe atëhere kur ai reziston ndaj mesazhit.

Komunikimi publik, nuk është si komunikimi i një ndërmarrjeje biznesi. Ai nuk lidhet me leverdinë, nuk është hallkë ndërmjetëse apo instrument për të arritur një qëllim të caktuar, por është qëllim në vetvete, është një deontologji e shërbimit ndaj qytetarit. Komunikimi publik është detyrë, që do të thotë se autoriteti publik duhet të punojë vazhdimisht në drejtim të krijimit të kanaleve të komunikimit të përhershëm edhe me atë pjesë të popullsisë që mund të mos kenë angazhimin e nevojshëm. E parë në këtë prizëm, synimi i parë duhet të jenë ato grupe të shoqërisë që për shumë arsye nuk e kanë kulturën e të informuarit dhe nuk bashkëveprojnë në përditshmërinë e tyre me institucionet.

Komunikimi publik në Shqipëri ka një qasje drejt personalizimit të komunikimit, ku persona me status publik kërkojnë trajtim të diferencuar. Por parimet e sotme të komunikimit në publik shprehin se qytetarët duhet të trajtohen të gjithë si të barabartë, pavarësisht statusit që përfaqësojnë.

Institucionet shpesh konsiderojnë se janë zëvendësuese të interesit të publikut, në fakt ato janë përçuese të interesit të pub-

likut dhe në thelb janë krijesa të publikut. Ideja e “përfaqësimit” e ngulitur në mendësinë e njerëzve, e ka origjinën që nga mesjeta, thotë Jurgen Habermas²³, ku fisnikët, aristokracia, kleri i kishës, i njihnin vetes legjitimitet për të dominuar hapësirën publike, ekonomikisht, politikisht, dhe në diskurs.

4.2 Pjesëmarrja e publikut në procesin e hartimit të RGjMSh

RGjMSh ka qëllim kryesor të tijin informimin për gjendjen e mjedisit në Shqipëri vit pas viti. Këtë e citon dhe vetë raporti që në fillim “Qëllimi i këtij raporti, në radhë të parë është, informimi për gjendjen e mjedisit në Shqipëri, mirëpo të dhënat e tij janë një bazë e mirë edhe për ndërtimin e politikave edukative mjedisore dhe për orientimin e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorë të cilët kanë ndikim në mjedis siç janë: ekonomia, industria, energjetika, transporti, bujqësia etj. *Jo më pak i rëndësishëm është qëllimi për informimin për gjendjen e mjedisit në Shqipëri, të publikut të gjerë, donatorëve, studiuesve dhe grupeve tjera të interesit*”.

Referuar VKM-së nr. 1189/18.11.2009, siç e kemi përmendur dhe më sipër në studim, sipas Kreut III, pikës 8 në monitorim marrin pjesë edhe personat fizikë e juridikë, veprimtaria e të cilëve është subjekt i lejeve mjedisore. Ndërsa për publikun dhe OShC-të nuk cilësohet asgjë e veçantë. Në kuadrin e përmirësimit të legjislationit duhet punuar në pikën e përfshirjes së publikut në hartimin e RGJM-së, së paku duke trajtuar çështje mjedisore që janë më afër shqetësimit publik, duke u konsultuar për indikatorët, parametrat apo ngjar-

23 <https://citizens-channel.com/2017/03/29/aksioni-civil-si-pushtet-i-deleguar/>

jet mjedisore që duhet të përfshihen në Raport.

Përsa i takon publikimit të RGJM-së në përfundim të tij, edhe sipas VKM-së nr. 1189/18.11.2009, edhe në praktikën e përhershme të AKM-së, në përfundim të procesit të monitorimit me të dhënat e siguruar nga monitorimi AKM-ja boton çdo vit RGJM-në. DRM-të duhet të përgatitin Raportin e Gjendjes së Mjedisit në bazë qarku dhe ta publikojnë atë në variantin elektronik.

Publiku duhet të ketë akses më të madh në informacionin dhe vlerësimet mjedisore që raporti i gjendjes së mjedisit. Njëkohësisht ai duhet të ketë një rol më aktiv duke dhënë kontributin e tij në furnizimin me të dhëna dhe informacion mjedisor mbi dukuri apo fenomene mjedisore që mund të përcillen në kohë reale pranë institucioneve përgjegjëse. Këto mund të jenë evidentuara prej tyre në mënyrë rastësore ose jo direkt në terren. Aktualisht nuk ka asnjë instrument si ligjor ashtu edhe komunikimi, që të mundësojë dhënien e një kontributi konkret të publikut në përgjithësi apo grupeve të caktuara të interesit në veçanti me informacion, të dhëna, zbulime apo konstatime të karakterit mjedisor të cilat mund të verifikohen më tej nga persona të specializuar për vërtetësinë apo besueshmërinë e tyre dhe më tej të bëhen pjesë e vlerësimit mjedisor, po ti referohemi këtu akteve ligjore në fuqi mbi të cilat bazohet hartimi i RGJM – së dhe vlerësimi e monitorimi i mjedisit. Për këtë qëllim nevojitet që VKM-ja nr. 1189/2009 të rishikohet duke i dhënë hapësirë edhe rritjes së aksesit të publikut në përgjithësi dhe `citizens science` në veçanti duke bërë të mundur furnizimin e tij me të dhëna mjedisore që vijnë direkt nga kontributi qytetar apo shoqërisë civile, përpos asaj shken-

core dhe profesionale. Edhe pse publikut (referuar VKM-së nr. 1189/2009) i lejohet aksesit tek të dhënat mjedisore që përdoren për vlerësimin mjedisor, ai nuk ka akses në ofrimin dhe furnizimin me të dhëna apo informacion mjedisor. Një instrument interesant dhe produktiv i aplikuar sot në disa vende të zhvilluara të Evropës është ngritja e një rrjeti mbarëkombëtar i përbërë nga qytetarë dhe shoqëri civile aktive në çështjet mjedisore të cilët mund të bëhen pjesë e procesit nëpërmjet ngritjes së platformave online të grumbullimit të informacionit mjedisor direkt të siguruar nga qytetarët.

Shembulli i mësipërm është një shembull pozitiv i “demokratizimit të burimeve” të informacionit. Në të ardhmen, për rastin e Shqipërisë ky demokratizim burimesh duhet të mendohet si një strategji që e nxjerr RGJM-në nga skema e një pune rutinore që shpërndahet tek pak aktorë. Konsiderimi i burimeve të tjera do të krijonte shumë më tepër mundësi për rritje kapacitetesh monitoruese. Kolektivizimi i procesit duke integruar aktorë nga shoqëria civile (me kapacitetet e duhura monitoruese), bota akademike, apo dhe partnerë ndërkombëtarë do ta kthente RGJM-në në një aset kombëtar të përdorshëm në shumë sfera të shoqërisë, me përdorim të padiskutueshëm.

4.3 Analizë e komunikimit të informacionit mjedisor tek publiku

4.3.1 Raportimi i ndotjes

Vlerësimi i treguesve mjedisorë ka dy dimensione: Dimensioi i parë ka të bëjë me transparencën ndaj qytetarëve dhe i dyti me implikimet ekonomike që ka çdo tregues. Të dhënat e ndotjes nuk mund të kenë kuptim pa referencat përkatëse me dinamikat ekonomike të zhvillimeve indus-

triale të secilit qytet, të secilit ndotës, apo të sektorëve të veçantë që e kanë gjeneruar këtë ndotje. Për këtë arsye kur flitet për *trend*, nuk mund të analizohet i shkëputur, vetëm *trend*-i i ndotjes, por duhet të shikohet në mënyrë të integruar edhe sesi lëvizin trendet e aktivitetit ekonomik, industrial, demografik, urbanistik, etj. Nëse këto të dhëna nuk do të merren në analizë në raportet vlerësuese për ndotjen, atëherë do t'ia delegojmë "fajin" ajrit. Ekspozimi i shkaqeve, nga pikëpamja e informimit ndaj publikut, mund të shërbejë për të rritur sensibilitetin, dhe t'i detyrojë autoritetet që të reagojnë. Në të kundërt nëse në raport konstatohet vetëm ndotja dhe nuk ka një arsyetim se nga vjen ajo, vështirë të ketë efekte mbi përmirësimin e situatës;

Një kufizim i tillë shfaqet në Raportin e vitit 2016 për Gjendjen e Mjedisit ku thuhet se: "*Mosnjohja e inventarit të emisioneve në zonat e studiuara përbën një pengesë për interpretimin e saktë të rezultateve*". Pra, në këtë rast nuk dihet se çfarë emetohet, dhe cili është burimi i emetimit. (RGjM 2016, Fq. 90)

4.3.2 Raportimi i parametrave të shkarkimeve

Të dhënat e matjeve për nivelet e ndotjes jepen të mesatarizuara dhe kjo është e kuptueshme si metodologji, por do të ishte më e frytshme për një publik që do ta lexonte raportin, që në rastet e tejkalimit të nivelit të pranueshëm të ndotjes, të jepeshin të dhëna të kryqëzuara, për dëmet shëndetësore që mund të shkaktohen, apo të dhëna të kryqëzuara, që mund të tregojnë rrezikun e pritshëm për publikun.

Përtej matjeve të fiksuara në metodologji, mungon fleksibiliteti për të ndjekur në dinamikë nivelin e ndotjes në qytete të ndryshme, në zona të dedikuara, atje ku ka aktivitet industrial të shtuar. Në këtë kontekst, nuk ka matje kampion në lidhje me

sinjalizime për ditë të veçanta, kur mund të ketë patur ndonjë episod të veçantë. Në raport thuhet: "*Bazuar në të dhënat statistikore për numrin e ditëve që tejkalojnë normën ditore të PM_{10} , vërejmë se kemi tejkalim në stacionin e Korçës, ku kemi 65 ditë në vit dhe Tirana AKM ku kemi tejkalim 76 ditë nga 35 që është numri i ditëve të lejuar në një vit*". Në këtë rast është e nevojshme që informacioni të detajohet, sa ka qenë dita më e ndotur, me cilat aktivitete ka lidhje, në cilat javë, në cilët muaj, në cilat zona specifike? (RGjM, 2016, fq 64).

Në raport thuhet se matjet janë kryer edhe me mjete të lëvizshme, por rezultatet i referohen stacioneve statike, siç është Ministria e Mjedisit, AKM-ja. Mjetet e lëvizshme do të duhej të krijonin një hartë shumë më të dendur matjesh, në pika të ndryshme, të shpërndara në territor dhe sigurisht sipas profileve sociale dhe ekonomike të zonave.

Si shkaktarë të ndotjes është mirë që të specifikohet se cilat janë dëmet në mjedis dhe në shëndetin e njeriut që mund të shkaktojnë " PM_{10} ", " $PM_{2.5}$ ", bashkëveprimi me faktorë atmosferikë, specifikimi sipas vendit, kohës. Informacioni i tillë do t'ua kontekstualizonte raportin qytetarëve me mjedisin rrethues. Gjithashtu, do të ishte më me vlerë që elementet kimikë ndotës të sqaroheshin në elemente shoqërues të përditshmërisë për t'i identifikuar se çfarë përfaqësojnë këto elemente, ku i gjejmë dhe çfarë mund të bëhet për t'i shmangur.

4.3.3 Burimet e ndotjes: Raportimi mbi efektet në mjedis dhe në shëndetin e njeriut

Trajtimi i vlerave të ndotjes në vlera përgjithësuese është e nevojshme nga pikëpamja shkencore, megjithatë vlerat e relativizuara sipas lokalitetit, dhe llojit të burimit të ndotjes, kanë rëndësi për dy arsye: ndihmojnë institucionet të orientojnë

politikat sipas vendodhjes së zonës së ndotur dhe llojit të masave për të ulur ndotjen si dhe janë të vlefshme për publikun për të ditur kostot ekonomike të ndotjes në vlerën e pasurive të tyre.

Në lidhje me burimet e ndotjes, ekziston nevoja për një identifikim të statusit të ndotësit me sinjalistikën përkatëse, me ikonografi të qartë, shpjegimin e shkatërrarëve gjithashtu me sinjalistikën përkatëse, si edhe me llojin e rrezikut - faktori natyror dhe ai antropogjen. Kjo pasi ndotja industriale nga aktiviteti njerëzor nuk mund të ketë të njëjtin status si shkarkimet e shkaktuara nga faktorë natyrorë, për shkak se presupozohet që, nëse shkarkimet natyrore nuk janë të eliminueshme, ndotja me origjinë antropogjene mund të jetë e reduktueshme.

Në këtë kuadër një problematikë lidhur me “zhurmat” është se mungojnë matjet, që përcaktojnë trendin në vite. Gjithashtu ato targetojnë kryesisht zhurmat e makinave në rrugë, jo llojet e tjera të zhurmave që kanë të bëjnë me industrinë apo me aktivitetet rekreative. Lidhur me këto të fundit mungojnë matjet sezonale.

4.3.4 Identifikimi i publikut

RgjM-ja përveç dokumentimit të gjendjes së mjedisit, në fakt përmend edhe sensibilizimin e organeve vendimarrëse në nivel lokal apo qendror, flitet për sensibilizimin e popullatës dhe grupeve të interesit, për shoqatat të interesuara direkt apo tërthorazi për mjedisin. Kjo lexohet si përpjekje e raportit për të dalë nga dimensionin thjesht shkencor, dhe për të shkuar tek publiku “influencues”, pra tek vendimarrësit, por dhe tek publikët e targetuar, tek komunitetet që ndikohen direkt ashtu si edhe tek publiku i gjerë. E, nëse publikun “influencues” është më e lehtë ta ndikosh për shkak të interesit të drejtpërdrejtë, apo publikut komunitar

që e pëson direkt dëmin, publiku i gjerë që nuk ndikohet drejtpërdrejt, e ka më të vështirë që të kuptojë problematikën, prandaj ka nevojë të asistohet me materiale më të thjeshtëzuar. Këto materiale duhen komunikuar në forma e me mjete të ndryshme si: takime, seminare, trajnime e forume në shkolla, universitete, etj.

Arritja e publikut do të jetë më e sukseshme nëse ai nuk konsiderohet thjesht si destinacion i emetimit të informacionit, por si një aktor veprues për të frenuar pasojat e raportuara në Raport. Për shembull, çdo individ ka nevojë të dijë sa ujë harxhon në ditë, sa kapacitet kanë burimet që e furnizojnë, kur dhe si ta përdorë ujin, për cilat funksione, kufizimet që mund të sjellë përdorimi afatgjatë, etj. Në këtë mënyrë krijohet një sistem më interaktiv informacioni, sepse qytetari shtyhet që të ndërtojë raport më të kujdesshëm me këtë burim të pazëvendësueshëm.

Gjithashtu, ofrimi i masave parandaluese është një formë tjetër e efektshme për të arritur gjithnjë e më shumë publikun, pasi një individ të cilit i janë ofruar zgjidhje dhe është i sensibilizuar mund të kthehet në llogari-kërkues aktiv. Në këtë kontekst, treguesit e menaxhimit të efektshëm të ujit si: matja e konsumit, cilësia e ujit të pijshëm është nevoja që të ilustron në mënyrë më të kuptueshme jo thjesht vizualisht, por dhe më konkretisht për kufizimet e pritshme dhe cilat mund të jenë masat parandaluese.

4.3.5 Reformimi i konceptit të raportimit

Interpretimi i rezultateve, bazuar në Kuadrin DPSIR rekomanduar nga Agjencia Europiane e Mjedisit (EEA).

Forcat Shtytëse	→	Presionet	→
Gjendja e Mjedisit	→	Impaktet	→
Reagimet			

Kuadri konceptual DPSIR i Agjencisë Evropiane të Mjedisit, ka qasje të ndryshme nga modeli i raportimit të “Raportit të Gjendjes së Mjedisit”, sepse del nga të dhënat e ngushta shkencore dhe hyn në një logjikë sistemike, ku dinamikat shpjegohen mbi bazë forcash dhe jo thjesht mbi shkaqe fundore. Përtej shkaqeve të dokumentuara, ka disa shkaqe që janë strukturore dhe sistemike, që funksionojnë në nivel social dhe politik.

Për një publik të gjerë do ishte shumë e dobishme që të kuptonte logjikën sistemike ku mjedisi konsiderohet si një aset ekonomik dhe jo thjesht si ngjarje natyrore. Kjo ndryshon edhe pozicionin politik të publikut ndaj mjedisit, sepse nuk mundet që për dëmet të cilat pëson mjedisi, të fajësohet vetë mjedisi. Kjo metodë ndryshon tërësisht formën e raportimit duke e tejkalluar atë tradicionale dhe duke nxjerrë në pah që gjendja e mjedisit nuk është thjesht “gjendje e mjedisit”, por është edhe gjendja e institucioneve dhe e shoqërisë.

Në këtë frymë, të përcaktohet që “ndërtimi si sektor është forcë shtytëse” është një informacion i rëndësishëm për publikun, sepse ai në këtë formë ka mundësinë që të kthehet në një aktor të rëndësishëm që ushtron presion tek autoritetet. Siç vërehet dhe nga forma e raportimit, sidomos në rastin e përmbytjeve, faji nuk i lihet fenomeneve natyrore, por aktiviteve njerëzore, publiku ftohet ta kuptojë ekosistemin si raport forcash, ku ka disa forma presioni njerëzor që prodhojnë pasojë.

4.4 Sugjerime për ta bërë komunikimin më efektiv

4.4.1 Raportimi dhe gjuha e komunikimit

Gjuha e komunikimit në raportim është me rëndësi, sepse kërkon normativën e korespondencës mes fjalëve dhe shen-

jave. Nëse do të marrim si shembull ilustrues raportimin mbi cilësinë e ujit, nëse në një rast ajo quhet “shumë e mirë”, dhe në një rast të dytë, për të njëjtin tregues, përdoret termi cilësi “e shkëlqyer”, kjo korespondencë mungon. Kur themi “cilësi e mjaftueshme” e ujërave, nëse duam ta komunikojmë për publikun, është e papërcaktuar se çfarë do të thotë semantikisht, dhe nuk ka një mënyrë se si mund të shenjohej si tregues për t’iu komunikuar publikut. Publiku ka nevojë për një shenjë të qartë dhe të përcaktuar që t’i tregojë nëse mund ta përdorë ujin. Sistemi i shkallëzuar me disa rangje - nga cilësia më e mirë, tek cilësia më e keqe - nuk premtonte efektivitet. Në këtë rast, do të mjaftonte “cilësia shkëlqyer” - që do të shërbente dhe për ta “branduar” plazhin (nëse do të merremi atë si shembull) të cilit i referohet.

4.4.2 Komunikimi i gjendjes së mjedisit

4.4.2.1 Toka, Erozioni

Dy tregues që me siguri meritojnë të kuptohen dhe të thjeshtohen për publikun janë forma e përdorimit dhe ruajtja e cilësisë së tokës. Të dyja janë simbiotike, pasi cilësia e tokës varet nga forma e përdorimit dhe përdorimi i tokës varet nga cilësia e tokës. Në këtë rast mund të operohet me sinjalistikë të dallueshme, të gjithëpërfhapur, për arsye se nga cilësia e tokës varen të gjithë ushqimet organike që kemi në tryezat tona, varet e ardhmja ekonomike e një zone, orientimi i zhvillimit, dhe lloji i përdorimit të saj në të ardhmen.

Shkaktarët e ndotjes së tokës, gjithashtu është mirë që të jenë të identifikuar me statuset përkatëse si rreziqe potenciale:

1. Pjelloria e Tokës, është një tregues i rëndësishëm, që kërkon sinjalistikë përkatëse.

2. **Aksesibiliteti i tokës për aktivitet bujqësor** është i rëndësishëm dhe përbën një informacion bazik, që do ta ndihmonte publikun për të ditur nëse ia vlen të investohet apo jo dhe se si mund të silltet që toka të ruajë parametrat e kërkuar në të ardhmen, duke shmangur rreziqet e aktivitetit njerëzor.

3. Rëndësi ka që të identifikohen shkaktarët e **ndotjes industriale**, nëse janë faktorë të brendshëm apo nga faktorë të jashtëm përtej proceseve bujqësore.

4. **Metalet e rënda** po ashtu duhet të thjeshtohen, nga se shkarkohen, ku gjenden, dhe si mund të dëmtojnë shëndetin e njeriut dhe gjallesave të tjera.

5. **Faktorët antropogjenë**, si tregues mund të kenë ikona dalluese, në mënyrë që të veçohen nga faktorët natyrorë, ashtu siç dhe raporti e kërkon. Koncepte të reja bashkëlidhura në këtë kontekst si “*anthropocene*”²⁴, ilustrojnë më mirë nga ana komunikative faktorët antropogjenë.

6. **Impakti ekonomik** i fenomeneve natyrore të ndikuara nga dora e njeriut, duhet të jetë një ikonografi identifikuese, sa për të sinjalizuar kostot që i shtohen ekonomisë për shkak të aktivitetit të pakontrolluar të dorës së njeriut. Po të mbajmë parasysh që shenja e parasë, ka një forcë komunikuese universalizuese, dhe asocimi me fenomene natyrore të shkaktuara nga dora e njeriut, ndoshta thjeshton për publikun e gjerë, rëndësinë e ruajtjes së ekosistemit, duke e përkthyer në terma ekonomikë.

7. Vetë elementet kimikë është mirë që jepen me sinjalistikën përkatëse

24 <http://quaternary.stratigraphy.org/work-ing-groups/anthropocene/>
<https://www.weforum.org/agenda/2016/08/what-is-the-anthropocene-and-why-does-it-matter/>
<https://www.youtube.com/watch?v=zhNumFBOWVI>

duke ilustruar rrezikshmërinë e një aktiviteti që transformon parametrat kimik të tokës. Ata duhet të shpjegohen për të krijuar një kontekst më të plotë për informacionin që shpërndahet.

8. **Pasojat shëndetësore të ndotjes** gjithashtu njëlloj si shkaqet e kategorizuara, mund të shënohen në formë shenjash gjurmë, ku jepet pasoja fizike, e analoguar me një figurë që përngjason, apo në formë simbolike me një simbol që jo medoemos ka lidhje ngjashmërie. Një praktikë e ngjashme ka filluar të zbatohet në Raportin e fundit për Gjendjen në Mjedis.

4.4.2.2 Biodiversiteti

1. Rrjeti ekologjik i zonave të mbrojtura

Është me rëndësi për publikun që të dihet të dallojë “Parkun Kombëtar”, “Monumentin e Natyrës”, “Peizazhin e Mbrojtur”, si hapësira me status të veçantë që imponojnë një sjellje të caktuar konservuese. Mendoj se të dyja ikonografitë mund të bashkëjetojnë, si ajo për “Zonat e Mbrojtura” dhe ajo për nënkategoritë e tyre, që mund të jetë me një ikonografi pecifike të vlerave më përfaqësuese për zonën e mbrojtur përkatëse apo për kategorinë.

2. Monumentet Natyrore

Vetë raporti shpreh se komunikimi i monumenteve të natyrës duhet të përmirësohet duke shtuar dijejminim e legjendave:

“Në vëmendje të rritjes së kujdesit për Monumentet e Natyrës të cilat në Shqipëri janë 746 (gjithsej) nga të cilat 348 bio-monumente dhe 398 gjeo-monumente, me shpërndarje gati gati uniforme në territorin shqiptar; sot ekziston mundësia e dizenjimit të legjendave për vlerat kulturore, turistike dhe shkencore. (RGJM, 2016, Fq. 268).

4.5 Komunikimi i normativës ndërkombëtare

Konventat mjedisore, programet e BE-së, të gjithë sipërmarrjet normative është e nevojshme të shpjegohen për publikun: në radhë të parë statusi juridik i këtyre normativave, çfarë fuqie kanë këto mbi legjislacionin shqiptar, çfarë detyrimesh ka shteti shqiptar në lidhje me këto konventa, apo direktiva, cili është roli i publikut, çfarë të drejtash ka ai nga pikëpamja e informimit apo pjesëmarrjes? Publiku duhet të informohet nëse një zonë mbrohet nga legjislacioni ndërkombëtar dhe në çdo rast ky informacion duhet të jepet e të shoqërohet me shenja dalluese të posaçme.

4.6 Raporti i ICCP - Një shembull pozitiv i raportimit parë nga aspekti komunikativ

Me synimin për të sjellë një praktikë të mirë të komunikimit të një raporti është me vlerë të paraqitet një model ilustrues i një fushate gjithëpërfshirëse për komunikimin e gjithë punës monitoruese që është bërë në kuadër të një raporti. Raporti i përzgjedhur si model është ai i IPCC (The Intergovernmental Panel on Climate Change), që është një organizëm i ngritur më 1988 nga *Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin*, dhe *Organizata Ndërkombëtare e Metereologjisë*, në mënyrë që të garantojë një qasje shkencore në lidhje me ndryshimet klimaterike dhe impaktin e tyre në rendin social, ekonomik dhe politik në botë. Organizmi në fjalë është më kompetenti në këtë fushë, dhe sigurisht që përvoja e gjatë, e bën raportin interesant për t'u analizuar nga ana komunikative.

Së pari, raporti ka një faqe interneti të gjithën të dedikuar me një mori rubrikash, që zërthejnë përmbajtjen e tij, por ka edhe shumë rubrika tjera, që lidhen me komunikimin tërësor të raportit. Në

rubrika gjejmë parimet dhe procedurat që organizmi dhe trupa e shkencëtarëve vënë në zbatim përgjatë gjithë procesit të punës; një përshkrim i të gjithë grupeve të punës bashkë me detyrat përkatëse, aktivitetet përgatitore në kuadër të përgatitjes së raportit, kalendari i detajuar i aktiviteteve para dhe pas publikimit të raportit.

Nga pikëpamja e komunikimit raporti ka një strategji në lidhje me synimet dhe mjetet që do përdoren për të realizuar komunikimin e raportit dhe organizatës.²⁵ Dokumenti ka të detajuara synimet e organizatës nga pikëpamja komunikative, kodin institucional të ndërtimit të ligjërimit, etikën e përmbajtjes së raportit, pozicionimin e organizatës pa kahje politike, audienat e synuara etj.

Në komunikimin me mediat, raporti është i shoqëruar me formatin e një komunikate për shtyp, me gjetjet të shprehura me gjuhë të thjeshtuar, ndërkohë që ka një dokument të veçantë vetëm për politik-bërësit²⁶ dhe kjo e bërë publike për mediat. Qëllimi i këtij dokumenti është që raporti të bëhet i kuptueshëm për vendim-marrësit, me një gjuhë që ata mund ta kuptojnë. Komunikimi me jashtë është i konceptuar në formë takimesh, shoqëruar me disa dokumenta: fletëpalosje, factsheet-e për raportin dhe organizatën, broshura, postera, video, animacion, power-point, prezantime gjenerike “slide deck”, ku ndërfitet teksti përshkruar me fjalën në një dokument.²⁷

Nga pikëpamja e përmbajtjes së raportit, në faqen e internetit gjen si lidhje elektronike me vete çdo kapitull të veçantë, përmbledhjen, konkluzionet, përmbledhjen për politikëbërësit, paragrafët e raportit, një skicë të përgjithshme dhe një dokument për sfondin e të gjithë procesit të ndërtimit të dokumentit, një dokument “FAQ” që veçon pyetjet më të përsëritura me përgjigje.

25 http://www.ipcc.ch/meeting_documentation/pdf/Communication/IPCC_Communications_Strategy.pdf

26 http://report.ipcc.ch/sr15/pdf/sr15_spm_final.pdf

27 http://www.ipcc.ch/news_and_events/outreach.shtml

jet përkatëse²⁸.

Nisur nga ilustrimi me shembulin e mësipërm të raportimit, RGjM duhet të ketë një dokument mbi strategjinë e komunikimit që përdor, një ndërfaqe të internetit të dedikuar, një përmbledhje qoftë për një publik të kufizuar influent, apo një publik më të zgjeruar, disa factsheet-e apo broshura si dhe në çdo rast, një deklaratë për shtyp përmbledhëse.

Në këtë drejtim komunikimi i RGJM-së ka mangësi dhe shfaq nevojë për përmirësimin e komunikimit. Përmirësimin i komunikimit nuk do të thotë thjesht të komunikosh mirë atë raport që disponon, por ta konceptosh raportin në atë mënyrë që të jetë i komunikueshëm, pa cënuar standaret shkencore të pranuar brenda komunitetit.

28 <http://www.ipcc.ch/report/sr15/?fbclid=IëAR30hSmds95CRGETqAAM9dXTFF8evl2r0JSBwOoqAqXPs-2TzW9AkAenNUg>



5 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME



1. Duke qenë se RGjMSh ofron të dhënat bazë të përpunuara dhe me vlerësime e interpretimet përkatëse në lidhje me gjendjen e mjedisit, të cilat më pas përdoren për t'ua komunikuar politikëbërësve dhe publikut të gjerë brenda vendit por njëkohësisht edhe për të kryer detyrimet raportuese ndërkombëtare, duhet vënë në dukje *nevoja e unifikimit të plotë të metodologjive të përdorura për monitorimin e çdo parametri mjedisor, me atë të vendeve të tjera të BE-së të përcaktuar edhe në secilën prej direktivave evropiane përkatëse.*

2. Duhet theksuar fakti që, ndërkohë që legjislacioni shqiptar po përafrohet gjithmonë e më shumë me atë evropian, duke përfshirë këtu edhe çështjet e monitorimit të gjendjes së mjedisit, mbi të cilin kryhet vlerësimi dhe hartimi i RGjMSh, atëherë gjithmonë e më shumë del si domosdoshmëri urgjente *Rishikimi i VKM-së aktuale 1189/2009 të monitorimit, duke e zëvendësuar atë me një akt tjetër ligjor ku të adresohen çështjet e monitorimit mjedisor në mënyrë më të integruar dhe në koherencë të plotë me paketën ligjore mjedisore aktualisht në fuqi në Shqipëri dhe të parafruar me atë të BE, si dhe të pasqyrojë ndryshimet institucionale të ndodhura në Shqipëri dhe detyrimet e tyre sa i takon kontributit për këtë proces.*

3. Treguesit mjedisorë, përgjithësisht përdoren për të raportuar zhvillime të caktuara mjedisore, që kanë ndodhur në të kaluarën si dhe të sigurojnë historikun e tyre kohë pas kohe (trendet mjedisore). Kjo duhet të interpretohet në raportet e gjendjes së mjedisit duke arritur në *konkluzione për ecurinë mjedisore të një rajoni të caktuar të bazuar në të dhëna mjedisore të besueshme, të sakta nga pikëpamja metodologjike dhe të shtrira në kohë.*

4. Në përgjithësi monitorimi në

Shqipëri vuan nga mungesa e procedurave që kanë të bëjnë me Sigurimin e Cilësisë (QA- *Quality Assurance*) dhe Kontrollin e Cilësisë (QC-*Quality Control*) si dhe nga mungesa e integritit dhe përdorimit të teknikave të GIS, në përpunimin dhe analizat e informacionit mjedisor të grumbulluar nga proceset monitoruese. Treguesit mjedisorë në Shqipëri, mund të thuhet që mbulojnë gjithë tematikat mjedisore kryesore të përfshira edhe në politikat mjedisore aktuale në vend. Megjithatë dhe pavarësisht kësaj, ka një nevojë prezente për *rishikimin dhe rifreksimin e tyre, në përputhje me tematikat dhe politikat e reja, të konsideruara më së fundmi si prioritare në vend dhe më gjerë, duke aplikuar një qasje më të integruar të tyre.*

5. *Ripërcaktimi i treguesve mjedisorë të biodiversitetit përbën sot një prioritet me qëllim që të sigurojë një pasqyrë të plotë e të qartë të statusit ekologjik të zonave të mbrojtura dhe specieve në Shqipëri.*

Ekziston nevoja e rishikimit të kuadrit ligjor ku bazohet hartimi i raportit të gjendjes së mjedisit, gjatë të cilit duhet të kihet parasysh edhe reflektimi i VKM-së Nr. 866, datë 10.12.2014 *“Për miratimin e listave të tipave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për BE”*, e parafruar me ato të BE-së gati plotësisht. Konkretisht amendimi i VKM-së nr. 1189/2009 duhet të bëhet në përputhje me atë nr. 866/2014 duke përfshirë një rishikim të plotë të treguesve të biodiversitetit në. Kjo është e domosdoshme pasi vazhdimisht është evidentuar nevoja e grumbullimit të të dhënave të nevojshme shkencore në lidhje me vlerësimin e gjendjes së biodiversitetit në Shqipëri. Këto të dhëna janë të nevojshme jo vetëm për dizenjimin e rrjetit sipas Natura 2000, Direktivës së Habitaveve por njëkohësisht

ato shërbejnë edhe për të kryer një vlerësim cilësor dhe me standarte të gjendjes bazuar në këto të dhëna, vlerësimi i cili në gjykimin tonë është pjesa më e mangët e raportit.

6. Sot në paketën aktuale të treguesve mjedisorë ka shumë prej tyre që shërbejnë për të monitoruar parametrat 'shkencorë', mjaft të rëndësishëm për studime shkencore, por që ofrojnë një përdorim mjaft të kufizuar për politikëbërësit dhe publikun. Kjo gjë çon në mungesën e lehtësirave të komunikimit të këtyre treguesve tek publiku si p.sh. 'cilësia e ujërave larës'. Edhe pse në listën e treguesve mjedisorë, përfshihet monitorimi i gjithë parametrave mikrobiologjikë që përdoren për këtë tregues, *vlerësimi gjendjes bëhet i vështirë dhe mjaft teknik pasi edhe parametrat e monitoruar janë të tillë dhe nuk mund të interpretohen lehtësisht nga të gjithë, por vetëm nga grupe të caktuara njerëzish, që disponojnë ekspertizën e duhur.*

7. Raporti Gjendjes së Mjedisit në Shqipëri që hartohet çdo vit mbi bazën e treguesve mjedisorë, nuk reflekton në tërësinë e tij vlerësime të kryera në përputhje me zinxhirin e plotë konceptual mbi të cilin klasifikohen treguesit mjedisorë sot në Evropë (DPSIR). Kjo e bën këtë raport jo të plotë, sa i takon shkallës së përfaqësimit të gjithë treguesve mjedisorë të aplikuar gjerësisht. Njëkohësisht kjo e bën të vështirë lidhjen midis gjetjeve të RGJM-së dhe politikave mjedimore kombëtare dhe matjes së efikasitetit të tyre, çka bën që raporti të mos përmbushë misionin e tij kryesor dhe veçanërisht të mos ofrojë informacion të plotë dhe të kuptueshëm për publikun e gjerë. *Në raport mund të integruara me të dhëna dhe informacion*

që vjen jo vetëm nga monitorimi i treguesve mjedisorë, por njëkohësisht dhe nga ai që duhet të furnizohet nga subjektet e operatorët privatë, objekt lejeje mjedimore në nivel lokal dhe problematikat e aktivitetit që ata ushtrojnë.

8. *Krijimi i Sistemit të Integruar të Monitorimit të Mjedisit*, do të bëjë të mundur rritjen e stabilitetit të procesit të monitorimit të mjedisit nga njëra anë dhe rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë e sigurimit e vazhdimësisë dhe bashkëpunimit mes partnerëve të ndryshëm, nga ana tjetër.

9. Ka mungesë të theksuar bashkëpunimi midis institucioneve, si në nivel lokal, ashtu edhe në nivel kombëtar, që ka të bëjë me të punuarit së bashku, ndarjen e të dhënave dhe informacionit mjedisor që secili prej tyre disponon, vënies në dispozicion të pajisjeve të monitorimit të njërit institucion për nevoja të tjetrit, atëherë kur nevojitet, si dhe kryerjes së inspektimeve apo monitorimeve të përbashkëta. Madje shpesh herë, aktiviteti i tyre mer format e një konkurrence të dukshme. Vetë - monitorimi, nga ana e subjekteve private, vetëm në tre vitet e fundit ka filluar të funksionojë, edhe pse ende ka pjesë të procesit që janë të paqartësuar, nga baza ligjore përkatëse. Megjithatë ajo kufizohet vetëm tek të dhëna statistikore sa i takon numrit të subjekteve raportuese dhe shpërndarjes së tyre sipas aktiviteteve dhe asaj gjeografike dhe nuk ka të dhëna mbi treguesit apo parametrat e monitoruar për efekt të matjes së sasisë së shkarkimeve, nga subjektet që janë objekt i lejeve të mjedisit. Kjo do të ishte një vlerë e shtuar e RGjMSh nëse do të aplikohesh, duke pasuruar atë dhë bazën e të dhënave që sot përdoren për vlerësimin mjedisor, si pjesë integrale e raportit.

10. Me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemeve të monitorimit, në raport me kërkesën për informacion dhe njëkohësisht me zhvillimet e politikave dhe strategjive mjedisore, konsiderohet si shumë e rëndësishme *rishikimi i vazhdueshëm i mënyrës së organizimit dhe rezultateve të proceseve monitoruese, me qëllim njohjen e mangësive, dobësive ose mungesës së balancave të nevojshme.*

11. *Ngritja e sistemeve të informacionit mjedisor (SIM), të cilat analizojnë dhe sintetizojnë e përpunojnë të dhënat e monitorimit, duke krijuar 'informacion', që do të përdoret për t'u raportuar, tek 'përdoruesit finalë', të tillë si politikëbërësit dhe publiku është gjithashtu një prioritet. Të dhënat mjedisore efektive të ofruara nga këto sisteme, nevojiten gjithashtu edhe për t'u përcjellë dhe ndarë mes 'ndotësve' dhe autoriteteve mjedisore, nëpërmjet agjencive të monitorimit dhe strukturave të qeverisjes lokale, rajonale dhe kombëtare të përfshira në këto aktivitete. Të dhënat e papërpunuara, nevojitet të përcillen, ruhen, procesohen, interpretohen dhe analizohen, ndërkohë që rrjeti IT, bazat e të dhënave dhe programet, do të shërbejnë si një mjet jetik, në shërbim të objektivit.*

Njëkohësisht, ngritja dhe funksionimi i SIM, do të bënte të mundur dhe siguronte, mbulimin me të dhëna dhe informacion mbi statusin mjedisor, presionet e ushtruara, ndikimin në mjedis dhe reagimin e publikut ndaj dukurive apo ndikimeve me impakt në mjedis (skema DPSIR), që përbën edhe konceptin bazë, ku duhet të bazohet monitorimi i treguesve mjedisorë, të cilët klasifikohen, sipas kësaj skeme konceptuale.

12. Raporti është pa një strategji komunikimi dhe nuk ka një fushatë emetimi, siç ndodh me agjencitë simotra në Evropë.

Në këtë drejtim ekziston nevoja që komunikimi për RGjM-në të ndërtohet brenda një strategjie të strukturuar dhe të bërë publike. Duhet dalluar publiku vendimarrës, nga organizatat/grupet e interesuara dhe këto të fundit nga publiku i gjerë. Janë nivele të ndryshme që duhen parë me kujdes, përdryshe e gjithë puna e raportit do të mbetet në hije, e pakomunikuar dhe pa efekt.

Që raporti të ketë ndikim, duhet të komunikohet mirë, me cilësi dhe me mjetet e duhura. Në mënyrë që të shkojë aty ku synohet. Në përfundim të publikimit të RGjMSh, përveç botimit dhe shpërndarjes në formën e shtypur (*hard-copy*) dhe publikimit në faqen zyrtare të AKM dhe të DRM-ve, duhet të propozohen mënyra më të thjeshta të përcjelljes së informacionit për gjendjen e mjedisit tek publiku ato grupet e veçanta të interesuara për gjetjet dhe informacionin e përcjellë përmes tij. Përgatitja nga ana e institucionit që e prodhon RGjMSh e një pakete komunikimi që mund të përmbajë video divulgative, *factsheet-e*, fletëpalosje, broshura informative ku mesazhet dhe informacioni jepet nëpërmjet info-grafikave dhe ilustrimeve tematike, etj. Gjithashtu mjete të efektshme mund të jenë edhe krijimi i një faqeje interneti të dedikuar, përdorimi i aplikacioneve mobile nëpërmjet të cilave shkëmbehet informacion dhe të dhëna mjedisore, që vijnë direkt nga terreni apo anasjelltas, institucionet përgjegjëse për hartimin e RGjMSh-së ia përcjellin qytetarëve.

13. Në aspektin ligjor nevojitet të bëhet më e qartë marrëdhënia institucionale mes organeve qendrore dhe atyre vendore për transmetimin e informacionit mjedisor tek publiku. Organet vendore, si institucione publike që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët duhet të luajnë një rol më të madh në këtë aspekt. Qëllimi përfundimtar është që parashikimet në ligj dhe aktet nënligjore të bëjnë të mundur që informacioni mjedisor tek publiku të arrijë në kohën e duhur për të parandaluar dëme

në mjedis dhe shëndetin e qytetarëve. Për këtë arsye organeve vendore duhet t'u sigurohen më shumë kapacitete dhe kompetenca lidhur me monitorimin dhe përcjelljen e informacionit mjedisor tek publiku.

14. RGjMSh fillon me një përmbledhje e cila është po aq me gjuhë teknike sa edhe gjithë Raporti (përshembull 'RGjMSh 2017'). Përgjithësisht, përmbledhjet janë sipërfaqësore dhe më shumë i kushtohen arritjeve dhe planeve për përmirësimin e legjislacionit në të ardhmen, ku të bie në sy gjithmonë shprehja në kohën e ardhme. Kjo përmbledhje duhet të jetë me një gjuhë të thjeshtë jo teknike, të kuptueshme nga publiku, duke u fokusuar tek gjetjet kryesore të raportit të lidhura me ndikimin e tyre në jetën dhe shëndetin e njeriut dhe pasojat e tyre. Kjo do t'i shërbente më mirë komunikimit të mirë dhe efektiv të mesazheve të raportit me lexuesin dhe ndërgjegjësimin e tyre. Përveç kësaj duhet të realizohet një përmbledhje e thjeshtë e të gjithë komponentëve të Raportit për publikun e thjeshtë dhe për OShC-të e interesuara në të ardhmen.

Elemente të tjera që duhet të përmirësohen dhe saktësohen në raport në këtë drejtim janë profilet e ekipit të autorisë sipas ekspertizës, citimet e pasaktësuara si dhe varfëria e grafikëve nga ana vizuale.

15. Thjeshtimi i indikatorëve për të përcjellë informacionin mbi gjendjen e mjedisit është një nga sfidat më të mëdha. Indikatorët duhet të jenë të kuptueshëm, të dallueshëm dhe të komunikueshëm. Ato duhet të jenë lehtësisht të identifikueshëm për sytë e publikut të gjerë, i cili duhet të dallojë menjëherë aty ku ka rrezik, apo qoftë dhe një situatë problematike.

16. Të dhënat janë kryesisht të mesatarizuara, maten në zona ku ka lehtësi logjistike dhe jo aty ku shqetësimi është më i madh, matjet janë të stacionuara, dhe mungojnë stacionet e levizshme - të paktën në raportim. Nëse do t'i referohemi të dhënave për cilësinë e ajrit, vihet re se

nuk ka matje në zona sensitive, dhe nuk ka raportime për raste aksidentesh industriale, ku ndotja mund të ketë qenë shumëfish mbi parametrat e lejuara. Të dhënat janë të relativizuara, sepse jo çdo ditë e vitit është matur. Matjet nuk kanë datë të dallueshme në raport dhe nuk pasqyrohet nëse janë kryer në një frekuencë vazhdueshmërie apo data të shkëputura.

Do të ishte me vend që në raport të kishite të dhëna lidhur me matje kampion me sinjalizime për ditë të veçanta, kur mund të ketë patur ndonjë episod të veçantë, si dhe të dhëna për dëmet shëndetësore që mund të shkaktohen, apo të dhëna të kryqëzuara, që mund të tregojnë rrezikun e pritsëm. Në rastin e aksidenteve industriale duhet konsideruar që në listën e treguesve të përfshihen tregues të veçantë mjedisorëm që të cilësohen si "tregues të aksidenteve industriale".

17. Raportimi i agentëve ndotës është tërësisht shkencor, konvencional, nuk ka gjuhë të thjeshtuar, nuk ka aktualizime apo lidhje me realitete të njohura.

Në këtë kontekst elementet kimikë ndotës për shembull, do të ishte mirë që të sqaroheshin në elemente asociativë të përditshmërisë për t'i identifikuar, ku i gjejmë dhe çfarë mund të bëhet për t'i shmangur. Shembujt e mirë që vijnë nga eksperiencia eksperimentale me tabela interaktive tepër divulgative, mund të merren në konsideratë nga formati i raportimit të RGjM-së.

18. Dokumenti ka nevojë që përtej tekstit të ofrojë dhe mundësi interaktiviteti, për shembull me lidhje elektronike të pëfshira në dokument. Variante alternative ndoshta me përmbajtje të shkurtuar mund të formatohen e përshtaten për faqen e internetit, që të vlejnjë si dokument, por dhe si informacion që jepet me shtresa në formatin e "deep learning", ku nuk ka kufi të eksplorimit të informacionit në procesin e lundrimit në internet.

19. Shenjat dalluese, qofshin ikoni-

ke, gjurmë apo përfaqësime simbolike, si parim duhet të kenë identifikimin e statusit për çdo tregues mjedisor, qofshin në nivelin e shkaqeve, dokumentimit të gjendjes, apo sinjalistikës që ndihmon masat për përmirësimin e këtyre treguesve. Publiku duhet të dallojë menjëherë për shembull “Parkun Kombëtar”, “Monumentin e Natyrës”, “Peizazhin e Mbrojtur”, si hapësira me status të veçantë që imponojnë një sjellje të caktuar konservuese. Gjithashtu, lidhur me hartat interaktive aktuale, ekziston nevoja e shtresëzimit të informacionit në nivele më të detajuara për publikun, p.sh. në rastin e paraqitjes së të dhënave për nivelin e zhurmave ka nevojë të përcaktohet jo vetëm se ku është niveli më i lartë i zhurmave, por edhe sa është kufiri i lejuar, që në këtë mënyrë të llogaritet devijanca.

20. Bazuar në atë që dokumentohet në raport mungon partneriteti me aktorë të tjerë që merren me studimin dhe ruajtjen e mjedisit, si p.sh. në rastin e organizatave të shoqërisë civile. *Konsiderimi i burimeve të tjera do të krijonte shumë më tepër mundësi për rritje kapacitetesh komunikuese. Përfshirja e aktorëve nga shoqëria civile, bota akademike, apo edhe partnerë ndërkombëtare do ta kthente RGJM-në në një aset kombëtar të përdorshëm në shumë sfera të shoqërisë.*

6 LITERATURA E KONSULTUAR



Birn Albania, Raport Kombëtar. Pushteti Vendor nën Lenten e të drejtës për informim. Tiranë 2017, faqe 15 & 79.

Convention on Biological Diversity

Cutanda L.B., Comparative View of Administrative Law Issues. - Albdesign Printing House 2010) fq. 353.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 10 Dhjetor 1948. neni 19.

Direktiva Kuadër e Ujit /Water Framework Directive 2000/60/EC

Goci E., Aksioni civil si pushtet i deleguar, citizens-channel, Maj 29, 2017

I. Baraku, E drejta për informim mbi çështjet e mjedisit. Legjislacioni Shqiptar në vështrim krahasues me Konventën e Aarhus-it. Revista shqiptare për studime ligjore Vol.7 (2013)

IEMS- Integrated Environmental Monitoring System

Instituti për Ndryshim dhe Lidërsip në Shqipëri, “Përmirësimi i qeverisjes lokale mjedisore në Bashkitë e Sarandës, Delvinës, Konispolit dhe Finiqit, Instituti për ndryshim dhe lidërsip në Shqipëri”, 2017, fq.9.

Intergovernmental Panel on Climate Change, Communications Strategy

Intergovernmental Panel on Climate Change, Global Warming Of 1.5 °C

KE, Raporti i Progresit për Shqipërinë 2015.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike/ United Nations Framework, Convention on Climate Change

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore, 4 Nëntor 1950, neni 10.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998)

Ligji 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, neni 17

Ligji Nr. 10431, 2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”

Ligji nr. 7664, datë 21.01.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Neni 42 & 38/b

Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 15

Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit, 2016, AKM.

Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit, 2017, AKM, Tiranë 2016, fq 17.

Raporti i Gjendjes së Mjedisit, AKM 2014

Raporti i Gjendjes së Mjedisit, AKM 2015

Raporti i Gjendjes së Mjedisit, AKM 2016

Raporti i Gjendjes së Mjedisit, AKM 2017

Stefan Jensen, Trends in policy relevant European environmental information systems, May 2017

Sub commission on Quaternary Stratigraphy, Working Group on the ‘Anthropocene’

Udhëzimit nr. 7, datë 06.01.1998 “Për sigurimin e informacionit për mjedisin. E drejta e publikut për informacion”. Pika 4

Udhëzimit nr.7, datë 06.01.1998 “Për sigurimin e informacionit për mjedisin. E drejta e publikut për informacion”. Pika 3

VKM nr. 509, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”.

VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Rregullat dhe procedurat për zbatimin e PKKM”

World Economic Forum, What is the Anthropocene? And why d



MENAXHIMI I INFORMACIONIT MJEDISOR NË SHQIPËRI

ANALIZË E KUADRIT LIGJOR DHE E MENAXHIMIT TË
INFORMACIONIT MJEDISOR NË NIVEL VENDOR E
KOMBËTAR, BAZUAR NË INFORMACIONIN E GJENERUAR
NGA RAPORTI I GJENDJES NË MJEDIS I SHQIPËRISË

